

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RAPORTI
VJETOR
2020



UNIVERSAL
POSTAL
UNION




IRG
INDEPENDENT
REGULATORS GROUP



European Conference of Postal
and telecommunications Administrations
48 European countries cooperating to regulate postal,
radio spectrum and communications networks






AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RAPORTI VJETOR **2020**

TIRANË 2021



PREAMBUL/PREMISA

Fjala e Kryetarit të AKEP



Tomi Frashëri - Kryetar i AKEP

Dorëzimi dhe paraqitja në Kuvendin e Shqipërisë i Raportit të tij vjetor, është për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) një moment vërtetësie dhe një mundësi për bilanc. Përmes Raportit vjetor, si institucion i pavarur, AKEP dhe stafi që ka në përbërje, nuk përpiqen të japin vetëm një panoramë sa më të qartë të një viti ushtrimor në sektorët nevralgjikë të telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare. Synimi kryesor mbetet vënia në perspektivë e dinamikave sektoriale, e impaktit të veprimtarisë në këto sektorë mbi përdoruesin, si dhe llogaridhënia për përmbushjen e detyrave institucionale që rrjedhin nga kuadri normativ dhe nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë.

Viti jashtëzakonisht sfidues që lamë pas diktoi në mënyrë të drejtpërdrejtë vetë strukturën dhe metodologjinë e përzgjedhur. Në ndryshim me pararendësit, Raporti për vitin 2020 i jep një përparësi të qartë analizës dhe vënies në pah të faktorëve transformues sektorialë. Një përpjekje e posaçme është bërë për lexueshmërinë dhe kuptueshmërinë e të dhënave dhe fakteve të trajtuara,

në mënyrë që përmbajtja të kthehet gjithmonë e më shumë në një udhërrëfyes të zhvillimit të sektorëve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe duke pasur parasysh transformimet dhe prurjet e pritshme apo të papritura që solli viti 2020 për shoqërinë digjitale, përfshirë këtu edhe shërbimet online dhe tregtinë elektronike e për pasojë shërbimet postare. Pandemia COVID-19 përshpejtoi në mënyrë mbresëlënëse procese në tranzicion drejt digjitalizimit tërësor, duke tejkaluar kornizat klasike rregullatore dhe duke ndryshuar, nën tryshinë e realitetit, qasjet ndaj teknologjive të reja të komunikimit dhe informimit. Një vit pas shpërthimit të pandemisë, të dhënat dëshmojnë se globalisht është realizuar një kapërcim pesëvjeçar në përdorimin e shërbimeve digjitale nga konsumatorët dhe bizneset. E-Commerce (E-Tregtia) në kontinentin amerikan njohu një hov të tillë më 2020, sa indikatorët tremujorë u barazuan me një rritje dhjetëvjeçare në këtë sektor. Më afër nesh, një vend si Italia që nuk ishte deri më sot pionier në fushën e digjitalizimit, përjetoj një kapërcim zhvillimor të barabartë me një rritje që pritej ta njihte vetëm në 10 vitet e ardhshme. Transaksionet elektronike përkundrajt atyre në të holla u rritën në nivele

që parashikoheshin për dy ose tri vitet në vijim ndërkohë që një pjesë e sistemeve të shëndetësisë në vende të zhvilluara njohu 10 vite transformim brenda një jave, sidomos nëpërmjet telekonsultimit¹.

Falë përparësisë së dhënë viteve të fundit inovacionit dhe procesit të digjitalizimit, Shqipëria nuk u gjet e papërgatitur kundrejt efekteve bllokuese apo ngadalësuese të shkaktuara nga pandemia në sektorët financiar, ekonomik, edukativ, sanitar dhe social. Si kudo në botë, edhe në vendin tonë u rrit ndjeshëm përdorimi i komunikimeve elektronike, si një aset për të mos ndalur punën dhe për të intensifikuar socializimin. Konsumi u përkthye gjithashtu me një rritje të shkëmbimeve postare, përfshirë këtu edhe marrjen e disa shërbimeve jetike nëpërmjet rrjetit postar. E thënë ndryshe, aksesit në komunikimet elektronike dhe postare u shndërrua në një proces jetik po aq sa furnizimi me mallra ushqimorë dhe barna apo trajtimi shëndetësor në mjedise të specializuara.

E gjithë kjo pati, si në Shqipëri, si kudo në botë, rrjedhoja të paparashikueshme në pikëpamje afatshkurtra dhe afatmesme. Rëndësi akute mori para së gjithash zhvillimi i kapaciteteve broadband për një rrjet sa më gjithëpërfshirës nga pikëpamja e mbulimit gjeografik dhe sa më të vijueshëm e të shpejtë nga pikëpamja e cilësisë. AKEP u kujdes në këtë aspekt, sikundër mund të shihet në detaj në pjesën I të këtij raporti, që në kushtet aktuale, pandemia mos të bëhej shkas për thellimin e frakturës digjitale, duke u përpjekur që çdo qytetar, përfshirë edhe ata me të ardhura modeste dhe me aftësi të kufizuara, të kishte akses dhe mundësi të barabarta përdorimi të internetit.

Nga një tjetër pikëpamje, AKEP u angazhua në riformatimin e strategjive kryesore zhvillimore, Planin Kombëtar Broadband dhe Strategjinë spektrale, të cilat u draftuan nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës me asistencën e AKEP dhe ekspertizën ndërkombëtare dhe u miratuan, vitin e kaluar, me vendim të Këshillit të Ministrave. Dokumentet e sipërpërmendura bazohen mbi plane veprimi me fokus një dekadë të tërë digjitale, e cila kërkon një investim të qenësishëm sidomos nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike në partneritet me autoritetet publike. Shenjë inkurajuese në këtë aspekt, e cila analizohet në këtë raport, është fakti se ndonëse me të ardhura të reduktuara për shkak të rënies së përdorimit të telefonisë fikse dhe celulare, sipërmarrësit i kanë kushtuar investimeve në përmirësimin e rrjeteve dhe teknologjive të reja, një pjesë të madhe të sforcos së tyre financiare gjatë gjithë vitit 2020, shifër kjo ndjeshëm më e lartë se në vitin 2019.

Më shumë se gjysma (52%) e popullsisë botërore ka sot akses në internet, kundrejt 8%, 20 vite më parë. Më 2019 në botë u shitën 1.5 miliardë smartphone. Interneti i sendeve (Internet of Things – IoT) ndërlidh sot 22 miliard aparate në kohë reale, nga automjetet tek fasilitetet sanitare, nga rrjetet elektrike tek ujësjellësit, nga furrat e pjekjes tek sistemet e vadtjes së tokave bujqësore².

Shqipëria ka ndjekur me ritme relativisht të përafërta trendin global për sa i përket cilësisë dhe shpejtësisë së ndërlidhjes përmes internetit. Gjatë vitit të kaluar, Shqipëria tejkaloi për herë të parë shifrën e 500 mijë pajtimtarëve me akses broadband fikse, duke njohur një rritje 15% më të lartë se në vitin 2019. Në raportin

1 The Economist, Le monde en 2021, Tendances Trends, nr. 52, 24 Décembre 2020, ff. 28-29.

2 K. SCHWAB, T. MALLERET, Covid-19: la grande réinitialisation, Forum Publishing, Genève, 2020, ff. 25-26.

e fundit të ITU, Shqipëria vlerësohet si një vend me rritje nga më të shpejtat të internetit nga rrjetet fikse për 100 banorë, me një normë penetrimi 17.6 %, mbi normën mesatare globale të 15.2%³. Trafiku i internetit broadband nga rrjete fikse arriti në rreth 600 milionë GB, ose rreth 32% më shumë se viti 2019, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre, financiare, informative, sociale, shëndetësore, në mënyrë sistematike. Për arsye të një përdorimi masiv të telefonisë së lëvizshme, përmirësimi i cilësisë dhe shpejtësisë së internetit mobile ka qenë gjithashtu një nevojë që operatorët e mëdhenj vendas të telefonisë janë duke e përmbushur progresivisht. Disa prej tyre janë renditur gjatë vitit 2020 mes ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve më cilësorë në botë nga raporte të pavarura ndërkombëtare. Volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, arriti në rreth 89 milionë GB. Kjo përbën një rritje rreth 28.6% krahasuar me vitin 2019. Instalimi i infrastrukturave dhe sistemeve 4G dhe 4G+ përmes përdorimit masiv të brezit të frekuencave 800Mhz, është një nga arsyet e përmirësimit të ndjeshëm të performancës broadband të këtyre operatorëve.

Këto transformime, si edhe shumë të tjera të vërejtura dhe të analizuar në raport, kanë pasur efekte interesante dhe hera herës të diskutueshme në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare. Në tregun e telefonisë celulare, të parë tradicionalisht si të ngërthyer në një funksionim të përqëndruar dhe me konkurueshmëri të dobët, forma të reja të konkurrencës, shpesh inovative por edhe agresive janë vëzhguar dhe adresuar nga AKEP. Nga ana tjetër, zhvillimi i një tregtie elektronike ende të pakornizuar ka sjellë një shtim eksponencial të ofruesve të shërbimeve postare. Dukuri të tilla e kanë detyruar autoritetin rregullator të intensifikojë mbikëqyrjen e tregjeve përkatës dhe të marrë masa e duhura sipas ligjit, në respekt të transparencës dhe konkurrencës efçente, të lirë dhe të ndershme. Raporti përmban në këtë aspekt një pasqyrë dhe një analizë të thelluar, në kuadrin e veprimtarisë monitoruese dhe inspektuese të AKEP.

Për t'u shënuar gjatë vitit 2020 janë gjithashtu edhe një seri nismash që AKEP ka marrë në fushën e partneriteteve, për të standardizuar, konform shtetit të së drejtës dhe detyrimeve ligjore për sigurinë e rrjeteve dhe mbrojtjen e privacisë së përdoruesit, qasjen dhe mjetet për përfitim të rrjeteve dhe teknologjive të pastra, në kuadër të implementimit të ardhshëm të teknologjive dhe rrjeteve të brezit të ri. Për krijimin e kushteve të këtij implementimi, AKEP ka punuar dhe vazhdon të punojë së bashkë me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, AMA, ITU dhe ekspertë të tjerë ndërkombëtarë, për lirim brenda 1 korrikut 2022, të brezit të gjerë 700Mhz i cili do të përdoret ekskluzivisht për qëllime digjitale dhe shfrytëzim të kapaciteteve broadband për rrjete të gjeneratës së re. Pajisja për herë të parë gjatë vitit të kaluar, sipas detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia spektrale, me një sistem bashkëkohor të automatizuar të menaxhimit të frekuencave, i jep AKEP mundësinë të menaxhojë me efektivitet asetet kombëtare dhe të jetë i përgatitur për marrjen në administrim të brezit të rëndësishëm 700Mhz.

Falë punës së një stafi profesional dhe të dedikuar, të cilit gjej rastin t'i shpreh mirënjohjen, AKEP ka pasur një veprimtari mjaft të dendur, megjithë shtrëngesat e pandemisë. Janë përmbyllur dhe finalizuar me vendime të Këshillit Drejtues një sërë analizash në tregjet me shumicë të telefonisë celulare dhe në tregun postar, sikundër janë miratuar disa dokumenta rregullatorë të rëndësishëm të veçantë, mes të cilëve spikat Rregullorja "Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve

3 https://www.itu.int/pub/D-IND-DIG_TRENDS_EUR.01-2021

elektronike publike”, e cila për herë të parë i kushton një vëmendje të posaçme, promovimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Për sa i përket performancës dhe transparencës në funksionimin e brendshëm të institucionit, mund të pohohet se përkundër viteve të mëparshme, AKEP realizoi plotësisht planin e investimeve dhe kryerjes së procedurave të prokurimit megjithë ngërçet dhe “force majeure” që rezultuan nga pandemia. Vetëm falë kryerjes me rigorozitet të procedurave të prokurimit publik për investimet, u krijua një tepricë prej gati 20 milionë lekësh e cila u derdh në buxhetin e shtetit.

Së fundmi, viti i vështirë 2020 nuk e ka penguar AKEP të intensifikojë bashkëpunimin e tij me BEREC, trupën e rregullatorëve të Bashkimit Evropian, të përftojë konsulencë dhe ekspertizë ndërkombëtare për të përgatitur vënien në shfrytëzim të frekuencave që ka nën administrim dhe përshtatjen e kuadrit normativ në fuqi në pritje të transpozimit të Kodit evropian të komunikimeve elektronike. Megjithëse u miratua vetëm në fund të korrikut 2020, AKEP mundi të realizojë gjithashtu brenda vitit më shumë se gjysmën e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2021, objektivat e AKEP janë të qartë:

1. Incentivimi i investimeve me fokus zhvillimin e qëndrueshëm digjital, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve;
2. Dinamizimi i sektorit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare përmes nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg;
3. Promovimi i aseteve kombëtare, brezave të frekuencave dhe përdorimi i tyre eficient në kuadrin e teknologjive të brezit të ri;
4. Standardizimi i sigurisë së rrjeteve dhe i besueshmërisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike nëpërmjet ofruesve të sigurtë dhe teknologjive të pastra;
5. Përafrimi gjithmonë e më i ngushtë me kriteret rregullatore dhe të pavarësisë funksionale sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Për arritjen e tyre, jemi të sigurtë se si në të kaluarën, po ashtu edhe në të ardhmen, AKEP do të gjejë mbështetjen dhe bashkëpunimin mjaft të frytshëm të Kuvendit të Shqipërisë.



PËRMBAJTJA

	PANORAMË E PËRGJITHSHME	13
	1. Aktualiteti i kuadrit ligjor dhe rregullator	13
	2. Statusi i shërbimit universal	15
	3. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë	19
	SHTYLLA TË VEPRIMIT STRATEGJIK PËR VITIN 2021	24
I.	2020, NJË VIT SPROVE: MENAXHIMI I PANDEMISË COVID-19 NË SEKTORIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE POSTARE	26
	1. Impakti i pandemisë globale Covid-19	27
	2. Roli i AKEP në bashkërendimin ndërsektorial për menaxhimin e krizës dhe në qëndrueshmërinë e rrjeteve dhe shërbimeve	29
II.	2020 NË FAKTE, ANALIZA DHE PERSPEKTIVA	34
	1. DINAMIKAT E TREGJEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE SHËRBIMEVE POSTARE	35
	1.1 Transformimet në tregjet e komunikimeve elektronike	35
	1.2 Proceset transformuese në tregun postar	49
	1.3 Proceset e monitorimit dhe inspektimit në tregjet e mbikëqyrura nga AKEP	51
	2. SFIDAT E ADMINISTRIMIT EFICIENT TË BREZAVE TË FREKUENCAVE	55
	2.1 Risia e përfuturit të sistemit të automatizuar të menaxhimit të frekuencave	55
	2.2 Inventarizimi dhe planifikimi i vënies në eficiencë të plotë të brezave 700Mhz, 800Mhz, 1450Mhz dhe 3800Mhz	57
	2.3 Proceset e monitorimit të përdorimit të frekuencave nga AKEP	60
	3. STRATEGJITË PËR PËRFORCIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË NJË MJEDIS GLOBAL TË PAQENDRUESHËM	74
	3.1 Ndërveprimi institucional për standardizimin e ndërtimit të infrastrukturave aktive dhe pasive në kushtet e zhvillimit të teknologjive të brezit të ri	74
	3.2 Procesi i përpunimit të sistemit të përqendruar të informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)	75
	3.3 Bashkërendimi strategjik me aktorët e tregjeve të komunikimeve elektronike për kalimin tërësor në rrjete, pajisje dhe teknologji të sigurta dhe të pastra	77
	4. PËRDORUESI NË FOKUS: ARRITJET NË PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE	83
	4.1 Risitë e Rregullores së konsoliduar të Konsumatorit	83
	4.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit	85
	4.3 Procesi i monitorimit dhe inspektimit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit	87
	5. PERFORMANCA INSTITUCIONALE DHE TRANSPARENCA FINANCIARE	93
	5.1 Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare	93
	5.2 Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit të institucionit	95
	5.3 Procesi i mbledhjes së të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore	99
III.	SHTOJCA	100
	1. Struktura dhe organigrama e AKEP	101
	2. Raport lidhur me nivelin e zbatimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019	102
	3. Statistika të zhvillimeve në tregjet e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare	111
	4. Statistika të zhvillimeve në sektorin e autorizimeve dhe të drejtave të tjera të përdorimit, licencat, certifikatat ajrore, detare, etj., si dhe përdorimi i domain.al	116
	5. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2020	124



1. Aktualiteti i kuadrit ligjor dhe rregullator

Raporti vjetor i AKEP, sikurse parashikohet nga ligji nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” është dokumenti përmes të cilit ky autoritet rregullator raporton dhe përgjigjet për punën e kryer gjatë një viti, duke parashtruar në të njëjtën kohë programin e punës për vitin në vijim.

Veprimtaria e autoritetit, si organi i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, rregullohet bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore dhe rregullatore të nxjerrë në zbatim të ligjit.

Veprimtaria e AKEP normohet nga tërësia e akteve nënligjore që përcaktojnë politikat e zhvillimit të sektorit si dhe aktet rregullatore të miratuara nga Këshilli Drejtues i AKEP, si organi drejtues i Institucionit, rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Direktivat e Komisionit dhe Parlamentit Evropian, aktet e BEREC, ITU, ERPG etj.

Gjatë vitit 2020 kuadri ligjor i AKEP nuk ka pësuar ndryshime.

Por, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë e madhe të këtij sektori në zhvillimin e ekonomisë digjitale, si dhe evoluimin e tij të jashtëzakonshëm brenda një periudhë shumë të shkurtër, AKEP konsideron si tejet të nevojshëm pasjen e një kuadri ligjor normues i cili i përshtatet dinamikës së sektorit, ndaj dhe në këtë kontekst vlerësohet mjaft e rëndësishme ndërhyrja legjislative në kuadrin ligjor ekzistues në fuqi.

Nisur nga konteksti i mësipërm, si dhe në ndjekje të rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përgjatë vitit 2020 AKEP ka kryer evidentimin e saktë të problematikave të legjislacionit në fuqi për sa i përket:

- Garantimit të pavarësisë operacionale të AKEP, bazuar në konstatimet dhe udhëzimet e Komisionit Evropian – progres raportet e përvitshme – dhe BEREC;
- Rritjen e performancës dhe kapaciteteve ushtrimore të misioneve rregullatore dhe konkurrencë-nxitëse të AKEP në qasjet e tyre juridike, ekonomike dhe inxhinierike;
- Përforcimin e kapaciteteve nxitëse dhe ndërvepruese në kuadër të rritjes

së investimeve në fushën e komunikimeve elektronike, në veçanti në aspektin e hyrjes në treg të teknologjive të reja 5G dhe shfrytëzimit të spektrave përkatës të frekuencave.

Në vijim, AKEP ka hartuar propozimet ligjore në formën e akteve ligjore/nënligjore dhe dokumentacionin shoqërues të tyre, fazë e cila do të ndiqet edhe nga propozimet përkatëse për nisjen e procesit legjislativ për miratimin e ndryshimeve ligjore, që do të vijnë edhe gjatë vitit 2021.

Brenda harkut kohor, objekt i këtij raportimi, AKEP është përpjekur maksimalisht të përmbushë një ndër synimet e përcaktuara për vitin 2020, lidhur me përditësimin dhe standardizimin e kuadrit rregullator, synim i cili mbetet ende një sfidë për t'u përmbushur edhe për vitin 2021.

Gjatë vitit 2020, AKEP ka përmbyllur procedurat e këshillimit publik për disa nga rregulloret më të rëndësishme që prekin mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike si dhe rregullimin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve, të akteve rregullatore që lidhen ngushtësisht me normimin e aspekteve teknike të sektorit të komunikimeve elektronike, si dhe përditësimin apo përmirësimin e akteve që lidhen me veprimtarinë administrative të brendshme të AKEP.

Përgjatë vitit 2020, nga Këshilli Ministrave u miratuan dy akte nënligjore shumë të rëndësishme, lidhur me Planin Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm *Broadband* dhe Politikën Spektrale.

AKEP ka dhënë ekspertizën e tij ligjore dhe teknike, dhe ka qenë pjesë e grupeve teknike të punës, të krijuar nga MIE, për hartimin e këtyre akteve me tepër rëndësi për sektorin në fjalë. Kjo është bërë duke u konsultuar edhe me organe dhe institucione ndërkombëtare, si dhe duke i kushtuar rëndësi përvojave dhe praktikave më të mira.

Të dy këto akte kanë përcaktuar ndaj AKEP detyra thelbësore, një pjesë e të cilave ka filluar të zbatohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020, dhe detyrat të tjera të rëndësishme që do të vijojnë të zbatohen gjatë vitit 2021.

VKM nr. 434, datë 3.6.2020 "Për miratimin e Planit Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale *Broadband* 2020-2025" ka përcaktuar ndaj AKEP detyra të tilla si:

- a) Përmirësimi i Atlasit *Broadband*.
 - i. Përfshirja e infrastrukturës së gjithë operatorëve lokalë të cilët mungojnë aktualisht në ATLAS;
 - ii. Përmirësimi i procesit të mbledhjes së të dhënave duke rritur bashkëpunimin me autoritetet lokale, bashkitë dhe institucionet;
 - iii. Përmirësimi i rregullores së ATLAS.
- b) Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis bashkive, ministrive dhe enteve rregullatore për çështjet e rrjeteve *Broadband*.
- c) Përmirësimi i bashkëpërdorimit të infrastrukturës ekzistuese:
 - i. Analiza dhe adresimi i pengesave për bashkëpërdorimin e infrastrukturës;
 - ii. Rregullimi i aksesit në infrastrukturën backbone;
 - iii. Inventarizimi i infrastrukturës pasive në zotërim të bashkive.
- d) Adresimi i çështjes nëse *Broadband* duhet të përfshihet në Shërbimin Universal, bazuar në Kodin e Ri

të Komunikimeve Elektronike (EECC).

e) Finalizimi i Lirimit të Dividentit Digjital 2.

f) Analiza dhe rishikimi i tarifave të spektrit.

g) Dhënia në përdorim e frekuencave të lira në 800 MHz.

h) Realizimi në kohë i ankandit për bandën 3.5 GHz.

i) Analiza e tregjeve përkatëse për *Broadband* dhe marrja e masave rregulluese.

Në VKM nr. 636, datë 29.7.2020, "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit", janë përcaktuar për AKEP detyra të tilla si:

- të kryejë studime novatore, lidhur me dhënien në përdorim të brezave të përcaktuar në Planin Kombëtar të Frekuencave, përfshirë kombinimet teknike midis tyre, si dhe për sa u takon çmimeve të dhënies në përdorim.
- të promovojë, në bashkëpunim me MIE, aksesin në shërbimet *Broadband* që përdorin brezat nën 1 GHz, në zona të largëta dhe me densitet të ulët popullsie, duke vendosur kushtet përkatëse të përdorimit.
- të krijojë së bashku me AMA, një inventar të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike.
- të përpunojë së bashku me MIE dhe AMA, një metodologji dhe të kryejnë një analizë për tendencat teknologjike bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian, të nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët përkatës dhe, në veçanti, për shërbime që mund të veprojnë në intervalin e frekuencave të përfshira nga 400 MHz në 6 GHz, me qëllim identifikimin e përdorimeve të rëndësishme, të mundshme ose në fazë zhvillimi, të spektrit radio.
- të përditësojë marrëveshjet ndërkufitare, për brezat e frekuencave që administron AKEP, në mënyrë që ato të përfshijnë të gjithë brezat kryesorë të shërbimeve të lëvizshme e fikse, sipas përcaktimeve në praktikën ndërkombëtare.

2. | Statusi i shërbimit universal

Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike

Ofrimi i shërbimit universal është parim themelor dhe detyrim i cili lind nga kuadri ligjor.

Ofrimi i këtij shërbimi konsiston në një minimum të përcaktuar shërbimesh, të cilat duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, me cilësinë dhe kushtet e përcaktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP, me çmim të

përballueshëm, në përputhje me kushtet specifike kombëtare.

Sipas të dhënave periodike vjetore për vitin 2020 të ITU “*Measuring the Information Society*” lidhur me përballueshmërinë e aksesit në shërbimin e internetit për shportën me përmbajtje 5 GB internet fiks, rezulton se në Shqipëri çmimi i kësaj shporte është dukshëm më e ulët se mesatarja botërore prej 2.75% të GNI dhe pranë mesatares së vendeve të Evropës 1.26% të GNI.

Gjithashtu, edhe për sa i përket treguesit të GNI për ofrimin e shërbimeve *Broadband* mobile, Shqipëria ka vlera dukshëm më të ulëta (1.06% GNI p.c) se mesatarja botërore dhe se vendet e rajonit.

Të dy këto tregues janë më të ulët se objektivi që ka vendosur Komisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm të Internetit (*Broadband Commission for Sustainable Development*) sipas të cilit niveli fillestar për akses në shërbimet *Broadband* (fiks dhe mobile) në vendet e zhvilluara duhet të jetë i përballueshëm për më pak se 2% të të ardhurave mujore të produktit të brendshëm bruto për frymë.

Gjatë vitit 2020, për të mundësuar që të gjithë përdoruesit e shërbimeve celulare të kenë akses në këto rrjete, pavarësisht aftësive të tyre paguese, AKEP ka sensibilizuar/nxitur ofruesit e këtyre shërbimeve që të krijojnë paketa që të jenë sa më përfaqësuese dhe të përballueshme për çdo kategori dhe preference konsumatore. Një gjë e tillë ka bërë që operatorët të lançojnë paketa me çmim 500 lekë, dhe përmbajtje minuta/sms/internet me vlefshmëri 30 ditore.

Edhe në rrjetet fikse sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve të internetit, në funksion të ofrimit të mundësisë për të pasur akses dhe tarifa të përballueshme, veçanërisht gjatë vështirësive të krijuara nga situata pandemike, kanë ofruar paketa interneti apo të kombinuara, me çmime deri në 60% më të ulëta se tarifat standarde të paketave që ata ofrojnë.

Për të siguruar ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për qytetarët shqiptar me të njëjtat standarde me ato të vendeve të BE, AKEP po bashkëpunon me MIE për harmonizimin e legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike me kuadrin e ri rregullator të BE (formësuar me Kodin e Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC)) i cili ka sjellë ndër të tjera dhe ndryshime të rëndësishme në lidhje me shërbimin universal, siç janë:

.....

- Të gjithë konsumatorët duhet të kenë akses me çmime të përballueshme, sipas kushteve specifike të çdo vendi, në shërbim të aksesit *Broadband* me shpejtësi adekuate dhe në shërbime të komunikimit zanor, sipas cilësisë së specifikuar në vendin përkatës, përfshirë lidhjen në rrjet nga vendndodhje fikse.
- vendet anëtare mund të konsiderojnë përballueshmërinë e shërbimeve të cituara më sipër, që nuk ofrohen nga vendndodhje fikse në rastet kur e konsiderojnë këtë të nevojshme për të siguruar përfshirjen e plotë sociale dhe pjesëmarrjen ekonomike të konsumatorëve në shoqëri.

.....

Gjatë vitit 2020, Këshilli i Ministrave me VKM nr. 434, datë 3.6.2020, ka miratuar “*Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të infrastrukturës Digjitale Broadband 2020 - 2025*”, plan i cili harmonizon pikëpamjet dhe perspektivën nga të gjithë aktorët, në lidhje me vizionin aktual dhe të ardhshëm të Planit Kombëtar për *Broadband*, objektivat e përgjithshëm të tij, si dhe qëllimet specifike. Vizioni që ky dokument

ka përcaktuar është: *Shqipëria me infrastrukturë Digjitale Broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.*

Në përputhje me këtë vizion, ndër të tjera synohet që deri në fund të vitit 2025:

- Penetrimi i *Broadband* nga rrjetet fikse të jetë 100% për familjet me mundësi aksesit prej të paktën 100 Mbps dhe 1 Gbps (zonat urbane - Tiranë) për 50% të familjeve;
- 100% e shkollave, universiteteve, qendrave shëndetësore dhe spitaleve të jenë të lidhura me internet *Broadband* me shpejtësi të lartë 1 Gbps;
- të jenë të mbuluara me lidhje 5G, një qytet kryesor, korridoret kryesore të transportit dhe vendndodhjet strategjike;
- deri në fund të vitit 2023, 50% të hapësirave publike si parqe, biblioteka dhe sheshe, në të gjitha qytetet dhe fshatrat të ketë akses të lirë në lidhje WiFi.

Statusi i Shërbimit Universal Postar

AKEP është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë. Për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në nenin 13 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, AKEP ndër të tjera ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e shërbimit universal postar, si dhe të mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar.

AKEP cakton ofruesin e shërbimit universal postar në bazë të një procedure konkurrimi, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave (VKM nr. 239/2018), nëse nga analiza e zhvillimit të tregut konstaton që ka, të paktën, dy ofrues të shërbimeve postare që mund të sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Në mbështetje të ligjit nr. 46/2015, dhe në përfundim të afatit të autorizimit individual të ofruesit të vetëm të shërbimit universal “Posta Shqiptare” sh.a., Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr.6, datë 16.4.2020 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “Analizë e Tregut të Shërbimeve Postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar”.

Pas përfundimit të procesit të këshillimit dhe marrjes së komenteve të palëve të interesuara, Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 12, datë 16.6.2020 miratoi dokumentin përfundimtar “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”.

Përmes këtij dokumenti AKEP ka kryer procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, si dhe ka analizuar nëse në treg ekziston më shumë se një operator që plotëson kushtet ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin.

Nga analiza përfundimtare rezultoi se në treg ka vetëm një operator postar, “Posta Shqiptare” sh.a., që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar.

Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal postar me procedurën e konkurrimit publik do të bëhej vetëm nëse në përfundim të analizës së zhvillimit të tregut të kryer nga AKEP konstatohej që kishte të paktën dy ofrues të shërbimeve postare, të cilët mund të siguronin ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve

të përcaktuara në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Duke qenë se “Posta Shqiptare” sh.a., është operatori i vetëm që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, AKEP miratoi zgjatjen e afatit të autorizimit individual të operatorit ekzistues për sigurimin e shërbimit universal postar dhe u angazhua të lëshojë autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19, në zbatim të VKM nr. 236, datë 19.3.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID 19”, “Posta Shqiptare” sh.a., ka ofruar për të gjithë pensionistët shërbimin e pensioneve në banesë dhe kryerjen e pagesave për pjesën më të madhe të kategorisë së përfituesve me aftësi të kufizuar.

Në realizimin e kësaj nisme u përfshi e gjithë struktura e ofruesit të shërbimit postar “Posta Shqiptare” sh.a., duke vënë në dispozicion burimet logjistike dhe njerëzore. Në kushte normale “Posta Shqiptare” sh.a., ka shpërndarë rreth 160,000 pensione/muaj nëpër familje, ndërsa gjatë periudhës mars - qershor 2020, ka arritur të shpërndajë në adresat përkatëse rreth 500,000 pensione/muaj ose gjithsej 1,500,000 pagesa pensionesh.

Gjatë vitit 2020, “Posta Shqiptare” sh.a., ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal:

- 561 zyra të hapura, që ofrojnë shërbime postare dhe financiare;
- 700 sportele, nga të cilët 521 sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar;
- 579 kuti postare për pranimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve;
- 667 kuti postare për dorëzimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve.

Bazuar në të dhënat e raportuara rezulton se “Posta Shqiptare” sh.a., i ka realizuar treguesit e mbulimit me shërbim universal sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës, me nr. 6174, datë 16.12.2019.

Gjatë vitit 2020, “Posta Shqiptare” sh.a., finalizoi investimin e ngritjes së “Postës Hibride”, investim që i shërben rritjes së numrit të objekteve postare të shërbimit universal dhe rritjes së treguesve të cilësisë të përmbushjes së këtij shërbimi. Shërbimi i “Postës Hibride” realizon shtypjen e informacionit elektronik, palosjen, sortimin dhe dorëzimin e objekteve postare në formë fizike në adresën e konsumatorit. Me këtë investim “Posta Shqiptare” sh.a., mundëson ofrimin e shërbimeve “paketë” të gjenerimit të faturave, printimit, zarfimit, shpërndarjes, arkëtimit dhe kalimit të vlerave në llogaritë përkatëse të klientëve të mundshëm potencialë si OSHEE, Ujësjiellës Kanalizime, etj.

3. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Rezolutën e datës 10.7.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”, AKEP është udhëhequr nga angazhimi maksimal për përmbushjen e tyre, duke punuar me përkushtim dhe profesionalizëm.



*Figure 1: Paraqitja e Raportit Vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2019 në Kuvendin e Shqipërisë (seanca plenare)
Burimi: Kuvendi i Shqipërisë 2020*

Megjithëse Rezoluta është miratuar në gjysmën e dytë të vitit 2020, për shkak të situatës së vështirë të shkaktuar nga pandemia, AKEP ka intensifikuar punën për realizimin e secilit rekomandim duke orientuar veprimtarinë dhe aktivitetin e tij, në përpjekje për të përmbushur me sukses përgjegjësitë e tij ligjore.



Figure 2: Dorëzimi i Raportit Vjetor të veprimtarisë së AKEP për vitin 2019 pranë Kryetarit të Kuvendit, Z. Gramoz Ruçi
Burimi: Kuvendi i Shqipërisë 2020

Vlen të theksohet se, megjithëse viti 2020 ishte një vit sfidues për tregjet, ekonominë dhe institucionet, asnjë prej rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi nuk mbeti pa u realizuar. Nga ky këndvështrim AKEP ka mundur të adresojë të gjitha rekomandimet e lëna në funksion të rolit dhe misionit të tij si organ rregullator.

Prej 11 rekomandimeve të dhëna për vitin 2020 në Rezolutën e Kuvendit⁴:

- a) 6 rekomandime janë realizuar plotësisht;
- b) 5 rekomandime janë në proces realizimi;

Janë realizuar dhe përmbushur me sukses rekomandime të tilla, si:

1. Dhënia përparësi dhe vënia në eficiencë të plotë e brezave të paalokuar, në përfitim të qytetarëve dhe konsumatorëve, kryerjes së analizave lidhur me dhënien në përdorim të spektrit, përfshirë këtu edhe kombinimet teknike të tij, bazuar në programin e politikës spektrale në nivel kombëtar. AKEP ka ndërmarrë të gjitha masat administrative për realizimin e procedurave të prokurimit për shërbimin e konsulencës përsa i përket dhënies në përdorim të brezave të lirë të frekuencave si dhe kombinimet midis tyre. Nga kjo procedurë është përzgjedhur konsulent një shoqëri ndërkombëtare me eksperiencë dhe njohuri të thelluara në fushën e administrimit, menaxhimit të spektrit të frekuencave, duke garantuar zbatimin e plotë të objektivave rregullatore, në përputhje të plotë me politikat e zhvillimit spektral në

4 Shtojca 2 përmban detaje lidhur me zbatimin e Rezolutës.

nivel kombëtar si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim.

2. Kryerja e Analizës së tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare. AKEP me vendimin e Këshilli Drejtues, nr. 11, datë 17.4.2019, miratoi dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare, tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare-dokument për këshillim publik” dhe, pasi shqyrtoi komentet e marra nga palët e interesuara dhe dy vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 9, datë 24.4.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin ‘Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare’” vendosi:

- (i) Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuara në pikën 4, të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut, kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduralë të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe rregullorja 9/2009;
- (ii) Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, sipas pikës 4, të nenit 5 të Rregullores.

3. Kryerja e analizës së tregut të telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik për Analizën e Tregut të Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare, AKEP vlerësoi opinionet e aktorëve në treg, si dhe rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, dhe pasi zhvilloi konsultime të herëpashershme me organizmat ndërkombëtarë, me vendimin nr. 11, datë 16.6.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, vendosi:

- (i) Tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a., Telekom Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., t'i konsiderojë si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi: (a). Masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 12, 13, 14, datë 22.2.2018; (b). Tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018;
- (ii) Të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.

4. Bazuar në dispozitat ligjore dhe duke marrë në konsideratë afatin e përfundimit të autorizimit individual të “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar në datën 7. 7. 2020, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 6, datë 16.4.2020, miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, për një afat 30 ditorë (17 prill - 18 maj). Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 12, datë 16.6.2020, vendosi të miratojë dokumentin përfundimtar “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, dhe të përcaktojë shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në datën 30.6.2020, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dhënien e Autorizimit Individual Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit Universal Postar për një periudhë 5 vjeçare, duke filluar nga data 7 korrik 2020.

5. Në ndjekje të rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për reformimin e kuadrit ligjor të komunikimeve elektronike në funksion të implementimit të kodit të ri të komunikimeve elektronike dhe përforcimin dhe garantimin e pavarësisë institucionale, AKEP, përgjatë vitit 2020, ka kryer evidentimin e saktë të problematikave të legjislacionit në fuqi për sa i përket:

- Garantimit të pavarësisë operacionale të AKEP, bazuar në konstatimet dhe udhëzimet e Komisionit Evropian – progres raportet e përvitshme – dhe BEREC;
- Rritjen e performancës dhe kapaciteteve ushtrimore të misionëve rregullatore dhe konkurrencë-nxitëse të AKEP në qasjet e tyre juridike, ekonomike dhe inxhinierike;
- Përforcimin e kapaciteteve nxitëse dhe ndërvepruese në kuadër të rritjes së investimeve në fushën e komunikimeve elektronike, në veçanti në aspektin e hyrjes në treg të teknologjive të reja 5G dhe shfrytëzimit të spektrave përkatës të frekuencave.

Në vijim, AKEP ka kryer hartimin e propozimeve ligjore në formën e akteve ligjore/nënligjore dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, fazë e cila do të ndiqet edhe nga propozimet përkatëse për nisjen e procesit legjislativ për miratimin e ndryshimeve ligjore.

6. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, AKEP ka monitoruar dinamikën e ecurisë së problemit të dorëzimit të pakove në adresën e individit nga “Posta Shqiptare”, si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit, e cila, edhe pas rekomandimeve të AKEP, vijon të mbetet problem, duke sjellë mosdorëzimin e një pjese të mirë të pakove në adresë të marrësit, por dorëzimin e tyre pranë zyrave postare. Gjithashtu, ka monitoruar dinamikën e ecurisë së problemit të tarifave dhe kostove shtesë që u kërkojnë konsumatorëve për marrjen e pakove nga Posta në kundërshtim me frymën e ligjit dhe parimet e Rregullores së Shërbimit Postar Universal. Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se, gjatë vitit 2019 AKEP ka realizuar kontrollin dhe inspektimin e subjekti “Posta Shqiptare” sh.a.

Gjatë procedurës inspektuese, është konstatuar se subjekti “Posta Shqiptare” sh.a., në veprimtarinë e saj shfaqte problematika lidhur me:

- shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit në përputhje me nenin 40, të ligjit 46/2015;
- tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare.

Në përfundim të procedurës së inspektimit, ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a., është dënuar me masën administrative “Gjobë” si edhe dënime administrative plotësuese në formën e rekomandimeve.



The background image shows a landscape with several tall, lattice-structured communication towers. The towers are covered with various antennas and satellite dishes. In the foreground, a dark-colored SUV is parked on a grassy field with its rear hatch open. A person wearing a hard hat and a high-visibility vest with the letters 'AKEP' on the back is standing next to the vehicle, looking towards the towers. The sky is overcast and grey.

SHTYLLA TË VEPRIMIT STRATEGJIK PËR VITIN 2021

The background of the page is a composite image. The upper portion features a tall, lattice-structured telecommunications tower with several satellite dishes attached, set against a clear sky. The lower portion shows a concrete wall topped with a chain-link fence, with a utility pole and some vegetation in the foreground.

1. Incentivimi i investimeve me fokus zhvillim në qendrueshëm digjital, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve;

.....

2. Dinamizimi i sektorit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare përmes nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg;

.....


3. Promovimi i aseteve kombëtare, brezave të frekuencave dhe përdorimi i tyre eficient në kuadrin e teknologjive të brezit të ri;

.....

4. Standardizimi i sigurtë të rrjeteve dhe i besueshmërisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike nëpërmjet ofruesve të sigurtë dhe teknologjive të pastra;

.....

5. Përafrimi gjithmonë e më i ngushtë me kriteret rregullatore dhe të pavarësisë funksionale sipas standardeve të Bashkimit Evropian.



I

2020, NJË VIT SPROVE:
MENAXHIMI I PANDEMISË
COVID-19 NË SEKTORIN
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
DHE NË SEKTORIN
E SHËRBIMEVE POSTARE

1. Impakti i pandemisë globale Covid-19

Impakti i pandemisë Covid-19 në sektorin e komunikimeve elektronike dhe në shërbimet postare

Impakti i pandemisë COVID-19 u ndje në të gjithë gjymtyrët e shoqërisë shqiptare, në sferën publike dhe në atë private, që në javët e para të muajit mars 2020. Masat e karantinimit dhe shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore i detyruan qytetarët dhe përdoruesit e shërbimeve të interesit publik t'i përshtaten një situate të jashtëzakonshme e të paprecedent. Në kushtet kur përparësi absolute mori distancimi social në formën e izolimit në banesa si dhe pezullimi i çdo lloj trafiku apo qarkullimi fizik, për të shmangur përhapjen e kontaminimit dhe mbingarkesën e strukturave dhe stafit sanitar, garantimi i aksesit dhe vijimësisë së komunikimeve dhe i informacionit *online* u shfaq hap pas hapi si një nevojë po aq jetike sa edhe furnizimi i popullsisë me mallra ushqimore dhe barna.

I gjithë sektori i komunikimeve elektronike, por edhe shërbimet postare, përfshirë edhe shërbimi universal postar u ndikuan thellësisht nga një pikëpamje e trefishtë e funksionimit organizativ, e integritetit, qëndrueshmërisë dhe vijueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve si dhe e kapaciteteve mbështetëse për garantimin e disa shërbimeve publike thelbësore. Eficienca e digjitalizimit të shërbimeve publike dhe i bashkëveprimeve mes qytetarit dhe administratës – 700 shërbime me 1.5 milionë përdorime mujore –, një mjet mjaft i dobishëm dhe lehtësues në kushtet e izolimit dhe distancimit social, për të përmendur vetëm më kryesorin, u gjendën nga momenti në moment nën kërcënimin e një asfiksie teknike dhe një kolapsi sistemik në varësi të qëndrueshmërisë së rrjeteve.

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, sikundër edhe sipërmarrësit e shërbimeve postare, regjistruan humbje të qenësishme të fitimeve dhe pakësim të konsiderueshëm të të ardhurave. Bilanci negativ i kësaj situate do të vijojë të ndihet gjatë në indikatorët e tregut, në reformatimet e strategjive tregtare dhe, sidomos, në planet e investimeve madhore gjatë gjithë periudhës 2020-2021 (shih në kapitullin e treguesve financiarë të operatorëve).

Paparashikueshmëria e efekteve të pandemisë dhe kohëzgjatja e tyre, duke sjellë për rrjedhojë përkeqësimin e situatës financiare të sipërmarrësve dhe kapacitetet e tyre investuese, ndikuan gjithashtu në rishikimin e qasjeve ndaj praktikave rregullatore. Organizma ndërkombëtare referencë në këtë fushë rekomandojnë një ulje të drejtpeshuar të trysnisë rregullatore dhe një rritje më të përqendruar të fokusit në incentivimin dhe përshpejtimin e kalimit në shoqërinë digjitale, zhvillimin e kapaciteteve të brezit të gjerë dhe implementimin e teknologjive të brezit të ri. Që nga fillimi i pandemisë, një qasje e tillë është përkthyer në nisma nga më të ndryshmet, prej të cilave vlen të veçohet miratimi i Strategjisë Digjitale (*Digital Strategy Act*) dhe i planveprimit Dekada Digjitale (*Digital Decade*) nga Bashkimi Evropian.

Në këto kushte, nuk mund të mbejë, dhe në fakt nuk mbeti, i pacenuar në funksionimin e tij global as

AKEP, i cili iu përshtat të gjitha masave shtrënguese duke zbatuar me përpikmëri protokollet zyrtare të parandalimit dhe menaxhimit të situatës virale, pa ndërprerë në asnjë moment misionet e tij rregullatore dhe koordinuese në dritën e rekomandimeve, bashkëpunimeve dhe bashkëveprimeve, ashtu sikurse rezultuan nga impulset e dhëna nga organizmat ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian.

Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm i pasojave të Covid-19 ishte risku real që ato përbënë në momente të caktuara për ndërtimin dhe konsolidimin e një shoqërie digjitale demokratike, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Konsumi eksponencial i shërbimeve të komunikimeve elektronike, kryesisht i internetit, në pamundësi për ndërveprime sociale fizike dhe në kushtet e punës, argëtimit dhe shkollës *online*, rriti nivelin e riskut nga pikëpamja e integritetit të rrjeteve si dhe përjashtimit nga aksesit në shërbime të disa kategorive përdoruesish. Situata nxori kështu në pah nevojën e një strategjie për të garantuar edhe në kohë krize, jo vetëm integritetin e rrjeteve, por edhe parime dhe të drejta themelore të përdoruesit:

- akses i barabartë në rrjetet dhe shërbimet elektronike;
- cilësi shërbimi në përpjesëtim të drejtë me nevojat e përdoruesit;
- strategji ofertash shërbimesh dhe tarifash inteligjente të përshtatura ndaj kategorive të ndryshme të përdoruesve, sidomos ndaj shtresave në nevojë, pa cenuar ekuilibrin e tregut dhe parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme;
- përgjegjësi sociale të theksuar të sipërmarrësve përkundrejt kategorive më të brishta të përdoruesve aktivë, kryesisht nxënësve dhe studentëve.

Pasojat e pandemisë, kohëzgjatja e të cilave vijon të mbetet e pacaktuar, e sensibilizuan menjëherë AKEP për konceptimin e një strategjie konkrete veprimi. Kjo strategji, e cila u konkretizua që në ditët e para të krizës sanitare, gjeti zbatim në respekt të kompetencave ligjore të institucionit, në sinkroni me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në bashkëinformim me BEREC, trupën e rregullatorëve të vendeve të BE. Rol kyç për ta bërë atë sa më eficientë luajtën vetë sipërmarrësit e sektorit, nga të cilët do të veçonim tre operatorët e telefonisë së lëvizshme, operatorët e telefonisë fikse si dhe titullarin e shërbimit universal për shërbimet postare.

2. Roli i AKEP në bashkërendimin ndërsektorial për menaxhimin e krizës dhe në qëndrueshmërinë e rrjeteve dhe shërbimeve

Gjatë gjithë periudhës së pandemisë dhe posaçërisht në faza kritike të saj, AKEP ka luajtur një rol bashkërendues ndërsektorial me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, me institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë, për të përcaktuar hap pas hapi masat e nevojshme për menaxhimin sa më eficient të gjendjes kritike të sektorit dhe për krijimin e kushteve të një kthimi gradual në normalitet.

Masat emergjente

1. Në përputhje me masat e marra nga Komiteti i menaxhimit të krizës dhe udhëzimet e njëpasnjëshme të Këshillit të Ministrave, AKEP përshtati funksionimin e brendshëm nëpërmjet punës online. Një shtab i përhershëm me staf të reduktuar strikt u ngrit në mjediset e institucionit për të siguruar mirëfunksionimin e sistemeve të brendshme dhe koordinimin teknik dhe institucional. Në këtë kuadër, AKEP mbikëqyri implementimin e masave të emergjencës edhe tek ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, stafet si edhe pikat e tyre të shitjes dhe të shërbimit të publikut. Vetëm një prej operatorëve të telefonisë celulare, në pak ditë, i shpërndau stafit mbi 10,000 maska, dorashka dhe dezinfektantë. Në ndërmjetësim me Ministrinë e Shëndetësisë u bë e mundur mbajtja hapur sipas një grafiku të dakordësuar të këtyre pikave dhe u trajtuan rast pas rasti situata të veçanta duke u gjetur zgjidhje të përshtatshme me fokus mosndërprerjen e shërbimit ndaj publikut.
2. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, AKEP siguroi, megjithë tryninë e javëve të para të karantinimit, mirëmbajtjen e pandërprerë të rrjeteve dhe infrastrukturave parësore në funksion të vazhdimësisë së shërbimit, përmes garantimit të qarkullimit të lirë në terren të skuadrave teknike të secilit sipërmarrës. Më shumë se 400 teknikë mundën të zhvendoseshin lirshëm në terren, jo vetëm për të siguruar mirëmbajtjen e rrjeteve, por edhe për t'u ardhur në ndihmë përdoruesve fundorë në rast defektesh apo ndërprerje të shërbimit në banesa private dhe mjedise pune edhe në zonat më të largëta. Në të njëjtën mënyrë u bë e mundur vijueshmëria e shërbimeve postare. AKEP ndërmjetësoi edhe në këtë rast qarkullimin e lirë të automjeteve të shërbimeve postare, për të garantuar dorëzimin e objekteve postare, sikundër edhe kryerjen e disa shërbimeve specifike si dorëzimi i pagesave apo i pensioneve për personat e moshuar dhe atyre në pamundësi për t'u zhvendosur.
3. Nëpërmjet koordinimit me operatorët, AKEP iu përgjigj kërkesës së autoriteteve publike për të lehtësuar fushata ndërgjegjësimi të popullsisë për përfitim të gjeveve jetëshpëtuese nëpërmjet thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS. Në shembullin e praktikave më të mira në rajon dhe në botë, AKEP u kujdes që ndërveprimi me përdoruesit të ishte proporcional me synimin e kërkuar si dhe i përcaktuar dhe i kufizuar në kohë.

4. AKEP ndërmjetësoi me operatorët celularë, pas kërkesës së autoriteteve publike dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), vënien në dispozicion të kapaciteteve të përforcuara (gateway/webservice) dhe ndërfaqe mesazhesh SMS falas për të menaxhuar në mënyrë sa më efikase fluksin e trajtimit të kërkesave për lejim qarkullimi të depozituara në portalin E-Albania.
5. AKEP lehtësoi ndërlidhjen mes operatorëve, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Brendshme, me qëllim bërjen sa më funksional dhe të arritshëm të numrit të emergjencës 112.
6. Sipërmarrësit u treguan të gatshëm ndaj ftesës së AKEP për të shmangur ndërprerjen e shërbimit në rast të mospagesës së menjëhershme të faturave nga disa kategori pajtimtarësh, në javët e para të pandemisë.

Më afatgjata rezultuan masat që u planifikuan nga AKEP me mbështetjen e operatorëve të telefonisë celulare dhe të internetit fiks për sa i përket mirëpërdorimit të rrjeteve dhe garantimit të aksesit në shërbime cilësore dhe kosto të përballueshme të të gjithë kategorive të përdoruesve fundorë. Këto masa u dakordësuan dhe u intensifikuan nën emrin e **Solidaritëtit Digjital** (*Digital Solidarity*).

Masat afatgjata në kuadrin e Solidaritëtit Digjital

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) i kushtoi në këtë aspekt një vëmendje të veçantë monitorimit të trafikut të përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronik, i cili u rrit ndjeshëm. Në javët e para të krizës sanitare u vu re një dyfishim, dhe hera herës edhe trefishim, i përdorimit krahasimisht me normalen dhe u konstatua një pritshmëri në rritje për internet me shpejtësi të lartë, konform përdorimit masiv të platformave digjitale me një gamë të larmishme shërbimesh audiovizive. Njëkohësisht, përdoruesit dhe autoritetet publike mbështetën idenë e ofrimit të shërbimeve në kapacitet maksimal, dhe mundësisht falas, për disa ditë, skemë që po vihej në jetë në disa vende evropiane. Duke marrë shkas nga kolapsi që kaploi shumë shpejt sistemet dhe rrjetet në këto vende, si për shembull në Spanjë, Itali dhe në Mbretërinë e Bashkuar, si pasojë edhe e një përdorimi të papërgjegjshëm të kapaciteteve ekzistuese, AKEP dhe operatorët kryesorë përpunuan një skemë më realiste, më të besueshme, më afatgjatë dhe më konform të drejtave dhe detyrimeve në një mjedis digjital të qëndrueshëm.

Së pari, krahas kërkesës formale për një shtim të qenësishëm të kapaciteteve *broadband* për përdoruesin fundor, AKEP mori përsipër hartimin e një udhëzuesi pedagogjik për përdorimin e përgjegjshëm të rrjeteve dhe shërbimeve, duke evidentuar mundësitë për gjithsecilin për të përfutur cilësi shërbimi më të mirë në sajë të disa gjesteve të thjeshta dhe për t'u ruajtur nga sulme kibernetike dhe nga parazitimi i rrjetit. Qartësisht, theksi u vu mbi faktin se përdorimi i disproporcionuar dhe i pakufizuar i internetit mund të çonte në një kongestionim jashtëzakonisht të dëmshëm për kohën që po kalonte vendi.



UDHËRRËFYES PRAKTIK PËR QËNDRUESHMËRINË DIGJITALE RREZIQET . POTENCIALET . VEPRIMET E DUHURA

Në kushtet kur puna në distancë është kthyer në prioritet për shumë nga ne dhe shkollat e kanë kthyer mësimdhënien e të gjitha grupmoshave online, lind pyetja:

A do të mundën linjat e internetit fiks dhe celular të përballojnë këtë ngarkesë?

Operatorët celularë dhe ato të rrjeteve fikse të shërbimit internet, janë në punë dhe në gadishmëri të plotë, për të siguruar mirëfunksionimin, në shërbim të jetës dhe ekonomisë së vendit. Megjithatë, vetë ne, përdoruesit, mund të ndërmarrim një sërë veprimesh për të siguruar mbarëvajtjen e shërbimit të internetit. Më poshtë mund të gjeni një udhërrëfyes të thjeshtë për t'u orientuar në lidhje me sjelljen tonë digjitale në këto ditë të vështira.

MBINGARKIMI DHE KEQPERDORIMI I RRJETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE - ÇFARË RREZIKOJMË?

Shumë njerëz, këto ditë, po zhvendosen në botën digjitale teksa jeta jashtë shtëpisë është e pamundur. Ky fakt po vështirëson detyrën e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për të mbajtur lidhjet në parametrat e kërkuara.

Angli, Francë, Itali dhe vënde të tjera javët e fundit, njerëzit e mbërthyer në shtëpitë e tyre po përdorin internetin shumë më tepër. Vizitat në faqet e lajmeve u rritën deri 60%. Një model i ngjashëm po shfaqet edhe në SHBA. Trafiku në internet u ngrit me 40%, pasi Presidenti Trump e shpalli pandeminë një emergjencë kombëtare. Në Angli, për shkak të mbingarkesës, në datën 17.03.2020, rrjetet e 5 operatorëve celular, u bllokuan për rreth 5 orë, duke i lënë abonentët e tyre pa shërbime telefonike dhe interneti.

Figure 3: Ekstrakt nga Udhërrëfyes praktik për qëndrueshmërinë digjitale (AKEP 2020)

Burimi: AKEP 2020 <https://akep.al/2020/03/20/akep-udherrefyesh-praktik-per-qendrueshmerine-digjitale/>

Publikimi i këtij dokumenti u shoqërua me masat e para që u zbatuan në interes të përdoruesit nga një ose më shumë sipërmarrës:

- Dyfishim i kapaciteteve të rrjeteve fikse duke mundësuar fluiditetin e një rritje të përdorimit deri 90% më shumë krahasuar me normalen. Falë kësaj mase, në fund të muajit mars 2020, trafiku u stabilizua;
- Shtrirje më e gjerë e mbulimit 4G në rrjete celulare edhe në zona ku nuk ekziston një mbulim fiks broadband;
- Rritje e sasive data (internet) falas nga 3-7GB për pjesën më të madhe të përdoruesve, për një periudhë 5-8 javore;
- Përdorim falas të të gjitha shërbimeve telefonike + > 10GB shtesë falas internet për një periudhë 5-8 javore për të gjithë pajtimtarët mjekë dhe infermierë;
- Sasi data (internet) të pakufizuara për përdoruesit e platformave edukative dhe kulturore, në limitet e kapaciteteve të rrjetit (RTSH School Channel) për një periudhë 5-8 javore;
- Sasi data (internet) deri 60% më lirë për përdoruesit e internetit fiks për të gjitha platformat edukative dhe të shkollës online pas periudhës së ofrimit të këtij shërbimi falas;
- Seri ofertash me një gamë të larmishme shërbimesh edukative dhe për fëmijë falas;
- Shërbime të kryerjes së pagesave dhe procedurave të tjera klient-operator në format digjital.

Përmbledhtazi, në javët e para të krizës sanitare, përdoruesit përfituan gjatë karantinimit më shumë se

50% internet falas për një periudhë 5-8 javore, ulje të konsiderueshme për pajtimtarët e fiksit për akses në platforma edukative për fëmijë, oferta me përmbajtje falas për disa javë për çdo abonim të ri, etj.

Një tjetër arritje për pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike është edhe dakordësimi, pas inkurajimit nga AKEP dhe miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës, i hedhjes në treg të disa ofertave të destinuara, gjatë krizës sanitare, për kategoritë më në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto oferta në formë paketash, me një çmim bazik prej 500 lekë, përmbajnë 50 minuta thirrje, 50 SMS dhe 50MB internet dhe synojnë një akses më të përshpejtuar dhe cilësor në gama të personalizuar shërbimesh për individë që gjatë pandemisë mund të jenë në pamundësi për të përdorur shërbime performante të telefonisë dhe internetit të lëvizshëm. Krahësuar me parametrat bazë të kategorive në nevojë, këto paketa kanë mundësuar një konsum të shtuar me një kosto mjaft të ulët.

Vlen të theksohet, se të inkurajuar nga AKEP, operatorët celularë dëshmuan një angazhim social për t'u vlerësuar nëpërmjet nismash në ndihmë të spitaleve publike, mjekëve dhe shkollës *online*. Operatori më i madh në treg dhuroi 15.000 tableta me abonimin përkatës për nxënës nga familje në nevojë, si edhe, për të njëjtën kategori, 15.000 karta SIM dhe 10GB internet të lëvizshëm, në mënyrë që të sigurohej sa më shumë ndjekja e programeve arsimore *online*.

Në sajë të këtyre masave solidare, që në shumë aspekte rezultuan më ambicioze se ato që u implementuan në vende të tjera, u synua mbi të gjitha shmangia e frakturës digjitale dhe thellimi i pabarazive që efektet sociale të pandemisë do të kishin shkaktuar.

Së fundmi, nga pikëpamja rregullatore dhe nisur nga përvoja e vitit të parë të pandemisë, AKEP vendosi detyrimin për të gjithë operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike për raportimin e monitorimit të kapaciteteve të rrjeteve dhe për draftimin e planeve afatgjatë të masave teknike për situatat e emergjencës dhe fatkeqësive natyrore. Tre operatorët e telefonisë celulare dorëzuan planet përkatëse pranë AKEP gjatë muajve nëntor-dhjetor 2020.

Të gjitha masat e ndërmarra nga AKEP dhe, nën bashkërendimin e tij, nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, janë pasqyruar në raportimet e vazhdueshme të trupës evropiane të rregullatorëve të komunikimeve elektronike.



Figure 4: Pamje e jashtme e godinës së AKEP
Burimi: AKEP 2020

III

2020 NË FAKTE, ANALIZA DHE PERSPEKTIVA

1.

Dinamikat e tregjeve të Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare

1.1 Transformimet në tregjet e komunikimeve elektronike

Vendimmarrjet lidhur me analizat e tregut të komunikimeve elektronike dhe masat rregullatore të ndërmarra

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë vitit 2020 i ka kushtuar vëmendje të veçantë shqyrtimit të dokumenteve të analizës së tregjeve celulare, duke ndjekur me rigorozitet procedurën specifike të këshillimit publik të përcaktuar në nenet 34 dhe 35 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar vendimet finale të dokumenteve të analizës së tregut si më poshtë:

- Vendimi nr. 9, datë 24.4.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin ‘Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare’”;
- Vendimi nr. 11, datë 16.6.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit ‘Analizë tregu i telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare’”.

Me anë të vendimit nr. 9, datë 24.4.2020, Këshilli Drejtues i AKEP, ndër të tjera, pasi analizoi të gjithë treguesit dhe faktorët që ndikojnë në këtë treg, si edhe referuar orientimeve dhe konkluzioneve të rekomandimit përfundimtar të Autoritetit të Konkurrencës (vendimi nr. 661, datë 21.11.2019), ku plotësimi i tre kriterëve për tregun e shumicës së akses-origjinimit nuk konsiderohet i karakterizuar nga pikëpamja e kuadrit normativ për mbrojtjen e konkurrencës, vendosi:

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kriterëve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut, kryer sipas përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimi të testit të tre kriterëve, konform pikës 4, të nenit 5 të Rregullores.

Pas përfundimit të procesit të Këshillimit Publik të Dokumentit “Analizë tregu i telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, AKEP administroi dhe analizoi komentet e palëve të interesuara për këtë proces.

Në funksion të këtij procesi, AKEP zhvilloi konsultime të herëpashershme me organizmat ndërkombëtarë. Ndonëse u rekomandua që për thirrjet hyrëse kombëtare të vijohej sipas metodës së *benchmark*-ut rajonal

(vendet e BE), u vërejt se analiza e tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse nuk do të mund të ishte plotësisht efiçiente, për aq kohë sa nuk do të përfitohej një model kostosh, i cili është duke u përpunuar aktualisht në AKEP, bazuar në praktikën më të fundit BE/BEREC.

Në përfundim të këtij procesi, Këshilli Drejtues i AKEP me anë të vendimit nr. 11, datë 16.6.2020, pasi analizoi me kujdes të gjithë faktorët që ndikojnë në këtë proces, vendosi:

1. T'i konsiderojë tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: *tregu me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare*, duke lënë në fuqi:
 - a) Masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 12, 13, 14, datë 22.2.2018.
 - b) Tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73, të datës 1.10.2018.
2. Të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.

Miratimi i vendimeve të mësipërme, ka qenë rezultat i një procesi të gjerë gjithëpërfshirës, për të cilët janë vlerësuar sugjerimet e Autoritetit të Konkurrencës, komentet e palëve të interesuara, rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikën më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian.

Tregjet e komunikimeve elektronike

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, ka treguar më shumë se kurrë, rëndësinë e shërbimeve të telekomunikacionit dhe rolin e tyre për të mbajtur aktivë dhe të lidhur shërbimet e ofruara nga Qeveritë, Bizneset dhe aktorët e tjerë të shoqërisë. Të ndikuar nga masat e marra për përballimin e pandemisë, qytetarët janë mbështetur në infrastrukturën e shërbimeve të telekomunikacionit dhe teknologjitë e avancuara për sigurimin e informacioneve, respektimin e distancimit social, si edhe kryerjen e punës nga shtëpia nëpërmjet sistemeve të telepunës.

Gjatë vitit 2020, operatorët celularë dhe të rrjeteve fikse kanë investuar në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve kryesisht të internetit, duke rritur shpejtësinë dhe cilësinë e qëndrueshmërisë së dërgimit të sinjalit.

Veçanërisht, gjatë periudhës së pandemisë, operatorët kanë ndërmarrë masa për rritjen e kapaciteteve të rrjetit për të mundësuar akses të qëndrueshëm të përdoruesit fundorë me shpejtësi të përmirësuar, e diktuar kjo edhe nga rritja e kërkesës konsumatore si rezultat i masave të karantinimit të ndërmarrë nga vende të ndryshme.

Nevoja për rritje dhe qëndrueshmëri të kapaciteteve ofruese të shërbimeve të telekomunikacionit, ka qenë në funksion të:


- Mbajtjes së qytetarëve të informuar dhe të ndërlidhur në rrjet për të siguruar akses në shërbimet shëndetësore, financiare, tregtare, etj.;
- Ofritit të qëndrueshëm të shërbimeve të komunikimit për bizneset;
- Lehtësimit të punës nga shtëpia përmes aplikimit të Telepunës, etj.

• Të ardhurat dhe investimet në rrjetet e komunikimeve elektronike

Efektet e shkaktuara nga situata pandemike, janë ndjerë edhe në rezultatet financiare të operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike.

Nga raportimet e kryera deri në muajin prill 2021, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike raportuan **në total 33.45⁵ miliardë lekë të ardhura nga komunikimet elektronike**, ku të ndara sipas kategorive shërbim nga rrjetet celulare dhe ato fikse, paraqiten si vijon.

Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike



Burimi: Të ardhura të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Në tregun e ofritit të shërbimeve celulare gjatë vitit 2020 operatorët kanë raportuar rreth 23.9 miliardë lekë të ardhura, e cila përbën një tkurrje me rreth 9% krahasuar me vitin 2019.

Kjo rënie në të ardhurat e operatorëve celularë është afektuar nga ulja e të ardhurave të gjeneruara në të dy tregjet, atë të pakicës dhe tregun e shërbimet me shumicë.

Ndër faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në rënien e të ardhurave mund të përmendim:

- uljen e volumit të thirrjeve kombëtare/ndërkombëtare si rezultat i përdorimit masiv të aplikacioneve

⁵ Të ardhurat mund të ndryshojnë si rezultat i raportimit dhe auditimit të pasqyrave financiare të operatorëve.

OTT (whatsapp, viber, etj.) të cilat kanë pasur një zhvillim të vullshëm vitet e fundit si rezultat i zhvillimeve teknologjike dhe përmirësimit të cilësisë së internetit;

- rënia e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e paketave *bundles* me pakicë.

Pavarësisht uljes së nivelit të të ardhurave totale nga viti 2019, gjatë vitit 2020 operatorët e shërbimeve celulare e kanë rritur ndjeshëm nivelin e investimeve në këto rrjete. Kjo shihet në përmirësimin e shërbimeve *broadband*, si edhe në përmirësimin e cilësisë së thirrjeve zanore. **Në fund të vitit 2020 kjo shifër arriti në 6.9 miliardë lekë, nga rreth 4.2 miliardë lekë për vitin 2019.**


Të ardhurat nga komunikimet elektronike, të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2020, ishin 9.55 miliardë lekë. Kjo përbën një rritje me rreth 6% krahasuar me vitin 2019.

Më shumë se 82% e të ardhurave të këtij tregu gjenerohen nga 7 operatorët kryesorë, që janë: Albtelecom, Abcom (Vodafone), ASC, ATU, Abissnet, Nisatel dhe Digicom. Operatorët e tjerë (OA), edhe pse në numër të konsiderueshëm, përbëjnë rreth 18% të këtij tregu.

Bazuar në raportimet e kryera, përgjatë vitit 2020, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer 2.76miliardë lekë investime, të cilat janë përdorur kryesisht për përmirësimin e aksesit të shërbimeve *broadband*.

Në lidhje me nivelin e të ardhurave për disa nga kompanitë kryesore në tregun e komunikimeve elektronike na informon figura në vijim.

Figura: Shpërndarja e të ardhurave të operatorëve të komunikimeve elektronike (në milionë Lekë)



Burimi: Të ardhura të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Tregu i shërbimeve elektronike është një ndër sektorët me kontribut mjaft të rëndësishëm edhe në punësim. Për vitin 2020 ky treg numëron 3.496 të punësuar.

- **Treguesit kryesorë të shërbimeve të rrjeteve celulare dhe fikse**

Pajtimtarët

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2020 arriti në 2 milionë, me një rritje me rreth 12% krahasuar me vitin pararendës. Pra, rreth 70% e pajtimtarëve aktivë të shërbimeve celulare përdorin internetin nëpërmjet telefonave *smart*.

Gjatë vitit 2020 ka vijuar tendenca e ndryshimit të strukturës së pajtimtarëve, ku vihet re ulje e numrit të pajtimtarëve me parapagim (77% nga 83% që ishte në vitin 2019), e cila tregon për tendencën e shkuarjes drejt shërbimeve me kontratë (paspagim), ashtu si edhe në vendet e tjera të zhvilluara.

Të dhënat e grumbulluara nga AKEP tregojnë se numri total i kartave SIM arriti në rreth 3.3 milionë gjatë vitit 2020, e thënë ndryshe, çdo banor në Shqipëri zotëron rreth 1.17 karta SIM.

Ndërkohë, numri i kartave SIM aktive (i referohet numrit të kartave që janë përdorur për të kryer komunikime elektronike gjatë tre muajve të fundit) arriti në rreth 2.6 milionë, një tkurrje e lehtë me rreth 0.4% krahasuar me vitin 2019.

Për sa i përket ecurisë tremujore të përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare, është vërejtur se *gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 ka pasur një rënie të treguesve kryesorë*, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, apo edhe me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Kjo periudhë është ndjekur nga një rritje gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020.

Një ndër faktorët që ka ndikuar në rënien e numrit të përdoruesve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, është situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, e cila solli :

- i. uljen e numrit të turistëve dhe emigrantëve për shkak të vështirësive të transportit ndërkombëtar, dhe mbylljes së kufijve;
- ii. reduktimin e numrit/pagesave të paketave standarde të riaktivizuara;
- iii. mosaktivizimin e paketave në mënyrë periodike për numrat me parapagesë.

Shërbimi i internetit nga rrjetet fikse ka pasur një rritje të konsiderueshme për sa i përket numrit të pajtimtarëve të rinj dhe rritjes së niveleve të shpejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi.

Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezulton se numri i operatorëve të autorizuar të rrjeteve të telefonisë fikse që kanë raportuar se kanë pasur aktivitet gjatë viti 2020 në telefoninë fikse është 40, dhe rreth 174 operatorë kanë ofruar shërbimet *broadband* fiks.

Numri pajtimtarëve me akses *broadband* fiks në fund të vitit 2020 për herë të parë tejkaloi shifrën e 500 mijë pajtimtarëve, duke u rritur këtë shifër me rreth 15% krahasuar me vitin 2019.

Bazuar në raportin e fundit të ITU⁶, normën më të lartë të penetrimit të internetit për popullsi në vitin 2020 e kanë vendet evropiane me një mesatare prej 32.9%, ndërkohë Shqipëria raportohet mbi normën mesatare globale e cila është 15.2%. Po në këtë raport Shqipëria vlerësohet si vendi me rritjen më të shpejtë të internetit për 100 banorë, me 15.9%.

6 https://www.itu.int/pub/D-IND-DIG_TRENDS_EUR.01-2021

Bazuar në të dhënat rajonale të vitit 2020 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 40.18% dhe 25.55%. Ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural, rreth 21%, i ndjekur nga Tirana dhe Shkodra me nga 10% dhe 8%.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në Shqipëri në vitin 2020 ka pësuar një rënie rreth 8%, konkretisht nga 242,000 në fund të vitit 2019, në 223,000 në fund të vitit 2020.

Volumi i njësive të përdorura

Gjatë vitit 2020, situata e krijuar nga pandemia, telepuna dhe zhvillimi i mësimin online kanë nxjerrë në pah më shumë se kurrë nevojën jo vetëm për akses në shërbimet e internetit, por edhe qasjen në këto shërbime me shpejtësi më të lartë dhe më të qëndrueshme.

Për të siguruar akses dhe shërbim të qëndrueshëm gjatë pjesës së parë të vitit 2020, operatorët e ofrimit të shërbimeve internet kanë rritur kapacitetet e rrjetit për përballimin gjithnjë e në rritje të trafikut të internetit, si rrjedhojë e kërkesës së shtuar dhe rritjes së përdorimit të internetit nga rrjetet fikse dhe ato mobile⁷.

Volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, arriti në rreth 89 milionë GB. Kjo përbën një rritje rreth 28.6% krahasuar me vitin 2019.

Rritja e përdorimit të internetit nëpërmjet telefonave celularë evidenton faktin se tashmë telefonat celularë të pajisur me karta SIM e kanë ridimensionuar rolin e tyre duke kaluar nga përdorimi tradicional për kryerjen e thirrjeve zanore, drejt ofrimit të aksesit të gjerë në botën virtuale (shfletim informacionesh, transmetim të dhënash, kryerje e thirrjeve audio/video, sms, etj.).

Rritja e përdorimit të internetit, u shoqërua me ulje të:

- volumit të thirrjeve dalëse ‘voice’;
- numrit të SMS-ve;
- volumi të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Rënia për këto tregues është pasojë edhe e përdorimit në masë të aplikacioneve OTT (*whatsapp, Viber, Messenger, Skype etj.*) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe ‘*video calls*’. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje edhe si rezultat i përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga operatorët të rrjeteve 4G dhe 4G+, të cilat mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve (video dhe audio) nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Masat e ndërmarra nga AKEP për mosdiskriminim të tarifave të thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, kanë prodhuar efekte pozitive edhe gjatë vitit 2020, ku konstatohet se rreth 43% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë ‘*off-net*’ dhe rreth 56% brenda rrjetit ‘*on-net*’.

Gjatë vitit 2020, trafiku i internetit *broadband* nga rrjete fikse arriti në rreth 600 milionë GB, ose rreth 32% më shumë se viti 2019, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre, financiare, informative, sociale, shëndetësore, etj.

⁷ Shiko pjesën më sipër

Për sa i përket përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re reduktim i sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelecom, si operatori me pjesën më të madhe në treg në vitin 2020, u reduktua me 8% krahasuar me vitin 2019, ndërsa mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të Albtelecom, i cili është operatori me rrjetin fiks më të rëndësishëm në vend, është reduktuar nga 35 minuta në vitin 2019, në 33 minuta në vitin 2020.

Teknologjitë e ofrimit të shërbimit dhe mbulimi me 3G dhe 4G

Rritja e numrit të pajtimtarëve të shërbimeve internet, si edhe zhvillimet teknologjike paralelisht sjellin edhe rritjen e kërkesës për cilësi në ofrimin e këtyre shërbimeve. Përdoruesit e internetit, si shkak edhe i tendencave dhe nevojës për të kryer telepunë, kanë diktuar rritjen e kërkesës për të pasur lidhje me shpejtësi dhe qëndrueshmëri më të lartë, si edhe nevojën për mbulimin edhe të zonave rurale të pambuluara, kryesisht atyre me potencial për ofrimin e shërbimeve të turizmit.

Mbulimi i territorit dhe popullsisë me rrjete të teknologjive 3G dhe 4G ka pasur përmirësime të dukshme vitet e fundit, rritje e cila është më e theksuar në mbulimin e territorit dhe popullsisë me rrjetet 3G/4G.

Të tre operatorët që ofrojnë shërbime celulare, për vitin 2020 kanë raportuar mbulim të popullsisë me rrjet 3G në nivele rreth 90 – 99%.

Për sa i përket mbulimit të territorit dhe popullsisë me rrjet LTE (4G), bazuar në raportimet e kryera për vitin 2020, rezulton se:

- Sipërmarrësi One Telecommunications sh.a., është operatori që ka mbulimin më të gjerë me këtë teknologji, duke arritur nivelin 93.7% të mbulimit të territorit me rrjet 4G, dhe 98.1% të mbulimit të popullsisë.
- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., ka raportuar mbulim të territorit 91.2% me rrjet 4G dhe 98.4% të popullsisë,
- Sipërmarrësi Albtelecom sh.a., ka mbulimin më të ulët të territorit me rrjet 4G, me 30%, dhe mbulimi të popullsisë 72%.

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të internetit konfirmohet edhe nga raporti⁸ i *Opensignal* (organizëm ndërkombëtar i pavarur) që synon të paraqesë gjendjen reale të rrjeteve celulare në mbarë botën, mbështetur në matjet e kryera nga vetë përdoruesit e rrjeteve.

Bazuar në këtë raport, konstatohet se dy nga operatorët kanë arritur tregues mjaft të mirë për sa i përket mbulimit me rrjet 4G dhe shpejtësisë së këtij shërbimi, duke i mundësuar përdoruesve navigim cilësor në rrjetin e internetit celular lidhur me, thirrjet zanore nga aplikacionet OTT, shpejtësinë download/upload, cilësi të videove dhe shërbime të tjera digjitale nga më të larmishmet.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të internetit vërehet edhe në tregun e ofrimit të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse. Në vitin 2020 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje *broadband* me shpejtësi 30-100 Mbps me rreth 4-fishim të pajtimtarëve krahasuar me vitin 2019. Gjatë vitit 2020, pjesa e pajtimtarëve që përdori shpejtësi më shumë se 10 Mbps arriti në 67%, krahasuar me rreth 41% që ishte në

8 <https://www.opensignal.com/reports/2021/04/albania/mobile-network-experience>

vitin 2019.

Zhvendosja e pajtimtarëve drejt paketave që ofrojnë shpejtësi interneti më të lartë dhe teknologji rrjeti bashkëkohore ju mundëson përdoruesve të marrin shërbimet e kërkuara me cilësi më të lartë dhe pa ndërprerje.

Për sa i përket rritjes së niveleve të shpejtësisë së ofruar vlen të theksohet se, gjatë vitit 2020 është vënë re një rritje e konsiderueshme e pajtimtarëve që përdorin rrjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 6.500 në vitin 2019, ky numër ka arritur në 15.500 në vitin 2020. Megjithatë, nivelet e shpejtësisë që përdorin pajtimtarët në Shqipëri janë ende nën nivelet e vendeve të zhvilluara.

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit *broadband* në rrjete fikse është FTTH/FTTB, e ndjekur nga lidhjet DSL duke shënuar rritje me rreth 60% krahasuar me vitin 2019. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Në Shqipëri lidhjet DSL përbëjnë 49% të totalit të lidhjeve *broadband* fiks dhe shumica e tyre është me kombinim fibër optike + linjë bakri apo FTTN/FTTC.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Përdorimi i infrastrukturës në tërësinë e saj është ndikuar jo pak nga fakti nëse kjo infrastrukturë është nën administrimin dhe në funksion të ofruesve të rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, apo është edhe pjesë infrastrukturore e utiliteteve të tjera si OSHEE, Ujësjellës, Autoritete Rrugore etj.

Përdorimi i infrastrukturës në tërësinë e saj konsideron të dy versionet e infrastrukturës aktive dhe pasive, duke synuar edhe përfshirjen e infrastrukturave mbështetëse nga utilitete të tjera, të cilat mund të vihen në dispozicion për nevojat e zhvillimit të mëtejshëm të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Këtij synimi i shërben edhe ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me arsyetimin për të evituar kosto të pakthyeshme të investimeve në ndërtimin e infrastrukturës specifike të komunikimit elektronik. Kjo mundësi direkt përfshin pozitivisht edhe përdoruesin fundor në përfitimin e më shumë produkteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike, sa me afër pozicionit gjeografik ku ndodhet ai, me maksimumin e mundshëm të përfitimeve si tarifa, por edhe në karakteristikat funksionale të produktit/shërbimit përkatës.

Në këtë këndvështrim, ekziston mundësia e aksesit në infrastrukturë fizike nga dy kategori ofruesish të infrastrukturës, nga ofrues të sektorit të komunikimeve elektronike, por edhe nga ofrues të rrjeteve dhe utiliteteve të tjera, si: infrastrukturë rrugore, e energjisë elektrike, ujësjellësit, etj.

Dinamika e pjesëve të tregut

Zhvillimet e vullshme në fushën e digjitalizimit kanë pasur ndikim esencial në mënyrën se si ndërveprojnë bizneset dhe njerëzit në mbarë globin, dhe, si pjesë e këtij sektori, edhe operatorët e shërbimeve celulare, për të mbajtur ritmin e evoluimeve digjitale, janë përballur me nevojat gjithnjë në rritje për të investuar në rrjete dhe teknologji.

Investimet e operatorëve celularë të kryera gjatë viteve 2019 – 2020, kanë dhënë efekt edhe në nxitjen e

konkurrencës midis operatorëve ku vërehen lëvizje për sa i përket pjesëve të tregut të secilit operator.

Edhe gjatë vitit 2020, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile, megjithatë, për pjesën më të madhe të këtyre treguesve ka shënuar rënie të lehtë krahasuar me vitin 2019.

Konkretisht, pjesët e tregut për vitin 2020 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., variojnë me:

- rreth 47% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card dhe SIM card aktivë;
- rreth 53% të tregut për thirrjet dalëse mobile;
- rreth 64% të tregut për volumin e të dhënave (internetit) nga rreth 59% në vitin 2019;
- rreth 49% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 53% në vitin 2019;
- 53% dhe 54% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë;

Pas ndryshimeve të bëra në strukturën aksionere të shoqërisë si edhe fokusimit në drejtim të përmirësimit të rrjetit, sipërmarrësi One Telecommunications sh.a., i ka dhënë një nxitje konkurrencës në tregun e shërbimeve celulare.

Kjo gjë pasqyrohet edhe në rritjen e pjesëve të tregut për disa nga treguesit kryesorë:

- rreth 37% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card dhe SIM card aktivë;
- rreth 34% të tregut për thirrjet dalëse mobile;
- rreth 23% të tregut për volumin e të dhënave (internetit) nga rreth 24% në vitin 2019;
- rreth 36% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 32% në vitin 2019;
- rreth 34% dhe 33% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë, nga rreth 31% për të dy treguesit në vitin 2019.

Sipërmarrësi Albtelecom sh.a., me gjithë masat e ndërmarra, gjatë vitit 2020 nuk ka mundur të përmirësojë pozitat e tij në treg dhe ka shënuar rënie të lehtë të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2019. Rënien më të ndjeshme e ka shënuar për treguesin e trafikut të të dhënave të internetit:

- rreth 16% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card dhe SIM card aktivë;
- rreth 12.6% të tregut për thirrjet dalëse mobile;
- rreth 13% të tregut për volumin e të dhënave (internetit), nga rreth 16% në vitin 2019;
- rreth 15% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 16% në vitin 2019;
- rreth 13% dhe 14% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë nga rreth 14% për të dy treguesit në vitin 2019.

Vlen të theksohet, se në funksion të përballimit dhe lehtësimit të situatës pandemike, të tre operatorët celularë kanë ndërmarrë masa për përmirësimin e qëndrueshmërisë së rrjetit për garantimin e ofrimit të shërbimeve celulare me cilësi dhe pa ndërprerje.

Tarifat e shërbimeve të rrjeteve celulare dhe fikse

Operatorët celularë në ofrimin e shërbimeve të tyre aplikojnë tarifim në paketa dhe tarifim standard, i cili aplikohet nëse përdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njësitë përkatëse të përfshira në çmimin e paketës/ofertës, si dhe për përdoruesit me kontratë pas konsumit të njësive të përfshira në pagesën fikse mujore dhe/ose të paketave/opsioneve shtesë që mund të blejnë kjo kategori përdoruesish.

Tarifat standarde të thirrjeve jashtë paketave variojnë nga 10 - 39 lekë/minutë që janë disa herë më të larta se vlerat mesatare të tarifave për minutë brenda paketave.

Në mënyrë të ngjashme, edhe tarifimi për aksesin *broadband* jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin *broadband* në paketa (parapagim/paspagim).

Gjatë vitit 2020, thirrjet celulare si pjesë e paketave *bundle* zënë rreth 96.8% të thirrjeve totale, përkundërt 3.2% që zënë thirrjet me tarifa standarde dhe volumi i SMS brenda paketave arrin në 95.6%.

Larmia e gjerë e paketave në tregun celular synon t'ju ofrojë konsumatorëve mundësi të gjerë zgjedhje, të cilët mund të vendosin blerjen e paketës së tyre të preferuar në përputhje me nevojat dhe karakteristikat e secilit përdorues për njësi të ndryshme komunikimi internet/voice/sms, etj.

Në ndryshim nga periudhat e mëparshme, gjatë vitit 2020 është vërejtur aplikimi i gjerë i ofrimit të shërbimit internet pa limit pas përfundimit të njësive të përcaktuara në paketë, por me shpejtësi interneti të reduktuar.

Si shkak i pandemisë, gjatë vitit 2020 operatorët celularë kanë marrë iniciativë për rritjen e volumit të internetit dhe/ose uljen e çmimeve për disa paketa në shenjë solidarizimi ndaj situatës së COVID-19, për t'u ardhur kështu në ndihmë studentëve dhe kategorive të tjera të përdoruesve që e kanë të domosdoshëm komunikimin *online*.

Në ndryshim nga tregu i ofrimit të shërbimeve celulare, numri i operatorëve që ofrojnë shërbime interneti dhe shërbime të integruara nga rrjetet fikse është ndjeshëm më i lartë, por shtrirja e tyre në pjesën më të madhe ka karakter lokal. Numri i lartë i ofruesve të këtyre shërbimeve shoqërohet edhe me larmi të paketave që ofrohen në treg, kjo si në aspektin e çmimit, ashtu edhe të kombinimeve dhe njësive të përfshira.

Krahasimi i çmimeve të paketave të shërbimeve nga rrjetet fikse është i vështirë për t'u realizuar, dhe kjo për shkak se në pjesën më të madhe të tyre këto shërbime ofrohen të kombinuara.

Paketat e integruara (Bundles)

Tendenca e konsumit drejt paketave me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet, e shoqëruar me ndryshimet e cituara, ka çuar në krahasim më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm, dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit

celularë. Tendencia e operatorëve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi ditor, javor dhe mujor (30 ditor), duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS, edhe akses në Internet.

Për sa i përket tregut të ofrimin të shërbimeve nga rrjetet fikse, të dhënat e grumbulluara nga AKEP, tregojnë se shërbimi telefonik prej disa vitesh rezultoi të ketë marrë rol dytësor në shërbimet nga rrjete fikse, situatë kjo e ngjashme edhe me vendete e tjera të rajonit e më gjerë. Nxitësi kryesor i zhvillimit të rrjeteve fikse tashmë janë shërbimet e aksesit *broadband* dhe sidomos shërbimet e integruara (*duo*, *triple* dhe *quad play*).

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezultoi të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/TV) në fund të vitit 2020 arriti në rreth 292,000 rreth 9% më shumë se në vitin 2019.

Në publikimet periodike të informacionit mbi tarifën që kryen AKEP në faqen elektronike, në një seksion të veçantë bëhet krahasimi i paketave mes operatorëve, duke përdorur si bazë krahasimi periudhën e përdorimit të paketave dhe çmimet respektive të tyre.

Konkurrueshmëria

Tregjet e telefonisë celulare

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në mënyrë të vazhdueshme monitoron dhe analizon sjelljen e ofruesve të shërbimeve celulare, mbi bazën e të cilave, në përputhje edhe me praktikën ndërkombëtare, ushtron detyrat e tij për analizat e tregjeve në nivel shumice, duke përcaktuar dhe shpallur operatorët me Fuqi të Ndjeshme në tregjet përkatëse dhe duke vendosur masa rregullatore proporcionale dhe jodiskriminuese.

AKEP, ashtu si dhe organet rregullatore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, BEREC dhe vendet e rajonit, nuk e përfshijnë tregun e shërbimeve celulare me pakicë në listën e tregjeve të rregulluara *ex-ante* nga Rregullatorët, dhe për këtë arsye ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës, për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 703, datë 6.8.2020, “*Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom*”, ndër të tjera i rekomandoi AKEP që hedhja e paketave të reja nga secila ndërmarrje në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasimor, në zbatim kjo edhe të rregullores së AKEP nr.27/2012, “*Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”.

Në këtë kuadër, AKEP është angazhuar maksimalisht që në përputhje me parashikimet e bazës ligjore dhe rregullatorë të përcjellë informacion adekuat në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Autoritetit

të Konkurrencës, në funksion të nxitjes dhe promovimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet e komunikimeve elektronike.

Nga monitorimet e bëra nga AKEP është konstatuar se gjatë pjesës së dytë të vitit 2020 ka pasur një intensifikim i fushatave promociionale agresive të operatorëve celularë për të tërhequr konsumatorët duke ofruar paketa me çmime të ulëta (deri në 50%) sidomos për pajtimtarët që mbartin numrin nga një operator tjetër. Si rezultat, ka pasur një numër mjaft të lartë portimesh ku pajtimtarët kanë përfituar nga ofertat me zbritje, gjë që ka impaktuar edhe të ardhurat e operatorëve nga ky treg.

Aplikimi i fushatave promociionale agresive, kryesisht për portimin e numrit nga njëri operator tek tjetri, duke ofruar paketa me përmbajta dhe çmim preferencial, në një periudhë afatshkurtër prodhon efekte pozitive për konsumatorët, por mund të sjellë pasoja të rënda për konkurrencën. Aplikimi i paketave me çmime preferenciale dukshëm më të ulëta se paketat e tjera standarde, vë në vështirësi sipërmarrësit që konkurrojnë në këtë treg, kryesisht sipërmarrësit me pjesën më të vogël duke ulur kapacitetin financiar për rritjen e investimeve në rrjet.

Tregjet e rrjeteve fikse

Numri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri në fund të vitit 2020 është 260. Pjesa më e madhe e operatorëve alternativë janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.

Tregu i ofrimit të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë.

Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurron në segmente më të vogla dhe kryesisht janë ofrues lokalë.

Për vitin 2020, operatorët me pjesët më të madhe të tregut fiks, janë renditur si më poshtë:

- Albtelecom zotëron rreth 26% pjesë tregu;
- Abcom (Vodafone) zotëron 19% pjesë tregu;
- ASC zotëron 12% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 8% pjesë tregu;
- OA (operatorë të tjerë), me 35% të tregut, (operatorët me pjesën më të madhe në këtë kategori janë Digicom me rreth 4.5% të pjesës totale të tregut, dhe Nisatel me rreth 3.5%).

Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara. Rritja e theksuar në ofrimin e shërbimeve të kombinuara është bërë më e dukshme gjatë vitit 2020, kjo si rrjedhojë e bashkimit me përthithje nga ana e Vodafone Albania të sipërmarrësit Abcom.

Thirrjet ndërkombëtare dhe shërbimet roaming

Operatorët celularë në Shqipëri në një pjesë të konsiderueshme të paketave të tyre ofrojnë edhe njësi komunikimi ndërkombëtare, minuta dhe SMS të përfshira në paketë, si edhe paketa të dedikuara me përmbajtje vetëm minuta ndërkombëtare. Tarifat standarde ndërkombëtare, jashtë paketave, janë të ndara sipas disa zonave gjeografike dhe çmimet e tyre variojnë sipas këtyre zonave.

Roaming-u ndërkombëtar mundëson përdorimin e shërbimeve celulare jashtë territorit të vendit përkatës, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e operatorëve të huaj. Tarifat e roaming-ut ndërkombëtar që përdoruesit celularë paguajnë varen në masë të konsiderueshme nga tarifat me shumicë të aplikuara nga operatorët e huaj. Këto tarifa shpesh janë të larta, duke çuar në tarifa shumë të larta me pakicë për këto shërbime. Roaming-u është një ndër shërbimet që shpesh ka impakt të konsiderueshëm në faturën mujore të përdoruesve celularë, megjithatë, vitet e fundit operatorët ofrojnë paketa të dedikuara për përdorimin gjatë kohës në roaming me afat të ndryshëm vlefshmërie dhe përmbajtje të ndryshme interneti, minuta dhe SMS.



*Figure 5: Pamje nga Samiti Digjital i Tiranës i vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6), nëntor 2020
Burimi: Kryeministria 2020*



Figure 6: Kryetari i AKEP merr pjesë në punimet e Samitit Digjital të Tiranës të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6), nëntor 2020

Burimi: Kryeministria 2020

Ndryshimet e fundit thelbësore ndodhën në vitin 2019 lidhur me shërbimin Roaming mes Shqipërisë dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku, me vendimin nr. 21, datë 24.6.2019 të Këshillit Drejtues të AKEP, u miratua dokumenti “Rregullimi i tarifave të shërbimit Roaming ndërkombëtar mes Shqipërisë - Ballkanit Perëndimor”, si dhe me vendimet nr. 22, 23, 24, datë 24.6.2019, u miratuan dokumentet për rregullimin e tarifave të këtij shërbimi përkatësisht për sipërmarrësit One Telecommunications (ish-Telekom Albania), Vodafone Albania dhe Albtelecom.

Të tre operatorët celularë gjatë vitit 2020 kanë njoftuar tarifat e reja me vendet pjesë e marrëveshjes, ku aktualisht po aplikohet modeli RLAH+, dhe me datën 1 korrik 2021 pritet të hyjnë në fuqi tarifat e reja sipas modelit RLAH të plotë. Tarifat e reja të miratuara janë shumë të favorshme për abonentët që përdorin këtë shërbim në njërin nga vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe do t’u mundësojnë pajtimtarëve që kryejnë roaming në këto vende të komunikojnë njësitë e paketave që kanë brenda vendit.

Në funksion të përgatitjes së të gjithë bazës rregullatore për aplikimin me sukses të politikës RLAH të plotë, Këshillit Drejtues i AKEP me vendim nr.1, datë 14.1.2021, ka miratuar për Këshillim Publik Rregulloren “Mbi Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”. Kjo rregullore përcakton rregulla të detajuara për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të politikave të përdorimit të drejtë “Fair Use Policy” (FUP) që operatorët celularë të RSH-së mund të aplikojnë për konsumin e shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jonormal të shërbimeve të roaming-ut me pakicë nga pajtimtarët gjatë roaming-ut në vendet e BP.

1.2 Proceset transformuese në tregun postar

Sektori postar në Shqipëri ka kaluar një proces ndryshimesh të shtrira në kohë duke ndjekur modelin e vendeve të BE dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Transformimi ka kaluar nga ofrimi i shërbimeve postare tradicionale në kushte monopolistike, drejt një tregu të hapur në mënyrë graduale për konkurrencë, ku ofrimi i këtyre shërbimeve ndihmohet dhe nga zhvillimet teknologjike dhe modernizimi i infrastrukturës.

Sektori postar është sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare dhe përbën një nga sektorët me numrin më të madh të punonjësve në vend me mbi 3.076 të punësuar. Aktiviteti i sektorit postar drejtohet bazuar në legjislacionin respektiv (ligji 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij) dhe zhvillimi i tij nga udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentin e politikave postare të hartuara dhe miratuara nga Qeveria.

Tregu i shërbimeve postare ka ndryshuar ndjeshëm vitet e fundit. Një ndër ndryshimet kryesore është zhvendosja nga komunikimi tradicional i bazuar në letër, drejt komunikimeve me mjete elektronike, gjë që ka çuar në rënie të konsiderueshme të vëllimeve të objekteve postare. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi nxit rritjen gjithnjë e më shumë të vëllimeve të pakove postare (kolive postare) për shkak të rritjes së tregtisë elektronike (e-commerce).

Për tregun postar, kjo tendencë e rritjes së vëllimit të pakove postare të nxitura nga tregtia elektronike është bërë segmenti kryesor për hyrësit e rinj në treg, ofruesit e shërbimeve të dorëzimit të pakove postare, ku nga 26 operatorë që numëroheshin deri në fund të vitit 2020, tashmë ky numër ka arritur në 31 në fund të tremujorit të parë 2021.

Ndërthurja e shërbimeve tradicionale postare me shërbimet elektronike ka nxjerrë si domosdoshmëri modernizimin dhe digjitalizimin e infrastrukturës dhe logjistikës të cilat ndihmojnë në ofrimin me cilësi të shërbimeve. Kështu, për të rritur standardet e cilësisë së dorëzimit të objekteve postare, me shtimin e kolive postare, lojtarët e tregut po investojnë në rritjen e numrit të automjeteve. Shembull mund të merret “Posta Shqiptare” sh.a., që ka investuar në një flotë automjeteve ekologjike.

Krahas rritjes së konkurrencës, karakteristikë tjetër e tregut postar e evidentuar së fundmi, është dhe rritja e bashkëpunimit midis lojtarëve të tregut për përfitime reciproke, sidomos për shfrytëzimin në maksimum të kapaciteteve infrastrukturore.

Si shembull të këtij bashkëpunimi që u bë edhe më i dukshëm gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, është vijimi dhe marrja nga jashtë vendit i dërgesave postare të “Posta Shqiptare” përmes avionëve të DHL dhe FedEx, në një kohë kur fluturimet civile, me të cilët transportohen normalisht dërgesat e “Posta Shqiptare” sh.a., ishin të pezulluara. Gjithashtu, gjatë kësaj situatë AKEP ka bashkëpunuar me institucionet e tjera publike për të bërë të mundur krijimin e mundësive për qarkullim të lirë për automjetet e shërbimeve postare, për të mundësuar dorëzimin e produkteve dhe pagesave të pensioneve në adresat e qytetarëve.

Ndryshimet në këtë treg në tranzicion përbëjnë dhe sfida për rregullatorin, i cili ka si qëllim krijimin e një kuadri rregullator që nxit prezantimin e shërbimeve inovative, dhe, në të njëjtën kohë, dhe konkurrencën e ndershme. Rregullatori duhet të përcaktojë qartë rregullat e lojës për të parandaluar anomali që rrjedhin nga abuzimi i mundshëm i tregut si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ajo e ofertës.

Shërbimet postare në Shqipëri gjatë vitit 2020 u ofruan nga 27 subjekte të autorizuar me “Autorizim të Përgjithshëm”, nga 20 që ishin në vitin 2019. Prej tyre, “Posta Shqiptare” sh.a., është ofruesi i vetëm ofrimit të Shërbimit Universal Postar, ku, siç u specifikua më sipër, në vitin 2020 u rinovua Autorizimi Individual për ofrimin e këtij shërbimi edhe për 5 vite të tjera.

Tregues të volumit të tregut postar

Tregu i ofrimit të shërbimeve postare përgjatë vitit 2020 është ndikuar në mënyrë të ndjeshme nga efektet e pandemisë, duke diktuar tkurrje të volumeve të përpunuara, kryesisht atyre ndërkombëtare.

Numri total i objekteve postare të pranua gjatë vitit 2020 nga “Posta Shqiptare” dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 24.7 milionë, një rënie me rreth 4% krahasuar me vitin 2019. Kjo tkurrje ka ardhur si rezultat i tkurrjes së volumit të shërbimeve postare të Postës Shqiptare, e kundërta ka ndodhur me volumet e pranua nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, të cilat përgjatë vitit 2020 kanë shënuar rritje për të gjithë treguesit e shërbimit jo-universal dhe atij ekspres. Rritjen më të madhe e ka shënuar shërbimi jo-universal postar për postën brenda vendit me rreth 174%, ndërkohë edhe shërbimi postar ekspres brenda vendit ka shënuar rritje me rreth 39% krahasuar me vitin 2019. Rritje ka shënuar edhe posta ndërkombëtare, por kjo rritje ka qenë në nivele më të ulëta, rreth 10-13%.

Efektet e mbylljes si shkak i pandemisë, kryesisht gjatë tremujorit të dytë 2020, kanë bërë që ofruesit e shërbimeve tregtare si edhe ato financiare të zhvendosen nga metodat e prezencës fizike në dyqane drejt kryerjes dhe marrjes së këtyre shërbimeve *online* dhe me korrier (postë).

Të ardhurat dhe investimet e tregut postar

Ofruesit e shërbimeve postare raportuan 2,8⁹miliardë lekë të ardhura nga këto shërbime, shifër e cila përbën një rritje me rreth 18% krahasuar me të ardhurat e gjeneruara për vitin 2019 (2,4miliardë lekë).

Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron ofruesi i shërbimit universal “Posta Shqiptare” sh.a., me një total të ardhurash 1,5 miliardë lekë, pothuajse në të njëjtin nivel si viti 2019, nga të cilat rreth 1,3 miliardë lekë janë të ardhura të gjeneruara nga shërbimi universal.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 1,3miliardë lekë një rritje me rreth 59% krahasuar me vitin 2019 (825 milionë lekë).

Ecure mjaft pozitive kanë shënuar edhe investimet e kryera në sektorin postar, të cilat në fund të vitit 2020 raportohen mbi 363 milionë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë investimet e bëra nga “Posta Shqiptare” sh.a., me rreth 92% të totalit.

Tregues të volumit të shërbimit universal postar

Viti 2020 ka qenë një vit sfidash për të gjithë sektorët e ekonomisë, edhe Shërbimi Universal postar si pjesë e konsiderueshme e tregut vendas ka ndjerë efektet dhe pasojat e shkaktuara nga kjo pandemi.

9 Të ardhurat mund të ndryshojnë në varësi të raporteve të auditimit dhe raportimit në AKEP

Tregues të numrit të objekteve të Shërbimit Universal Postar

	2017	2018	2019	2020	Ndryshim 2020/2019
Total shërbim Universal Postar	19,922,420	19,711,717	21,501,005	18,390,874	-14.5%
<i>Postë brenda vendit</i>	18,599,662	18,298,143	20,348,070	17,487,538	-14.1%
<i>Postë ndërkombëtare</i>	1,322,758	1,413,574	1,152,935	903,336	-21.6%
Objekte të regjistruara	2,985,376	3,158,376	4,181,775	2,371,759	-43.3%
Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	1,152,935	903,336	-21.6%
<i>Objekte Ndërkombëtare Dalëse</i>	362,415	334,696	344,930	202,823	-41.2%
<i>Objekte Ndërkombëtare Hyrëse</i>	960,343	1,078,878	808,005	700,513	-13.3%

Burimi: Të dhëna nga “Posta Shqiptare” sh.a.

Të dhënat e mësipërme për vitin 2020, paraqesin një tkurrje të theksuar të treguesve të shërbimit universal postar, kryesisht volumit të objekteve postare, kjo e ndikuar thellësisht nga situata pandemike e shkaktuar nga Covid-19, pasi deri në vitin 2019 këta tregues kanë qenë me rritje të vazhdueshme.

Disa nga arsyet kryesore që kanë ndikuar në rënien e treguesve të shërbimit universal postar renditen si më poshtë:

- përballimi i pandemisë Covid-19 kërkoi mbylljen e bizneseve dhe kufizimin e lëvizjes së popullatës në fasha të caktuara orare për një periudhë të konsiderueshme kohore, duke sjellë ndërprerje të korrespondencave ndërmjet bizneseve (B2B), bizneseve me konsumatorët (B2C) dhe anasjelltas, dhe duke penguar paraqitjen e klientëve në sportelet e “Posta Shqiptare” për shfrytëzimin e shërbimeve postare;
- kalimi në punën në shtëpi (telepunë) i administratës qendrore dhe lokale, në përgjithësi ndikoi në reduktimin e përdorimit të postës së letrave dhe rriti përdorimin e postës elektronike (e-mail);
- situata e pandemisë Covid-19, solli ndërprerje të fluturimeve civile për disa muaj, duke ndërprerë dhe vijimin e rregullt të postës ajrore. Për kryerjen e shërbimit postar ndërkombëtar u bashkëpunua me DHL dhe FedEx, duke vijuar dërgesat postare me avionët e këtyre kompanive postare.

1.3 Proceset e monitorimit dhe inspektimit në tregjet e mbikëqyrura nga AKEP

Veprimtaria e AKEP për vitin 2020 është bazuar dhe udhëhequr në drejtim të plotësimit të rolit, funksioneve dhe objektivave rregullatorë të përcaktuara në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe postare.

Vlen të theksohet se inspektimi është një hallkë e rëndësishme e AKEP për përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në zbatimin e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura. Inspektimi në vetvete, sipas përcaktimeve ligjore që e rregullojnë, ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Ky qëllim i veprimtarisë së inspektimit arrihet

nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit si dhe dokumentimit të praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre. Inspektimi mund të arrijë efektivitet maksimal nëse kryhet në kushtet e një bashkëpunimi reciprok dhe me përgjegjshmëri me subjektet e inspektimit.

Objektiv tjetër strategjik i strukturës së inspektimit në AKEP, edhe sipas përcaktimeve ligjore është të vijojë të jetë partnere e sipërmarrësve dhe një kontributore aktive në fuqizimin e mirëoperimit dhe llogaridhënies publike, në funksion të promovimit të transparencës, efeciencës në treg, efektivitetit dhe zbatueshmërisë ligjore. Në këtë kuadër thellimi i luftës kundër informalitetit është në fokus të veprimtarisë inspektuese.

Gjatë vitit 2020, strukturat inspektuese të AKEP, në përmbushje të objektivave të planit vjetor të inspektimit kanë realizuar inspektimin e një pjese të subjekteve të komunikimeve publike sipas këtij planit vjetor, pasi për shkak të pandemisë Covid 19, dhe në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore u vendos pezullimi i monitorimeve dhe inspektimeve të programuara për të vijuar në një moment të dytë.

a) Inspektim i Programuar

(subjekte ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve elektronike)

Subjektet, ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve elektronike, të cilat u programuan për inspektim nga struktura përgjegjëse në terren gjatë vitit 2020, u përzgjedhën duke u bazuar në disa kritere.

- subjekte, të cilët nuk ishin inspektuar dy vitet e fundit, pra në vitet 2018 - 2019;
- subjekte të cilat kategorizohen me nivel të lartë risku;

Risi e planit të inspektimit për vitin 2020 ishte përfshirja në procedurën inspektuese edhe e Regjistrarëve të Domain-eve. Në këtë plan u përcaktuan në detaje veprimtaria e inspektimit që do ndërmerrej gjatë vitit tek Regjistrarët e Domain-eve, tematikat kryesore, si dhe kontrolli i ligjshmërisë në zbatimin e përcaktimeve të rregullores nr. 2, datë 21.2.2008, “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”.

Në Planin Vjetor të Inspektimit për subjektet e komunikimeve elektronike ishin planifikuar të inspektoheshin në terren 56 subjekte, në kushtet e krijuara gjatë vitit 2020 u inspektuan vetëm 10 subjekte.

Sipas planit vjetor ishte parashikuar të inspektoheshin 8 Regjistrarë të Domain-eve. Aktualisht rezulton se gjatë vitit 2020 u inspektuan vetëm 2 Regjistrarë. Pas përfundimit të inspektimit është dhënë masa administrative (dënim kryesor) “Paralajmërim” për 1 subjekt dhe dënim plotësues në formën e rekomandimit për një tjetër.

Në planin vjetor të inspektimit për vitin 2020 ishin programuar të inspektoheshin të gjithë subjektet që ofronin shërbime postare të regjistruar në Regjistrin e Shërbimeve Postare, pra 16 subjekte. Për shkaqet objektive dhe pezullim të procesit të inspektimit nga situata pandemike, rezultojnë se u inspektuan vetëm 3 subjekte postare. Për të tre këto subjekte janë dhënë dënime plotësuese në formën e rekomandimeve.

Në vitin 2020 u përfundua procesi i inspektimit të ofruesit të shërbimit universal “Posta Shqiptare” sh.a., filluar në vitin 2019.

Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, datë 18.2.2020, u vendos masa administrative “Gjobë” ndaj ofruesit të shërbimit postar “Posta Shqiptare” sh.a., gjobë e cila u la në fuqi edhe nga Këshillit Drejtues i AKEP, pas ankimit administrativ të Postës Shqiptare.

Pas vendimit të Këshillit Drejtues, subjekti “Posta Shqiptare” sh.a., ushtroi të drejtën e ankimit edhe pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Më datë 2.3.2021, gjykata vendosi rrëzimin e kërkesë padisë të paditësit “Posta Shqiptare” sh.a., dhe lënien në fuqi të masës administrative të vendosur nga AKEP.

Përveç pjesës së masës administrative “Gjobë”, AKEP ka vendosur për Ofruesin e shërbimeve postare “Posta Shqiptare” sh.a., rekomandimet si më poshtë:

- Të marrë masa organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40, të ligjit 46/2015.
- Të marrë masa për rishikimin e vendimi nr. 5, datë 30.1.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare, dhe rishikimin e vendimit nr. 24, datë 17.6.2014, “Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimeve postare të Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a.” (*shërbimi i lajmërimit për tërheqjen e pakove postare*), me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare.
- Të marrë masa për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore dhe teknike me qëllim plotësimin e kërkesave të nenit 31, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

Një moment tjetër i rëndësishëm në zbatimin e misionëve të inspektimit ka qenë edhe inspektimi i tre operatorëve celularë. Ky inspektim, i cili u zhvillua nga data 23.12.2020 deri më 25.02.2021 ishte pjesë e planit vjetor, por menjë dimension më akut për shkak të intesifikimit të problemeve për portimin e numrit.

Pas inspektimit të 3 sipërmarrësve të rrjeteve publike celulare “One Telecommunications” sh.a., “Vodafone Albania” sh.a., dhe “Albtelecom” sh.a., struktura inspektuese e AKEP konstatoi tek të 3 sipërmarrësit shkelje të përcaktimeve të Rregullores nr. 43, datë 22.9.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, shkelje të cilat klasifikohen si kundërvajtje administrative për të cilat parashikohen dënime administrative “gjobë” dhe dënime administrative plotësuese në formën e rekomandimeve sipas nenit 137, të ligjit nr. nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b) Inspektimi në distancë

Krahas inspektimeve të programuara në terren, struktura përgjegjëse inspektuese e AKEP, në zbatim të Rregullores nr. 46, datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” si dhe Urdhrit nr. 343 prot., datë 7.6.2018, “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës të inspektimit dhe monitorimit”, realizoi inspektime në distancë duke verifikuar rreth 180 sipërmarrës që zhvillojnë veprimtarinë në rrjetet elektronike.

Përshkrim i objektit të inspektimit ishte verifikimi i zbatimit të:

1. Detyrimit mbi plotësimin dhe dërgimin e Formularit G mbi të dhënat statistikore për 3 mujorin e parë të vitit 2020; (Rregullore nr. 12, datë 7.4.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”),
2. Detyrimit të raportimit të treguesve të cilësisë së 6 mujorit të dytë të vitit 2019; (Rregullore nr. 16, datë 16.4.2010, “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”).
3. Kryerjes së pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave në AKEP sipas afateve; (neni 78, i ligjit 9918//2008).
4. Kryerjes së pagesave për caktimin dhe përdorimin e numeracionit në AKEP sipas afateve, njoftimeve dhe rinjoftimeve; (neni 86, i ligjit 9918//2008).

Në përfundim të procedurave inspektuese me objekt verifikimin e përmbushjes së detyrimeve rregullatore ndaj AKEP, rezultoi se:

Për subjektet të cilët i përmbushën detyrimet rregullatorë ndaj AKEP, nuk u morën masa administrative, pasi u vlerësua edhe situata me të cilën është përballur i gjithë vendi prej pandemisë Covid 19 si dhe shfaqja e vullnetit pozitiv të subjektit për përmbushjen e detyrimeve pas komunikimeve me grupin e inspektimit.

Për subjektet (21 subjekte) të cilat edhe në përfundim të procedurës inspektuese nuk i përmbushën detyrimet rregullatorë ndaj AKEP, u morën masa administrative kryesore “Gjobë” (në rastet kur subjekti ishte përsëritës në shkeljen e konstatuar) si dhe masa “Paralajmërim” (kur shkelja konstatohet për herë të parë), shoqëruar me vendimin plotësues të përmbushjes së detyrimeve rregullatorë në mënyrë të menjëhershme. Në total janë marrë 21 masa administrative “gjobë” me vlerën totale 270.000 lekë.

2. Sfidat e Administrimit eficient të brezave të frekuencave

2.1 Risia e përfuturit të sistemit të automatizuar të menaxhimit të frekuencave

Duke marrë në konsideratë:

- nevojat e institucionit për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullatore për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në administrimin e kërkesave që vijnë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike;
- detyrimet e përcaktuara në VKM nr. 636, datë 29.7.2020, “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”;
- detyrimet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2574, datë 22.5.2015 “Për Miratimin e dokumentit “Plani i Investimeve afatmesme në Sistemet e Teknologjisë dhe Informacionit 2015-2018””;
- detyrimet rregullatore me qëllim administrimin sa më efektiv të spektrit të frekuencave dhe kryerjen e inventarizimit të tij;

AKEP ndërmoi masat e nevojshme për administrimin e spektrit radio me programe kompjuterike bashkëkohore të mundshme për t’u përditësuar sipas praktikave dhe përcaktimeve të PKF, RR- ITU dhe Tabelës ECA.



Figure 7: Qendra Kombëtare e Monitorimit të Frekuencave
Burimi: AKEP 2020

Megjithëse procedurat e prokurimit publik u pezulluan në pjesën e parë të vitit për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, AKEP arriti të kryente me sukses procedurën ligjore të prokurimit publik, duke bërë kështu të mundur implementimin e Sistemit të Avancuar të Administrimit të Spektrit të Frekuencave.

Ky investim përmbush të gjitha kriteret e rekomanduara nga ITU për mënyrën se si duhet të operojnë “Sistemet Automatike të Avancuara të Menaxhimit të Spektrit”.

Automatizimi i procesit të administrimit të spektrit të radiofrekuencave bëhet i domosdoshëm kur sasia e të dhënave që do të përpunohen është e madhe dhe janë të nevojshme studime analitike komplekse, dhe kështu ky sistem sjell këto risi:

- Përgjigje më të sakta dhe të optimizuara për kërkesat e caktimit të frekuencave, nëpërmjet zgjedhjes së kanaleve të përshtatshme duke marrë parasysh detaje të tilla si karakteristikat e terrenit.
- Verifikim të kërkesave të bëra me Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin Kombëtar të Përdorimit dhe Tabelës Ndërkombëtare të Alokimeve të Frekuencave.
- Kryerje të analizave të thelluara inxhinierike për të shmangur interferencat.
- Shkëmbim elektronik të të dhënave midis administratave dhe ITU-së.



Figure 8: Salla qendrore e menaxhimit dhe monitorimit të frekuencave në AKEP (2021)

Burimi: AKEP 2020

Gjithashtu, sistemi i implementuar mundëson lehtësimin e detyrave specifike rregullatore në mirëmenaxhimin e Spektrit të frekuencave, dhe lejon përdorimin sa më efikas të brezave të frekuencave, sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Vendimeve / Rekomandimeve ndërkombëtare CETP/ITU.

Nëpërmjet tij, realizohen analiza të thelluara inxhinierike mbi caktimin e frekuencave, interferencat dhe koordinimin, duke lejuar stafin e AKEP të përmbushë në mënyrë profesionale detyrat rregullatore, në lidhje me administrimin e spektrit.

Koordinimi ndërkombëtar dhe njoftimi i caktimeve të frekuencave, sipas përcaktimeve të Radio Rregulloreve të ITU dhe modeleve të softeve përkatëse të ITU, e ndihmojnë AKEP në vlerësimin e brezave të frekuencave për sistemet dhe rrjetet ekzistuese të komunikimeve elektronike dhe ato të reja që mund të zhvillohen, duke mos shkaktuar interferenca në vendet fqinje dhe të rajonit.



Figure 9: Trajnimi i punonjësve të AKEP nga shoqëria kontraktuese për sistemin e avancuar të administrimit të spektrit të frekuencave

Burimi: AKEP 2021

2.2 Inventarizimi dhe planifikimi i vënies në eficiencë të plotë të brezave 700Mhz, 800Mhz, 1450Mhz dhe 3800Mhz

Një nga detyrat e lëna nga Rezoluta Kuvendit, miratuar në muajin korrik 2020, ishte që AKEP t'i japë përparësi vënies në eficiencë të plotë të brezave të paalokuar, në përfitim të qytetarëve dhe konsumatorëve, pasi të ketë kryer analiza lidhur me dhënien në përdorim të spektrit, përfshirë këtu edhe kombinimet teknike të tij, bazuar në programin e politikës spektrale në nivel kombëtar.

Gjithashtu Planit Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të *Broadband*, miratuar me VKM nr.434, datë 3.6.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale *Broadband* 2020-2025”, në lidhje me brezin 800MHz, ka përcaktuar dhënien në përdorim të frekuencave të lira deri në fund të vitit 2022.

Në këtë kontekst, caktimi i pjesës së mbetur të pashfrytëzuar të spektrit të frekuencave në brezin 800MHz dhe brezave të tjerë që ndihmojnë zhvillimin e rrjeteve të gjeneratës së ardhshme, ka bërë që AKEP të ketë në dispozicion të tij, disa mjete mbi qasjet më të mira të praktikave evropiane për menaxhimin e spektrit si dhe vlerën e tyre.

Për këtë, AKEP në gjysmën e dytë të vitit, ka kryer procedurat e prokurimit për të marrë shërbimin e konsulentëve ndërkombëtarë për dhënien në përdorim të brezave të lirë të frekuencave si dhe kombinimet midis tyre. Shërbimi i konsulencës u mundësua nga një shoqëri gjermane me mjaft eksperiencë në këtë fushë. Kjo kompani ka kryer konsulencë në fushën e komunikimeve elektronike për qeverinë gjermane dhe autoritetin rregullator gjerman ashtu edhe për vendet e BE dhe Regional Cooperation Council (RCC). Realizimi i kësaj detyre, vjen në përputhje të plotë me disa përcaktime ligjore të përcaktuara në ligjin 9918/2008, i ndryshuar, për:

- Përdorim sa më efikas të spektrit të frekuencave nga operatorët celularë në Shqipëri;
- Respektim të parimit të paanshmërisë (neutralitetit) teknologjik;
- Nxitjen e investimeve eficiente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre.
- Nxitjen e konkurrencës eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera.
- Mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- Mbrojtjen e interesave të sigurisë publike.
- Mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Ky shërbim konsulence ndihmoi për të analizuar për herë të parë brezat e frekuencave 800 MHz, 1452 – 1492 MHz dhe 3400 – 3800 MHz, nga një perspektivë teknike, ligjore dhe ekonomike, si dhe kombinimet e mundshme të tyre.

Konsulenca ka dhënë një tablo të qartë të situatës aktuale në lidhje me disponueshmërinë e brezit me bandë të gjerë dhe të lëvizshme, teknologjitë e përdorura, investimet në tregun e telekomunikacionit dhe një shqyrtim të Planit Kombëtar *Broadband 2020 - 2025*, me fokus të veçantë në strategjinë e frekuencave. Shoqëria konsulente ka paraqitur rekomandimet për veprimet që duhen ndërmarrë, si për hartimin e tenderit, alokimin e frekuencave, ashtu edhe për çmimin e spektrit të frekuencës.

Rekomandimet për veprim janë formuluar në formën e tre skenarëve, të cilët korrespondojnë me tre objektiva të mundshëm për t'u ndjekur nga Autoriteti Rregullator.

Si rezultat i analizës së kryer, u identifikuan fushat e mëposhtme të veprimit, të cilat kanë një rëndësi të veçantë për shqyrtim të mëtejshëm në lidhje me brezat e frekuencave dhe të cilat përfshihen në vlerësimin e tyre për:

- Eliminimin e një boshllëku të konsiderueshëm digjital në mbulimin me brez të gjerë ndërmjet zonave rurale dhe urbane, e cila vjen kryesisht për shkak të një mungese të konsiderueshme të infrastrukturës së përshtatshme për krijimin e aksesit me brez të gjerë, në zonat rurale.
- Përmirësimin e mbulimit territorial me shërbimet 4G, pasi një pjesë e madhe e mbulimit me frekuenca të rrjeteve 4G, pritet të përqendrohen aktualisht në zonat urbane dhe akset e rrugore të transportit.
- Futjen graduale të teknologjisë së gjeneratës së ardhshme, bazuar në zgjerimin e mëtejshëm me 4G.
- Akses me brez të gjerë përmes ofertave të komunikimit celular, për shkak të përdorimit në rritje të lëvizjeve të ofertave me brez të gjerë dhe një infrastrukture joadekuate me tela në zonat rurale, si një zëvendësim për aksesin e rrjetit fiks.

Zhvillimi i kësaj konsulence, ka sjellë disa risi për AKEP, ndër të cilat mund të veçojmë:

- Janë studiuar dhe janë paraqitur eksperiencat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Rajonit, për brezat e frekuencave që janë në proces studimi.
- Janë studiuar dhe janë paraqitur masat e autoriteteve rregullatore të këtyre vendeve, për brezat e frekuencave (në proces studimi).
- Rekomandimet trajtojnë gjerësisht dhe me saktësi, mundësitë teknike, veprimet ligjore, çmimin e secilit brez dhe aktet që duhet të miratohen.
- Rekomandimet janë të mundshme për t'u aplikuar në Shqipëri, në varësi edhe të nevojave të tregu

Brezi 700 MHz

Brezi 700 MHz (694-790 MHz) vlerësohet si shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbulimit me brez të gjerë, veçanërisht në zonat që paraqesin zhvillime të qëndrueshme, të tilla si zonat rurale, malore ose të largëta. Ky brez është i përshtatshëm për të siguruar mbulim efikas mbi fusha të gjera dhe mbulim të përmirësuar të brendshëm, duke u përshtatur si për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të komunikimeve mobile të ofruara nga teknologjitë 4G, ashtu edhe për vendosjen e teknologjive të reja të komunikimit mobil të gjeneratës së ardhshme të njohura si 5G ose IMT - 2020.

Frekuencat në brezin 700 MHz do të zgjerojnë burimet e spektrit nën 1 GHz që tashmë përdoren për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve mobile me brez të gjerë përmes teknologjisë LTE dhe do të lehtësojnë vendosjen e rrjeteve 5G dhe futjen e gjerë të shërbimeve digjitale inovative.

Kombet e Bashkuara vlerësojnë se 5G do të ketë një ndikim të madh jo vetëm në sektorin digjital, por në ekonominë në tërësi. Sidomos përkundër sfondit të vendosjes së ngadaltë të 4G dhe shërbimeve përkatëse, nisja e suksesshme e 5G në BE konsiderohet si vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për konkurrencën dhe produktivitetin e ekonomisë.

Caktimi i brezit të frekuencave 700 MHz duhet të strukturohet në funksion të lehtësimit të konkurrencës dhe duhet të kryhet në atë mënyrë që nuk e 'minon' konkurrencën ekzistuese.

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve

shqiptarë dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, përdorimin efektiv të spektrit si dhe përmbushjen e objektivave rregullatore.

Digjital Dividenti i dytë ose rialokimi i brezit 700 MHz (694-790 MHz), për shërbimet e lëvizshme *Broadband* (Mobile Broadband – MBB) është alokuar kryesisht për shërbimet audiovizive.

Në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit të ITU të vitit 2015, u mor një vendim kyç që do të ofrojë kapacitete më të mëdha në brezin e frekuencave 694-790 MHz në Rajonin 1 të ITU-së (ku bën pjesë edhe Shqipëria) dhe kjo do të jetë një zgjidhje e harmonizuar globalisht për zbatimin e dividendit digjital.

Vendimi i Komisionit Evropian, datë 17 maj 2017, përcakton se deri më 30 qershor 2020, vendet anëtare duhet të lirojnë brezin 700 MHz, nga përdorimet radiotelevizive. Ndërsa deri në 30.6.2022, duhet t'i kenë dhënë në përdorim frekuencat e brezit 700 MHz për operatorët celularë, për ofrimin e shërbimeve tokësore të lëvizshme *Broadband*.

Në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit të ITU të vitit 2019, përfundimisht, brezi 700 MHz u përcaktua për rrjetet celulare për ofrimin e shërbimeve *broadband* (me shpejtësi të larta).

Rekomandimet e BE për vendet anëtare janë që, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, vendet anëtare të BE duhet të lëshojnë të drejtat për përdorimin e brezit të frekuencave 700 MHz (Autorizimet Individuale).

Aktualisht brezi 700 MHz, në Shqipëri është në përdorim nga disa operatorë audiovizivë. Ky brez administrohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Pas lirit, ky brez do të kalojë nën administrimin e AKEP, për t'u dhënë në përdorim për operatorët e rrjeteve celulare.

Për lirimin e këtij brezi, me iniciativën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është përfituar një konsulencë nga ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve), konsulencë e cila ka filluar në muajin shtator 2020 dhe përfundon në prill të vitit 2021.

Kjo konsulencë synon t'i mundësojë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), zgjidhjet më të mira teknike të lirit të këtij brezi nga operatorët audiovizive.

AKEP ka dhënë opinionin e tij dhe ekspertizën ligjore, në komunikim të vazhdueshëm edhe me ekspertët e ITU, për përgatitjen e dokumentacionit dhe akteve të dala për politikën spektrale.

Pas lirit nga AMA, ky brez do të kalojë në administrim të AKEP, për t'u tenderuar për dhënie në përdorim të operatorëve celularë.

2.3 Proceset e monitorimit të përdorimit të frekuencave nga AKEP

Proceset e monitorimit të spektrit të frekuencave dhe të të drejtave të përdorimit

Në referim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP është përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës për monitorimin e përdorimit të spektrit të

frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave.

Me qëllim ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, AKEP ka organizuar aktivitetin vjetor të monitorimit të spektrit të frekuencave si më poshtë:

a) Monitorim fiks i spektrit të frekuencave nga Stacionet Fikse.

Ky monitorim kryhet me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit të frekuencave RFMS dhe SRMF, me qëllim ofrimin e të dhënave të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, ofrimin e informacioneve të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vendeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimit e transmetimeve jashtë brezi;

b) Monitorimi i lëvizshëm i spektrit të frekuencave.

Ky monitorim ka për qëllim monitorimin e frekuencave të radiolidhjeve fikse në pikat kryesore transmetuese të Republikës së Shqipërisë me qëllim verifikimin e përdorimit të frekuencave të dhëna me autorizim, i cili duhet të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;

c) Monitorim i frekuencave për nivelin e rrezatimit të fushës elektromagnetike (EMF).

Ky monitorim kryhet në ndihmë të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, gjithashtu edhe me kërkesë të publikut në lidhje me nivelet e rrezatimeve në ambientet e banuara.

d) Monitorimi i spektrit të frekuencave për Cilësinë e Shërbimit për Shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Ky monitorim ka për qëllim mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimit të telefonisë mobile me qëllim evidentimin e zonave problematike me cilësi të dobët shërbimi dhe nxitjen e operatorëve për përmirësim të mëtejshëm në këto zona për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Shërbimi i monitorimit vëzhgon spektrin radio dhe krahason nëse përdorimi i spektrit përputhet me politikën e administrimit të spektrit, duke bërë të mundur përcaktimin e rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundravajtjeve administrative nëpërmjet monitorimit të spektrit të frekuencave për respektimin e kushteve teknike të Autorizimit Individual.

Planifikimi vjetor i monitorimit të spektrit bazohet kryesisht në vlerësimin periodik të përdorimit të brezit dhe rekomandimeve të ITU mbi caktimet për brezat e rinj të frekuencave.

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin nr. 9918/2008 dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përcaktuara në Autorizimet Individuale të përdorimit të frekuencave, AKEP kryen

në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave radio.

Qëllimi i monitorimit të spektrit është të mbështesë procesin e administrimit të spektrit në përgjithësi, përfshirë funksionet e caktimit të frekuencave dhe planifikimit të spektrit.

Në mënyrë specifike, objektivat e monitorimit janë:

- Të ndihmojë në zgjidhjen e interferencave të spektrit elektromagnetik, në shkallë lokale, rajonale, apo me gjerë, pra që shërbimet radio dhe stacionet të mund të bashkekzistojnë në pajtueshmëri, duke reduktuar dhe minimizuar burimet shoqëruese me instalimin dhe operimin e shërbimeve të telekomunikacionit, duke siguruar përfitim ekonomik për infrastrukturën e vendit nëpërmjet aksesit në shërbime të telekomunikacionit pa interferenca;
- Të sigurojë të dhëna të vlefshme nga monitorimi për procesin e administrimit të spektrit elektromagnetik nga administrata lidhur me përdorimin aktual të frekuencave dhe brezave (p.sh., zënia e kanaleve dhe brezave), verifikimin e karakteristikave teknike dhe operacionale të sinjaleve të transmetuara, detektimin dhe identifikimin e transmetuesve ilegalë, gjenerimin dhe verifikimin e regjistrimit të frekuencave;
- Të sigurojë informacion të vlefshëm monitorimi për programet e organizuar nga ITU, p.sh., në përgatitjen e raporteve të Konferencave të Radiokomunikacioneve, me synimin e një ndihmese speciale për administratat në gjetjen e frekuencave të përshtatshme.

A. Monitorimi i spektrit të frekuencave me anë të stacioneve fikse

Monitorimi i spektrit të frekuencave është kryer nëpërmjet stacioneve të monitorimit:

- **RFMS – Krujë dhe RFMS – Pinet për brezin e frekuencave 20 MHz deri në 3000 MHz**

Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) të vendosura në Pinet dhe Krujë kanë pajisjet e nevojshme për monitorimin e frekuencave dhe gjetjen e drejtimit me metodologjinë AOA dhe janë të kontrolluara në distancë nga MCC, nëpërmjet software-it të monitorimit ARGUS. Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) në Pinet dhe Krujë realizojnë monitorimin e spektrit të frekuencave në brezin 20 – 3000 MHz.

- **SRFMS – Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Fier për brezin e frekuencave 20 – 8500 MHz.**

Stacionet Fikse të Thjeshtuara të Monitorimit (SRFMS) të cilat janë të instaluar në rajonet Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Fier disponojnë pajisjet e nevojshme për monitorimin e frekuencave dhe gjetjen e drejtimit me metodologjinë AOA dhe kontrollohen në distancë nga MCC në Tiranë dhe Zyrat Rajonale në Shkodër, Vlorë, Korçë nëpërmjet software-it të monitorimit SCORPIO CLIENT. Stacionet Fikse të Thjeshtuara të Monitorimit (SRFMS) realizojnë monitorimin e spektrit të frekuencave në brezin 20 – 8500 MHz.

Kontrolli i sistemit të monitorimit realizohet nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), e cila është vendosur në zyrat në Tiranë dhe zyrat rajonale Vlorë, Korçë dhe Shkodër.



Figure 10: Stacioni fiks i monitorimit të frekuencave në Vlorë

Burimi: AKEP 2020



Figure 11: Stacioni fiks i monitorimit të frekuencave në Vlorë

Burimi: AKEP 2020




Figure 12: Zyra Rajonale për monitorimin dhe inspektimin në Korçë

Burimi: AKEP 2020



Figure 13: Zyra Rajonale e monitorimit dhe Inspektimit në Vlorë
Burimi: AKEP 2020



Figure 14: Qendra kryesore e Kontrollit (MCC) në mjediset e AKEP në Tiranë
Burimi: AKEP 2020

Nga këto zyra është e mundur të kontrollohen në distancë të gjithë Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) dhe Stacionet e Thjeshtë Fiks të Monitorimit (SRFMS).

Detyra më e rëndësishme e monitorimit me anë të stacioneve fikse është mbledhja e të dhënave mbi përdorimin e spektrit radio të frekuencave radio.

Të dhënat e përftuara nga monitorimi i spektrit të frekuencave do të shërbejnë në vijimësinë e punës duke mbledhur informacionin e nevojshëm mbi përditësimin e planit të përdorimit të frekuencave i cili hartohet dhe përditësohet në mënyrë periodike, për të siguruar një përdorim efektiv dhe pa interferenca të frekuencave.

Gjithashtu të dhënat nevojiten për përcaktimin e rregullave lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e operimit lidhur me operimin e radio sistemeve.



Figure 15: Pajisje monitoruese për shërbimin tokësor të lëvizshëm
Burimi: AKEP 2020



Figure 16: Analizator për monitorimin e spektrit të frekuencave deri në 8 Ghz
Burimi: AKEP 2020

B. Monitorimi i spektrit të frekuencave të lidhjeve fikse radio

Monitorimi i spektrit të frekuencave të radiolidhjeve fikse është realizuar nëpërmjet stacioneve të lëvizshme të monitorimit Mobile Monitoring Station – MMS. Stacionet e monitorimit janë shumëqëllimësh, ato janë të pajisur me të njëjtat pajisje si RFMS, si dhe me një komplet pajisjesh portative, në mënyrë që të kryejnë gjithë tipet e matjeve speciale, p.sh., tek lidhjet radio fikse (radio reletë apo radio linket) ose matësit e intensitetit të fushës elektromagnetike. Me anë të MMC janë kryer operacione monitorimi në të gjithë vendin.

Qëllimet kryesore të përdorimit të këtyre pajisjeve gjatë vitit 2020 kanë qenë verifikimi i përputhshmërisë ligjore dhe administrative të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual të AKEP, me qëllim që përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave të AKEP.

*Figure 17: Parku i Stacioneve të lëvizshme të monitorimit të frekuencave
Burimi: AKEP 2020*





*Figure 18: Stacion i lëvizshëm i monitorimit të spektrit
Burimi: AKEP 2020*



Figure 19: Pamje gjatë procesit të monitorimit të radiolidhjeve fikse



Figure 20: Pamje gjatë procesit të monitorimit të radiolidhjeve fikse
Burimi: AKEP 2020

Kryerja e monitorimit në kuadër të veprimtarisë vjetore të monitorimit të spektrit të frekuencave, për monitorimin e radiolidhjeve fikse, u realizua në vendndodhjet kryesore ku janë instaluar pajisjet transmetuese të sipërmarrësve, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Vendi ku janë kryer matje	Qyteti	Periudha e matjeve
1	Kodër Mucaj, Ardenicë	Vorë, Fier	Gjatë muajit Janar
2	Grabjan, Ligoj	Lushnjë, Fier	Gjatë muajit Shkurt
3	Sopot, Qafe Gjshtë	Gjirokastrë, Sarandë	Gjatë muajit Korrik
4	Midë, Tregtan	Pukë, Peshkopi	Gjatë muajit Gusht
5	Kërculle, Gllavë	Gjirokastrë, Tepelenë	Gjatë muajit Shtator
6	Zvërnec, Llogara, Himarë	Vlorë, Himarë	Gjatë muajit Tetor
7	Pepellash, Çarshovë	Kolonjë, Përmet	Gjatë muajit Nëntor
8	Kodër Durrës	Tiranë, Durrës	Gjatë muajit Dhjetor

Pikat transmetuese kryesore në të cilat është kryer monitorim i spektrit të frekuencave.



Figure 21: Paraqitja gjeografike e pikave kryesore të transmetimit në Republikën e Shqipërisë
Burimi: AKEP 2020

Gjatë vitit 2020 AKEP ka realizuar monitorimin në 16 pika kryesore transmetuese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

C. Trajtim i ankesave për interferenca të dëmshme

Rastet e raportuara të interferencës tregojnë se shumica e tyre lidhet me frekuencat e përdorura për transmetimet *broadband* GSM, UMTS dhe LTE në frekuencat që përdorin operatorët e rrjeteve të lëvizshëm.


Për këto lloje interferencash, stacionet monitoruese fikse nuk janë gjithmonë të përshtatshëm, meqenëse identifikimi i problemit në këto raste kërkon të identifikohet dhe përdoret drejtimi i sinjalit interferues që, në përgjithësi, operon me një fuqi të ulët dhe në një zonë të ngushtë veprimi. Metoda më praktike dhe tipike në monitorimin e interferencave është kombinimi i stacioneve fikse me pajisjet e stacionit të lëvizshëm të monitorimit për të rritur efikasitetin në hetimin e interferencës.

Për të bërë të mundur identifikimin e plotë të burimit të interferencës shpesh është i nevojshëm të kryhet inspektimi i pajisjeve radio, kur stacioni radio i cili është identifikuar si përgjegjës për një ankesë specifike për interferencë. Inspektimi, i kryer qoftë si pjesë e një pune të programuar, apo në përgjigje të një ankese specifike për interferencë, synon të sigurojë që instalimi është në përputhje me kushtet për përdorimin e tij, dhe që pajisja radio operon në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi të shkaktojë interferencë të padëshiruar.




Figure 22: Punë monitoruese të spektrit të frekuencave për interferenca të dëmshme
Burimi: AKEP 2020


Gjatë vitit 2020 rastet e interferencave të trajtuara paraqiten si më poshtë:



Rastet e interferencave të trajtuara gjatë vitit 2020.



Rastet e interferencave të administruara dhe trajtuara gjatë vitit 2020.



Ndërhyrjet sipas llojit të pajisjes dhe shkakut të ndërhyrjeve të konfirmuara

Përmes procedurave të tilla si testimi dhe etiketimi i 27 burimeve të mundshme të interferencës është bërë e mundur të zbulohen dhe korrigjohen ndërhyrje të tilla si emetues të konfiguruar gabimisht dhe jo të autorizuar, pasi është shkaktuar ndërhyrja dhe është bërë një ankesë.

Gjithashtu, konstatohet se gjatë vitit 2020 pati një nevojë në rritje për përdorimin e rrjeteve komunikuese, ku shpeshherë trafiku në komunikim arriti në vlerat limit. Kjo dukuri shpeshherë identifikohet si interferencë nga vetë sistemi, në disa raste ka përkuar edhe me ndryshimet dhe investimet e operatorëve për përmirësimin dhe rritjen e kapacitetit të komunikimit në rrjet, gjë e cila shoqërohet me vështirësitë në optimizimin e rrjetit.

D. Monitorimi i spektrit të frekuencave për rrezatimin e fushës elektromagnetike (EMF)

Nisur nga ndjeshmëria e lartë e interesit publik në lidhje me rrezatimet dhe për të ardhur në ndihmë pajtimtarëve dhe jo vetëm, gjatë vitit 2020 AKEP ka realizuar një fushatë monitorimi të nivelit të fushës elektromagnetike pranë institucioneve publike me ndjeshmëri të lartë siç janë shkollat, kopshtet, çerdhet dhe spitalet, edhe pse në ndërtesën e tyre nuk janë të instaluar antena radiotransmetuese.

Në lidhje me ekspozimin ndaj emetimeve të fushës elektromagnetike (EMF), AKEP nuk vendos nivelet e sigurisë së emetimit dhe nuk ka as ekspertizën e as përgjegjësinë për të marrë pjesë në çështjet që kanë të bëjnë me hulumtimet biologjike apo shëndetësore. AKEP është i kufizuar në kryerjen e matjeve të mostrave të niveleve të emetimeve.

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi në Republikën e Shqipërisë (KMRR) ka detyrë ligjore për të vendosur rregullat mbi Fushat Elektromagnetike (EMF) dhe shëndetin, ku përfshihen edhe vlerësimet mbi njohuritë shkencore dhe udhëzimet për ekspozimin e sigurtë në EMF.



*Figure 23: Pamje të procesit të matjes së rrezatimit jojonizues pranë antenave transmetuese të telefonisë celulare
Burimi: AKEP 2020*

Matje pranë antenave transmetuese janë kryer në rastet kur është kërkuar nga qytetarë të ndryshëm, të cilët kanë ngritur shqetësimin pranë AKEP për prezencën e antenave celulare në afërsi të banesave ku ata jetojnë. Kryerja e monitorimit i frekuencave për nivelin e rrezatimit të fushës elektromagnetike (EMF) në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me qëllim rritjen e rolit dhe kontributit të AKEP pranë Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet, gjithashtu informimin e publikut në lidhje me nivelet e rrezatimeve në ambientet e përditshmërisë.

Matjet për monitorimin e nivelit të rrezatimit të fushës elektromagnetike janë realizuar me anë të metodës *broadband measurement* në brezin e frekuencave 8 kHz – 8 000 MHz.

Rezultatet e këtyre matjeve të regjistruara deri tani tregojnë se nivelet e rrezatimeve të emetuara nga antenat celulare nuk e tejkalojnë pragun e sigurisë së përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jojonizues (ICNIRP).

Të dhënat e matjeve të mbledhura nga terreni përpunohen në raportet teknike dhe bëhen publike në faqen elektronike të AKEP, më qëllim informimin e publikut si dhe vlerësimin e të dhënave nga Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet e cila ushtron funksionet pranë KMR.

Gjatë vitit 2020 janë kryer në total 175 matje, 18 prej tyre të programuara dhe 2 me kërkesë të subjekteve.

3.

Strategjitë për përforcimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në një mjedis global të paqendrueshëm

3.1 Ndërveprimi institucional për standardizimin e ndërtimit të infrastrukturave aktive dhe pasive në kushtet e zhvillimit të teknologjive të brezit të ri.

Zhvillimi i rrjeteve të shërbimeve të gjeneratave të reja, si atyre fikse dhe atyre të lëvizshme, është një proces ndëraktiv ku pjesëmarrësit kryesorë janë: pushteti qendror, pushteti lokal, rregullatorët dhe sipërmarrësit.

Pavarësisht bazës ligjore ekzistuese, për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësit po përballen me vështirësi, sidomos në:

- procesin për pajisjen me leje të ndërtimit,
- zbatimin e akteve nënligjore lidhur me të drejtën e kalimit,
- moskthimin e investimit në zonat rurale dhe të largëta,
- mbështetjen vetëm në sektorin privat për të investuar në infrastrukturë,
- mungesën e mekanizmave mbështetës me financime publike, duke pasur parasysh këtu krijimin e fondit të Shërbimit Universal për shërbimet broadband,
- problematikat që lidhen me alokimin dhe tarifimin e spektrit të frekuencave.

AKEP gjatë vitit 2020 ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë operatorët e rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në zhvillimin e infrastrukturave fizike aktive dhe pasive të tyre, dhe, për këtë qëllim, padyshim që partneri kryesor në një qasje strategjike është MIE.

Gjithashtu, AKEP ka dhënë ekspertizën e tij teknike pranë MIE në plotësimin e akteve nënligjore të ligjit 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” për të përcaktuar rregullat dhe kërkesat për instalimin e rrjeteve fikse *broadband* në godina, rregullat dhe procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, metodologjitë e llogaritjes së tarifave për të drejtën e aksesit dhe atë të kalimit etj.

Një prej qasjeve strategjike e cila lidhet direkt në reduktimin e kostove të operatorëve dhe për pasojë nxitjen e investimeve në ndërtimin e infrastrukturave ka qenë bashkëpërdorimi i infrastrukturave pasive dhe aktive si për rrjetet fikse, ashtu dhe ato të lëvizshme. Përvoja e mirë e bashkëpërdorimit të infrastrukturave për mbulimin me shërbime të komunikimeve elektronike mobile të disa prej zonave turistike do të jetë në fokus edhe në vijim në vitin 2021.

Është e njohur tashmë se pjesën më të madhe të kostove të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike e zë kostoja e ndërtimit të infrastrukturës, për rrjedhojë zvogëlimi sa më tepër i tyre, do të mundësonte një zhvillim më të shpejtë. Sigurisht, mënyra më e mirë për të arritur këtë është “*infrastructure sharing*”, pra përdorimi i përbashkët i infrastrukturës.

Përgjatë vitit 2020 AKEP ka përgatitur një raport mbi evidentimin e problematikave dhe propozimet për zgjidhjet përkatëse lidhur me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike si dhe menaxhimin e shtrirjes së rrjeteve në mjediset urbane.

Duke qenë se infrastruktura është hallka më e rëndësishme dhe delikate për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të tregut të telekomunikacionit, është kërkuar organizmi i takimeve me Bashkinë e Tiranës për të orientuar, lehtësuar dhe nxitur me tej këtë zhvillim.

Edhe gjatë vitit 2020, brenda kushteve dhe mundësive të limituara, vijoi puna me qëllim përmirësimin e rrjeteve në qytetet kryesore të vendit, shmangien e rrjeteve të komunikimeve elektronike nga rrjetet e energjisë.

Gjatë gjithë vitit 2020 AKEP ka vijuar të mbikëqyrë vazhdimisht punën e sipërmarrësve të rrjeteve për largimin dhe sistemimin e kablllove të rrjeteve të tyre dhe ndërhyrjen në fasadat e apartamenteve në disa zona të nxehta të Tiranës.

Sipërmarrësit kanë bashkëpunuar me inspektorët e AKEP në trajtimin e problematikave të raportuara nga qytetarët, të cilët kanë kërkuar sistemimin e godinave të banimit dhe ambienteve përreth nga kabllot ajrore.

Vërehet gjithashtu rritje e përgjegjshmërisë së sipërmarrësve të rrjeteve ndaj këtij problemi, pasi sistemimet e kablllove, pas largimit nga shtyllat, bëhen në mënyrë më të kujdesshme dhe tentohet drejt instalimeve të teknologjive bashkëkohore me preferencë fibrën optike ku, siç dihet, një fibër optike zëvendëson shumë kablllo të tjera.

3.2 Procesi i përpunimit të sistemit të përqendruar të informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)

3.2.1 Situata aktuale e sistemit të përqendruar të informacionit ATLAS

Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS) është ngritur dhe operon që prej vitit 2012, mbështetur në përcaktimet ligjore, ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullore nr. 26, datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

AKEP është caktuar institucioni përgjegjës për ngritjen dhe administrimin e Sistemit të Përqendruar të Informacionit, i cili përfshin regjistrin elektronik me të dhënat e përcjella nga sipërmarrësit dhe përditësohet me informacionin e ri të ardhur prej tyre. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar që rrjetin e tyre ta regjistrojnë në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike ATLAS.




Figure 24: Sistemi i përqendruar i informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (ATLAS).
Burimi: AKEP 2020

Gjatë vitit 2020 është vijuar me përditësimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (ATLAS) nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

Në fund të vitit 2019 AKEP, me të gjitha bashkitë e vendit, ndërmori procesin për regjistrimin e rrjetit të tyre të infrastrukturës të telekomunikacionit në ATLAS.

Në këtë kuadër, në muajt e parë të vitit 2020, u kryen 2 trajnime me disa bashki, mbi përdorimin dhe regjistrimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit ATLAS.

Procesi do të vazhdojë edhe me bashkitë që nuk janë paraqitur në trajnim dhe që janë ende të patrajnuara në lidhje me përdorimin e sistemit dhe hedhjen e të dhënave. Duhet theksuar se pavarësisht komunikimit dhe detyrimeve të bashkive dhe ARRSH për përditësimin e të dhënave si operatorë rrjeti, sasia dhe cilësia e të dhënave të hedhura në sistem ka mangësi.

Gjatë vitit 2020 AKEP ka vijuar bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në lidhje me depozitim periodik të të dhënave për rrjetet e komunikimeve elektronike në formatin GIS (*shapefile*) për pasqyrimin e tyre në sistemin kombëtar të informacionit gjeohapësinor i cili administrohet dhe menaxhohet nga ASIG.

3.2.2 Qasja strategjike e mbledhjes, përpunimit të të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike

Duke analizuar mangësitë që shfaq sistemi aktual i ATLAS, AKEP në bashkëpunim MIE kanë vendosur përditësimin e sistemit me qëllim plotësimin e të gjitha kërkesave për një sistem koherent në raport me zhvillimet e kohës dhe sistemet e tjera që administrohen nga rregullatorët evropianë.

Për këtë qëllim, në fillim të vitit 2020, Komiteti Kombëtar i Investimeve (KPS/KPI) miratoi listën e projekt-investimeve që do të aplikoheshin nga Shqipëria në kuadër të thirrjes së 23-të, të Kuadrit të Investimeve

të Ballkanit Perëndimor, në të cilën u përfshi edhe projekti “Për Zhvillimin e Atlasit të *Broadband* të Shqipërisë dhe përdorimin e tij në sektorin publik dhe privat”.

AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë përgatitën aplikimin pranë WBIF, i cili u shpall si një prej projekteve fituese për financim, duke qenë të bindur që zhvillimi i sistemit të ATLAS do të jetë një investim me një rëndësi strategjike për vitet në vijim.

Ky projekt ka për qëllim përmirësimin/zhvillimin e sistemit ekzistues ATLAS, përditësimin e këtij sistemi me informacionin deri në përdoruesin fundor, informacionin mbi përdorimin e Internetit me bandë të gjerë në Shqipëri, ofruesit e rrjetit në një zonë të caktuar, informacionin mbi zonat e bardha si edhe mbulimin e shërbimeve celulare, bazuar në praktikën dhe modelet më të mira ndërkombëtare. Ky projekt, përveç zhvillimit të sektorit privat, do të ketë impakt edhe në shtrirjen e rrjeteve të Internetit me shpejtësi të lartë në institucione shtetërore si shkolla, qendra shëndetësore, njësi administrative etj.

Vlen të theksohet se sistemi i ri do të jetë në përputhje me VKM nr. 998, datë 20.12.2020 “Standardet Shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema : Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, ku të dhënat e dërguara nga ATLAS në geoportal të ASIG duhet të jenë automatike dhe në kohë reale sipas këtij standardi të ri.

3.3 Bashkërendimi strategjik me aktorët e tregjeve të komunikimeve elektronike për kalimin tërësor në rrjete, pajisje dhe teknologji të sigurtë dhe të pastra

SFIDAT PËR IMPLEMENTIMIN E RRJETEVE TË SIGURTA DHE TË PASTRA NË SHQIPËRI

Sfida e sigurisë së rrjeteve dhe teknologjive të pastra

Kriza sanitare gjatë vitit 2020, e shkaktuar nga pandemia COVID-19, nxori edhe më shumë në pah situatën e brishtë në të cilën ndodhen, nga pikëpamja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjeteve, sistemeve dhe teknologjive, komponentët kryesorë të shoqërisë digjitale në nivel global që përgatiten për një tranzicion të përsheptuar drejt gjeneratës së re të telekomunikacioneve. Vitin e kaluar, më shumë se 1/3 e sulmeve kibernetike kanë pasur të bëjnë me punën *online*. Në vende të ndryshme të BE, një në pesë biznese ka deklaruar se ka qenë objekt i të paktën një sulmi kibernetik përmes *ransomware* gjatë vitit të kaluar. Më shumë se gjysma e këtyre sulmeve kanë shkaktuar pasoja në tregjet e biznesit me impakt të menjëhershëm në zinxhirin e prodhimit në më shumë se 1/4 e rasteve.

Autorët e sulmeve kibernetike dhe parazitimit dashakeq të rrjeteve janë shfaqur gjatë gjithë vitit të kaluar në forma nga më të ndryshmet. Përgjegjës për to janë individë, por edhe entitete më të organizuara dhe gjymtyrë organizmash të caktuar me ndikim të rëndësishëm në sferat publike dhe private globale. Ndërkohë, nga viktimat e shpërdorimit dashakeq të mjeteve digjitale, askush nuk është i përjashtuar, qoftë individët, bizneset, bota akademike, shërbimet publike dhe komponentët strategjikë të ekonomive kombëtare dhe shteteve.

Përgjatë vitit 2020 edhe sipërmarrësit që operojnë në tregjet shqiptare kanë raportuar sulme kibernetike

pranë AKEP, por, fatmirësisht në numër të kufizuar. Pas marrjes së informacionit të detajuar të përcjellë, dhe duke parë kërkesat dhe përcaktimet e rregullores nr.37, datë 29.10.2015 “Mbi Masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP ka kërkuar disa informacione shtesë nga sipërmarrësit, të tilla si:

- vlerësimin e impaktit të incidentit të sigurisë;
- planin e detajuar të incidenteve dhe nëse është aplikuar ky plan mbi pajtimtarët;
- nëse shërbimi ka kaluar automatikisht përmes linjës backup me qëllim rikthimin sa më shpejt dhe vazhdimin e ofrimit të shërbimit tek pajtimtarët;
- nëse është kryer njoftimi në kohë i pajtimtarëve në lidhje me këtë incident kritik të sigurisë;
- masat e marra për parandalimin dhe reagimin në kohë ndaj sulmeve të tilla në të ardhmen.

Ndërhyrjet dashakeqe, të paligjshme dhe të dëmshme në sferën digjitale nuk shfaqen vetëm në formën e sulmeve. Ato nuk synojnë vetëm mashtrimin, grabitjen apo tjetërsimin e elementëve konfidencialë. Të organizuara dhe të bashkërenduara nga aktorë të fuqishëm, të strukturuar në forma vështirësisht të gjurmueshme, jashtë çdo juridiksioni gjyqësor efektiv apo kontrolli demokratik, këto ndërhyrje mund të jenë të konfiguruar paraprakisht në zemrekun e sistemeve, teknologjive dhe rrjeteve në përdorim të përditshëm dhe të kthehen në ndërfaqe të mbledhjes, stokimit, trajtimit dhe përdorimit të të dhënave personale, tregtare, të pronësisë intelektuale apo të sigurisë kombëtare dhe ndërveprimeve në kuadër të aleancave dhe partneriteteve strategjike. Si të tilla, ato përbëjnë një kërcënim të madh të përbotshëm dhe vënë në pikëpyetje sovranitetin kombëtar, funksionimin e shtetit të së drejtës, garantimin e të drejtave themelore dhe mbrojtjen e interesave të qytetarit, parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme si dhe sigurinë publike. Rreziku afatgjatë që ato paraqesin për besueshmërinë e një shoqërie digjitale demokratike shumëfishohet nga përpjekjet për t’u shtrirë kudo nëpërmjet teknologjive dhe rrjeteve të brezit të ri, më veçanërisht 5G.



*Figure 25:
Konferenca ndërkombëtare
për sigurinë e 5G
(Prague's Proposals)
Burimi: www.vlada.cz*

Në këtë kontekst, përvoja e viti 2020 theksoi nevojën për t'iu qasur sa më parë dhe në mënyrë realiste standardeve të rekomanduara një vit më parë, në maj 2019, nën emrin “Propozimet e Pragës” (*Prague's Proposals*), dalë nga konferenca ndërkombëtare për sigurinë e 5G, në të cilën, mes 32 vendeve anëtarë të BE dhe të NATO-s, mori pjesë edhe Republika e Shqipërisë. Në bazë të këtyre rekomandimeve, përveç parimeve kryesore në harmonizimin e qasjeve ndaj sfidave të sigurisë së 5G, qëndron domosdoshmëria, në zhvillimin e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri, e dallimit preventiv mes ofruesve të rrjeteve, shërbimeve dhe pajisjeve të besueshëm dhe atyre të dyshimtë që mund të jenë apo të vendosen në shërbim të entiteteve të rrezikshme dhe dashakeqe. Dallimi mes këtyre dy kategorive, jetik për sigurinë kolektive të mbarë shoqërisë digjitale, themelohet mbi kritere objektive, proporcionale dhe të mbështetura në respektimin e të drejtave të njeriut, të shtetit ligjor dhe të konkurrencës së lirë dhe të ndershme.



Nismat e AKEP

Nga pikëpamja e kuadrit ligjor dhe rregullator, AKEP ka detyrime specifike përkundrejt mbikëqyrjes dhe verifikimit të operimit të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, sidomos përmes kontrollit të zbatimit të kushteve të autorizimit të përgjithshëm, për sa i takon:

- Përbushjes së angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizata ndërkombëtare;
- Mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit;
- Mbrojtjes së interesit publik. (neni 15 i ligjit 9918/2008).

Gjithashtu, rregullorja nr. 37, e datës 29.10.2015, e ngarkon AKEP me misionin për t'i përcaktuar sipërmarrësve një sërë detyrimesh, midis të cilëve edhe atë të implementimit të mjeteve dhe metodave të duhura teknike dhe organizative, për të garantuar sigurinë e rrjeteve të komunikimit publik dhe të shërbimeve të ofruara prej tyre. Këto mjete duhet të garantojnë nivelin e sigurisë, në përputhje me rrezikun e paraqitur dhe të shmangin ndodhjen e incidenteve të sigurisë ose të reduktojnë impaktin apo pasojat kur këto incidente ndodhin. Detyrime të tjera në këtë aspekt janë edhe:

- Implementimi i mjeteve të duhura teknike dhe organizative për të garantuar integritetin e rrjeteve të komunikimit publik, duke siguruar në këtë mënyrë ofrimin e pandërprerë të shërbimeve të tyre;
- Menaxhimi dhe mbrojtja e pajisjeve dhe sistemeve të përdorura për ruajtjen e të dhënave të përdoruesve të rrjeteve të komunikimit publik dhe/ose shërbimeve;
- Sigurimi i një niveli mbrojtjeje dhe sigurie të përshtatshëm ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara.

Zbatimi i këtyre detyrimeve nga sipërmarrësit, verifikohet edhe gjatë veprimtarisë së inspektimit që ushtron AKEP.

Kuadri ligjor dhe rregullator, por edhe standardet që burojnë nga marrëveshje shumëpalëshe në themel të aleancave institucionale ku bën pjesë vendi ynë, apo nga dokumente dhe qëndrime në kuadër të partneriteteve strategjike në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, nxisin një vëmendje të posaçme ndaj sfidave të integritetit të rrjeteve dhe teknologjive të sigurta. Në këto kushte, gjatë vitit të kaluar, AKEP ka nisur një reflektim shumëplanësh, bazuar mbi shkëmbime dhe dialog të hapur me sipërmarrësit, autoritetet publike, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, në mënyrë që të përftohet një platformë e qartë bashkëveprimi për një tranzicion të sigurtë drejt gjeneratës së re të telekomunikacioneve.



Një udhërrëfyes mjaft i rëndësishëm në këtë aspekt mbetet për AKEP edhe paketa *European Union's 5G Toolbox*.

Nisma e AKEP ka synim të trefishtë:

- Të vlerësojë, nëpërmjet mbledhjes së informacionit, në respekt dhe brenda kufijve të konfidencialitetit të të dhënave, riskun që paraqesin pajisjet dhe teknologjitë që përdorin sipërmarrësit për zhvillimin, përmirësimin apo zëvendësimin e komponentëve me natyrë të spikatur sensitive të rrjeteve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- Të rekomandojë mekanizma vetërregullimi apo të përcaktojë kriteret rregullatore orientuese për sipërmarrësit, për të ndihmuar në shmangien e përdorimit në Shqipëri të teknologjive të pasigurta dhe operimin agresiv në tregjet shqiptare të ofruesve dhe prodhuesve të dëmshëm ose të dyshimtë, në respekt të parimit të *net neutrality* dhe të së drejtës tregtare;
- Të nxisë sipërmarrësit në migrimin gradual, në kuadër të zhvillimit të rrjeteve 4G+ - 5G, drejt teknologjive 100% të sigurta dhe të standardizuara, në përputhje me parimet në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

Për sa i përket dy çështjeve të para, AKEP do të shqyrtojë edhe mundësinë e ngritjes në të ardhmen të një Laboratori Kombëtar të Telekomunikacioneve, realizimi i të cilit do të kushtëzohet nga përfundimi i një mbështetje institucionale dhe teknike masive, nga rekrutimi i burimeve njerëzore të specializuara dhe nga fonde adekuate.

Krijimi i një Laboratori Kombëtar të Telekomunikacioneve do të krijojë një mjedis unik testimi për operatorët, prodhuesit dhe ofruesit, që të përputhen me kërkesat dhe specifikimet e tyre për të vlerësuar performancën teknike dhe sigurinë e pajisjeve në rrjetet përkatëse - kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme për ofruesit e rinj dhe në zhvillim, duke u dhënë mundësinë për të demonstruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e pajisjeve që do të hidhen në treg.

Laboratori do të testojë në mënyrë të pavarur sigurinë, qëndrueshmërinë dhe performancën e pajisjeve të rrjetit në kushte të ndryshme - duke siguruar qasje në shembuj përfaqësues, operacionalë të rrjeteve telekomunikuese kritike të gjeneratës së re.

Laboratori do të ketë si mision:


- Sigurimin e hapësirës për të ndërmarrë kërkime në lidhje me sigurinë e telekomunikacioneve;
- Mundësimin ndaj operatorëve, ofruesve, autoriteteve publike dhe botës akademike, si dhe enteve të tjera, të instrumenteve për të kapërcyer sfidat e sigurisë;
- Krijimin e një mjedisi të sigurt operimi për të menaxhuar ndjeshmërinë tregtare dhe nevojat e Sigurisë Kombëtare;
- Ndihmën ndaj ofruesve dhe operatorëve për të përputhur termet e tyre teknike me kornizën e sigurisë së telekomunikacioneve të përdorura për shërbime publike apo qëllime strategjike qeveritare, duke lehtësuar dhe ulur kostot e një procesi të tillë;
- Mbështetjen ndaj diversifikimit të zinxhirit të furnizimit duke u siguruar ofruesve të rinj akses në mjedise ku ata mund të demonstrojnë aftësitë e ndërveprimit dhe sigurisë;
- Lehtësimin e kërkimeve mbi sigurinë nga fundi në fund si dhe për kryerjen e hulumtimeve që synojnë lexueshmërinë e realiteteve të vendosjeve të rrjetit;
- Sigurimin e një vëzhgimi të përhershëm mbi parametrat e sigurisë mbi një gamë të gjerë të teknologjive të telekomunikacioneve, duke përfshirë sistemet e trashëguara, aktuale dhe të ardhshme që ka të ngjarë të përdoren në infrastrukturën tonë fikse dhe mobile;
- Mbështetjen e zhvillimit të aftësive në telekomunikacione dhe sigurinë e telekomunikacioneve, në veçanti krijimin e një kuadri kombëtar me burime të vlefshme dhe me përvojë.

Deri në fund të vitit 2020, dialogu institucional i ndërmarrë nga AKEP me këto premisa ka sjellë rezultate, siç janë mbledhja e informacioneve me rëndësi, të cilat kanë qenë një hap i parë drejt konceptimit të një vlerësimi më të plotë dhe të gjerë të kapaciteteve aktuale për implementimin e teknologjive të brezit të ri në

vendin tonë. Ky vlerësim, i cili, gjatë vitit 2021 do t'i nënshtrohet një procesi konform parametrave më të mirë ndërkombëtarë, do të hetojë arkitekturën dhe formatet e sigurisë së rrjeteve, së bashku me sfidat që shfaq secili komponent i teknologjive 5G, rregullat mbi operacionet e sigurt, monitorimin dhe kufizimet e *outsourcing* të funksioneve, etj.

Një rezultat i qenësishëm i dialogut ka qenë edhe nisma shembullore e operatorit të dytë në tregun celular, One Telecommunications, i cili, duke zgjedhur të bëhet pjesë e iniciativës ndërkombëtare “*Clean Networks*”, të iniciuar nga SHBA, është angazhuar të mos përdorë pajisje transmetuese, kontrolli, kompjuterike apo ruajtje nga kompani të përcaktuara si të pasigurta dhe jashtë mundësisë për të përmbushur kriteret e besueshmërisë ndërkombëtarisht të pranuar.

Dialogu me të gjithë aktorët e sektorit do të vijojë edhe gjatë vitit 2021, duke qenë një përparësi për institucionin.



4. Përdoruesi në fokus: arritjet në promovimin e të drejtave të konsumatorëve

4.1 Risitë e Rregullores së konsoliduar të Konsumatorit

Dokumenti “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” është një akt rregullator i rëndësishëm për përmbushjen e objektivave të ligjit 9918/2008, strategjisë dhe politikave të sektorit të komunikimeve elektronike, plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe procesit të integritetit në BE.

Dokumenti u miratua nga Këshilli Drejtues i AKEP në datën 11.3.2021, pas përfundimit të procesit të këshillimit publik të nisur më datë 30.9.2020. Rregullorja do të hyj në fuqi për zbatim 6 muaj pas miratimit të saj.

Dokumenti i publikuar për këshillim publik për vetë rëndësinë dhe kompleksitetin e tij, u bazua në përfundimet dhe diskutimet me palët e interesit të draft-rregullores përgjatë këshillimit publik të parë të zhvilluar në vitin 2019, takimeve me operatorët në fillim të vitit 2020, si dhe në rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2020.

Në një kapitull të veçantë të rregullores, AKEP përfshiu masat e propozuara për garantimin e aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuar sipas nenit 102/1, të ligjit 9918/2008, si dhe hartoi plotësime/ndryshime të pjesëve të tjera të rregullores, duke marrë në konsideratë dokumentat përkatës më të fundit të KE në lidhje me kontratat e pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Në kuadër të këshillimit publik të rregullores, dhe specifikisht, të Kapitullit për personat me aftësi të kufizuar, AKEP bashkëpunoi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për identifikimin dhe koordinimin e takimeve me shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Në vijim të komunikimeve me grupe të interesit/shoqata/organizata, AKEP mundi të realizojë e të marrë komente dhe sugjerime mbi propozimet e rregullores nga institutet/shoqatat e mësipërme, si dhe hodhi në draft një kapitull të veçantë për personat me aftësi të kufizuar, risi në këtë rregullore.

Rregullorja e miratuar synon një mbrojtje më të mirë të të drejtave të konsumatorit dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet përcaktimit të rregullave më të qarta për të drejtat tyre në marrëdhëniet me sipërmarrësit, duke përfshirë:

- detyrime më të qarta për termat dhe kushtet të cilat duhet të përfshihen dhe të jenë pjesë përbërëse në kontratat e pajtimit për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- rregulla të qarta për aksesin në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen e informacionit të vendndodhjes së pajtimtarit për këto thirrje, përfshirë thirrjet drejt numrit unik të emergjencave 112;
- saktësime për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave;
- rregulla më të qarta për trajtimin e ankesave nga operatorët dhe mbajtjen e rekordeve të tyre si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtarë - sipërmarrës;
- kushtet për transparencën dhe publikimin e informacionit nga ofruesit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- masa për garantimin e aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

“Rregullorja për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” përmban:

- përcaktimet e AKEP për rregullimin e marrëdhënieve të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike me pajtimtarët;
- harmonizim me rekomandimet dhe direktivat e BE-së, dokumentet e BEREC dhe praktika në disa vende të BE-së në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit fundor të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- përshtatje me kushtet aktuale të tregut shqiptar të komunikimeve elektronike dhe problemet e hasura në marrëdhëniet sipërmarrës-pajtimtar;
- marrjen në konsideratë të komenteve të palëve të interesuara, si sipërmarrësit, shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.
- konsolidimin e disa akteve të AKEP në lidhje me të drejtat e pajtimtarëve në një akt të vetëm.

Lidhur me krijimin e regjistrit *Do Not Call Me*, si detyrë e vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e vitit 2020, përgjatë vitit 2020 AKEP ka vijuar bashkëpunimin e nisur në vitin 2019 me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDIP) për propozimin e AKEP për krijimin e regjistrit *Do Not Call Me*.

AKEP ka marrë pjesë në Grupin e Punës ndërinstitucional të udhëhequr nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për hartimin e projektligjit “*Për krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të Pa kërkuara*”.

Në përfundim të këtij procesi diskutimi, KMDIP ka hartuar projektligjin, i cili është duke ndjekur procedurën përkatëse të miratimit. Në këtë projektligj është përcaktuar që regjistri *Do Not Call Me* të popullohet/krijohet me të dhëna nga qytetarët/konsumatorët në komunikim të drejtpërdrejtë me KMDIP, i cili parashikohet të jetë edhe administratori i këtij regjistri të *Komunikimeve Tregtare të Pa kërkuara*.

4.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit

A. Monitorimi i cilësisë së shërbimit postar

Në zbatim të ligjit nr. 46/2015 «Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë» ofruesi i shërbimit postar “Posta Shqiptare” sh.a., ka detyrimin e raportimit periodik pranë AKEP për cilësinë e shërbimit universal postar.

Gjatë vitit 2020, ofruesi i shërbimit postar “Posta Shqiptare” sh.a., edhe në kushtet kufizuese të diktuar nga pandemia globale Covid 19, organizoi trajnime të pjesshme me punonjësit e filialeve të ndryshme, në lidhje me standardet e shërbimit universal postar për pjesëmarrjen e “Posta Shqiptare” në projektin e UPU-së të *GlobalMonitoring Sistem*.

Gjithashtu, u organizuan teste të brendshme për të monitoruar proceset operacionale të punës ndërmjet zyrave postare (fshati, qyteti) dhe sektorëve të përpunimit, shpërndarjes, tranzitimit të objekteve dhe dërgesave postare deri në dorëzimin e objektit tek marrësi.

Viti 2020 ishte një vit i vështirë, pasi pandemia COVID 19 përfshiu të gjithë botën, dhe kufizimet e kësaj situate jo të zakonshme ndikuan në kufizimin e shkëmbimeve të dërgesave postare, si pasojë e anulimeve dhe numrit të ulët të fluturimeve të shumë linjave ajrore, duke shkaktuar vonesa mujore në mbërritjen në destinacion të objekteve postare.

Kushtet e mësipërme mbarëbotërore, ndikuan dhe në ecurinë e realizimit të projektit G.M.S. (Global Monitoring System) WORLD, pasi transporti ndërkombëtar i testeve, si një ndër kushtet kryesore të projektit, u bllokua nga mbyllja përkohësisht e linjave ajrore. Në kushtet e kësaj situate, operatorët postarë, pjesëmarrës në këtë projekt, u detyruan që transportin e dërgesave postare ta alternonin duke përdorur dhe rrugëtimet tokësore, të cilat sollën vonesa mujore në mbërritjen e dërgesave postare në destinacion.

B. Monitorimi i cilësisë së shërbimit të komunikimeve celulare

Kryerja e monitorimit të frekuencave për cilësinë e shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme në territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me qëllim konstatimin e të dhënave reale të marra nga terreni mbi parametrat teknike të cilat i ofrohen përdoruesit fundor, rritjen e cilësisë së shërbimit të telefonisë mobile, evidentimin e zonave problematike me cilësi të dobët shërbimi dhe nxitjen e operatorëve për përmirësim të mëtejshëm në këto zona për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Gjatë vitit 2020 monitorimet QoS u realizuan në zgjedhje manuale të teknologjive 3G dhe 4G.

Figure 26: Stacioni i lëvizshëm i monitorimit të cilësisë (QoS)

Burimi: AKEP 2020








Figure 27: Brenda e stacionit të lëvizshëm të monitorimit të cilësisë (QOS)
Burimi: AKEP 2020

I. Mbulimi në % për sinjalin LTE (4G) për zonat turistike/plazhet.



II. Mbulimi në % për sinjalin UMTS (3G) për zonat turistike/ plazhet.



Fushata e monitorimit QOS në territorin e Republikës së Shqipërisë

Për sigurimin e përmbushjes në mënyrë sa më eficiente të objektivave rregullatore në lidhje me monitorimin e cilësisë së shërbimit për teknologjitë GSM (2G), UMTS (3G) dhe LTE (4G) për shërbimet zë (*voice*) dhe të dhëna (*data*), AKEP realizoi një fushatë monitorimi për cilësinë e shërbimit (QoS) në të gjithë territorin e Shqipërisë, për të tre operatorët e telefonisë së lëvizshme.

Rrugët e matura gjatë projektit arrijnë afërsisht rreth 8000 Km. Të dhënat u përpunuan duke përdorur një ndarje në dy grupe. Në të parën përfshihen 7 qytetet kryesore dhe në të dytën përfshihen rrugët nacionale, qytet e vogla dhe zonat turistike.

Qëllimi i Benchmark ishte përcaktimi i kërkesave kryesore për kryerjen e matjeve të lëvizshme për operatorët e telefonisë së lëvizshme në territorin e Shqipërisë, duke pasur një metodologji nëpërmjet të cilës AKEP do të bëjë të mundur një krahasim të cilësisë së shërbimit që u ofrohet konsumatorëve nga secili operator në zona të ndryshme gjeografike.

Rrjeti i preferuar nga pajtimtarët rezultoi të ishte 4G.

Thirrjet me zë ishin 4G/ CSFB dhe 2G/3G në varësi të strategjisë që kishte zgjedhur secili operator.

Të dhënat e publikuara gjenden edhe në faqen e internetit të AKEP.

4.3 Procesi i monitorimit dhe inspektimit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit

Monitorimi i cilësisë së shërbimit postar

Qytetarët dhe bizneset kanë përdorur gjerësisht shërbimet e komunikimit elektronik për të përmbushur nevojat e tyre të punës, ekonomike dhe sociale. Konsumatorët dhe ndërmarrjet ishin në gjendje të blinin mallra thelbësorë, brenda kufijve të rregulloreve të sigurisë dhe në përputhje me masat e distancës sociale, duke përdorur platformat *online* dhe shërbimet e lidhura të dorëzimit të pakove në tregun postar.

Gjatë pandemisë Covid 19 pati një rritje të konsumit të shërbimeve të komunikimit në internet. Që në javët e para të saj, janë regjistruar norma të larta rritjeje për përdorimin e informacionit, si në mediat tradicionale ashtu edhe në ato *online*.

Monitorimi i cilësisë së shërbimit të rrjeteve fikse


Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e gjendje së fatkeqësisë natyrore, u pezullua aktiviteti i monitorimeve të treguesve të cilësisë së shërbimit QoS. Brenda mundësive në dispozicion, aktiviteti i monitorimit të cilësisë së shërbimit u vazhdua nëpërmjet platformave të matjeve online.

Gjatë periudhës mars - prill 2020, një rëndësi e veçantë ju kushtua kontrollit të ofrimit të shërbimeve të telekomunikacioneve të lëvizshme dhe fikse për pajtimtarët. Rëndësia e këtij kontrolli ishte e domosdoshme për shkak të rritjes së përdorimit të internetit nga pajtimtarët gjatë kësaj periudhe.

Nga analizimi i këtyre informacioneve u konstatua se, ofrimi i shërbimeve të telekomunikacioneve nga operatorët e lëvizshëm dhe atyre fikse, gjatë periudhës së pandemisë, ishte brenda parametrave normale të cilësisë së shërbimit.


Më poshtë paraqiten disa grafikë me këto të dhëna nga sistemi për periudhën janar - prill 2020, si për telefoninë e lëvizshme ashtu edhe atë fikse (operatorëve kryesor).

TË DHENAT DATA PËR TË TRE OPERATORËT NË ZGJEDHJE AUTOMATIKE TË TEKNOLOGJISË GSM/UMTS/LTE



Performanca e shpejtësisë së data downloaded për periudhën 20 janar-20 prill 2020, për të gjitha teknologjitë.

TË DHENAT DATA TË OPERATORËVE KRYESORË TË RRJETIT FIKS



Të dhënat data të operatorëve të rrjetit fiks gjatë muajve janar-prill 2020


Inspektimi mbi portabilitetin e numrit

Gjatë pjesës së dytë të vitit AKEP ka identifikuar rritje të kërkesave për portim.

Sasia mesatare e numrave të portuar (portime të realizuara në bazë MSSIDN) midis tre operatorëve celularë, deri në muajin gusht 2020, ka qenë rreth 200 portime/ditë, ndërsa prej muajit gusht 2020 e në vijim ky tregues ka arritur mbi 1000 portime/ditë, duke arritur pikun me datë 2.12.2020, me 2214 numra të portuar/ditë.

Rritja e kërkesave dhe sasisë së numrave të portuar prej gushtit 2020 është shoqëruar me përkeqësim të treguesit të kërkesave të pranuar nga operatorët dhënës, që do të thotë rritje të përqindjes së kërkesave të refuzuara, duke çuar dhe në ankesa të shumta nga pajtimtarët dhe operatorët (në rolin e operatorit marrës).

Përqindja e numrave të pranuar për port-out sipas operatorëve (Operator Dhënës) 2019-2020



Duke filluar nga muaji gusht i vitit 2020, përveç rritjes së numrit dhe përqindjes së kërkesave të refuzuara, pranë AKEP janë adresuar një numër shumë i madh ankesash, si nga përdoruesit, ashtu edhe nga vetë operatorët, që denoncuan praktika abuzive në procesin e portimit të numrit nga shoqëritë konkurrenente.

Megjithëse AKEP, nëpërmjet takimeve si dhe komunikimeve elektronike dhe shkresore, ka paralajmëruar tre operatorët për rritjen e ndjeshme të përqindjes së kërkesave të refuzuara dhe ankesave për portim, duke kërkuar marrjen e masave urgjente për përmirësimin e situatës, pavarësisht disa reagimeve sporadike, të tre operatorët vijuan të rezultonin me tregues të përkeqësuar të pranimin të kërkesave për port-out.

Një ndër misionet e AKEP është promovimi i të drejtave të konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së sipërmarrësve në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor. Për të realizuar këtë mision, AKEP përdor masa me karakter parandalues dhe masa me karakter ndëshkues, duke sanksionuar edhe me gjobë sipërmarrës të ndryshëm në rastet kur në veprimtarinë e tyre konstatohen shkelje të kërkesave ligjore.



*Figure 28: Pajisjet hardware të platformës të portabilitetit të numrit (CRDB)
Burimi: AKEP 2020*

AKEP *Portabiliteti* 068 069 067

10 gjera që duhet të dihen për të bërë numrin tuaj

Kur mund të bëj numrin tim?

Sa kushton barta e numrit?

Çfarë duhet të bëj për barta e numrit?

Sa kohë më duhet për barta e numrit?

Ku dhe si mund të gjej më shumë informacion mbi barta e numrit?

Tarifat për kërkesat për numrat e barta

Ku dhe si mund të gjej mbrojtje?

Ju faleminderit që na vizitoni www.portabiliteti.al, një adresë e krijuar dhe e administruar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ju lutemi lexoni me kujdes në vijim.

Modifikimet e paautorizuara të përmbajtjes së saj konsiderohen një krim dhe do të ndëshkohen sipas Ligjeve në fuqi. AKEP ka të drejtë të monitorojë çdo modifikim të paautorizuar si dhe përpjekjet për të modifikuar përmbajtjen e kësaj faqeje.

Përmbajtja e kësaj faqeje është krijuar dhe plotësuar nga AKEP, me qëllimin e informimit të publikut mbi barta e numrit.

Riprodhimi, në tërësi ose në veçanti i dokumentave në këtë faqe është subjekt për mënyrat e mëposhtme:

Informacioni i riprodhuar apo i cituar duhet të shoqërohet me referimin e saktë të adresës www.portabiliteti.al si një burim informacioni.

Informacioni i riprodhuar apo i cituar duhet të shoqërohet me një nga specifikimet e mëposhtme:

- Burimi: faqja e administruar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Burimi: www.portabiliteti.al
- Sipas faqes së AKEP
- © AKEP
- Një njoftim të hollësishëm me kuptim të njëjtë.

Informacioni i riprodhuar apo i cituar nuk duhet të ndryshohet dhe asnjë fragment nuk duhet të përdoret jashtë përmbajtjes, nëse kuptimi i tyre si pasqyrë e ndërhyrjes modifikohet.

Nëse do të gjeni informacion të paqartë në këtë faqe, ju lutemi kërkonte sqarime dhe hollësi të mëtejshme përpara riprodhimit të tyre. Prandaj, ju lutemi të dërgoni një e-mail në adresën: portabiliteti@akep.al

Për çdo ankesë në lidhje me portabilitetin e numrit, mund t'i drejtoheni AKEP nëpërmjet emailit, telefonit, letër ose paraqitjes direkte në zyrat e AKEP si më poshtë:

email: portabiliteti@akep.al

Tel : +355 4 2250928 (gjatë orarit zyrtar)

Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Tiranë

Vendosni numrin e telefonit

Kërko

AKEP AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

www.akep.al Kontakt

Figure 29: Platforma e portabilitetit të numrit (CRDB)

Burimi: AKEP 2020

Gjithsesi, duke marrë shkas nga situata e rënduar e portabilitetit të numrit, si nga numri i shtuar i ankesave, ashtu edhe nga monitorimi i përkeqësimit të treguesit të përqindjes së kërkesave të refuzuara nga operatorët dhënës, AKEP realizoi inspektime pranë tre sipërmarrësve të rrjeteve publike celulare.

Strukturat inspektuese të AKEP, prej datës 28.12.2020, deri më 25.2.2021, realizuan inspektimin pranë tre sipërmarrësve të lartpërmendur, si dhe hartuan proces-verbalet respektive të inspektimit në datë 4.3.2021.

Shkeljet e konstatuara lidheshin me përcaktimet e neneve 6, 13, 15, 18 dhe 20 të Rregullores nr.43, datë 22.9.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore, G.I vendosi marrjen e masës administrative “Gjobë” sipas parashikimeve të paragrafit VII, të nenit 137, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918).

Krahas masës me gjobë, strukturat inspektuese kanë vendosur për të 3 (tre) subjektet rekomandime që duhen realizuar me afate kohore respektive

Ndër të tjera, rekomandimet përfshijnë:

- kryerjen e analizimit dhe zgjidhjen e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të procesit të portabilitetit të numrit, duke zgjatur procedurën në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht;
- përditësimin e të dhënave që administrohen në databazën e tij, në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit;
- kryerjen e vetëkontrollit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit;
- zhvillimin intensivisht të trajnimeve me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshim etj;
- ndalimin e menjëhershëm të praktikave tregtare çorientuese dhe agresive, ofertave të individualizuara që ndikojnë në procesin e portimit etj., (vetëm për 2 operatorë).

Sipërmarrësit janë rekomanduar të kryejnë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga vendimi përfundimtar i inspektimit dhe të njoftojnë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar më sipër si dhe të paraqesin provat që e vërtetojnë këtë fakt.

Gjithashtu, të 3 operatorët kanë detyrimin të dorëzojnë raportime periodike mujore (çdo datë 30 të muajit), deri në përmbylljen e afatit përfundimtar, duke përcaktuar progresin që është bërë për zbatimin e detyrave për korrigjimin e shkeljeve.

AKEP mbetet i angazhuar, të ndjekë zbatimin me përpikmëri të kuadrit ligjor në fuqi, nisur dhe nga impakti i madh që procesi i portimit të numrit ka tek pajtimtarët, duke siguruar vijimin me sukses të këtij procesi me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Gjithashtu, gjatë viti 2021 dhe në vijim, AKEP do të synojë të rrisë bashkëveprimin, efektivitetin e punës për përmbylljen e objektivave të planifikuara nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm, duke përmbyllur misionin e tij si një strukturë e pavarur dhe eficiente për rregullimin sektorial në tregjet e telekomunikacioneve, duke kërkuar të nxit një mjedis të favorshëm dhe konkurrues për investorët si dhe të ofrojë zgjidhje për çdo problematikë të konsumatorëve, duke garantuar mosdiskriminim, akses të barabartë në shërbime cilësore me çmime gjithmonë e më shumë të orientuara drejt kostos.



5. Performanca institucionale dhe transparencia financiare

5.1 Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare

Megjithë situatën e krijuar prej pandemisë, AKEP u angazhua për faturimin dhe mbledhjen në kohë të të ardhurave.

Pagesat për vitin 2020 janë realizuar nga pagesat e kryera prej sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare¹⁰:

- Pagesa për caktim dhe përdorim të frekuencave;
- Pagesa për numeracion;
- Pagesa për mbikëqyrje të tregut;
- Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit;
- Pagesa për Domain;
- Komisioni i përfituar si agjent tatimor.

Gjatë vitit 2020, për AKEP janë faturuar 380.81 milionë lekë, nga këto janë arkëtuar rreth 99% ose rreth 377.7 milionë lekë.

¹⁰ Pagesat bazohen në VKM nr. 599, datë 23.7.2010 "Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP", i ndryshuar, akteve normative në zbatim të ligjit 9918/2008, akteve normative të dala në zbatim të këtij ligji, si dhe nga udhëzimi i përbashkët nr. 30, datë 12.1.2015, i ndryshuar i MFE dhe AKEP.

AKEP vepron edhe si agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit¹¹.

Në rolin e agjentit tatimor, AKEP ka faturuar dhe arkëtuar rreth 500 milionë lekë, nga të cilat 474.57 milionë lekë janë derdhur në Drejtorinë e Rajonale të Tatimeve Tiranë, sipas udhëzimit të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Krahasuar me një vit më parë, janë arkëtuar dhe derdhur rreth 1% më shumë.

Pjesa më e madhe e pagesave u faturua në periudhën janar-shkurt 2020. Pagesa që u impaktua më shumë nga pandemia, ishte ajo e mbikëqyrjes së tregjeve. Pavarësisht vështirësive për shkak të hartimit me vonesë të pasqyrave financiare të sipërmarrësve dhe depozitimit të tyre në AKEP për llogaritjen e taksës së mbikëqyrjes së tregjeve, sipërmarrësit arritën t'i shlyenin detyrimet në kohë.

Me poshtë paraqiten pagesat e detajuara.

- Pagesat nga mbikëqyrja e tregjeve**

Lidhur me procesin e kësaj pagese, u faturuan sipas planit 164 milionë lekë nga tregu i komunikimeve elektronike dhe 8.5 milionë lekë pagesa e mbikëqyrjes për tregun postar. E gjithë vlera është arkëtuar.

- Pagesat nga mbikëqyrja e tregjeve**

Lidhur me procesin e kësaj pagese, u faturuan sipas planit 164 milionë lekë nga tregu i komunikimeve elektronike dhe 8.5 milionë lekë pagesa e mbikëqyrjes për tregun postar. E gjithë vlera është arkëtuar.

- Pagesat nga përdorimi i spektrit të frekuencave dhe numeracion**

Gjatë vitit 2020 janë faturuar 125.6 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i frekuencave, ku janë arkëtuar rreth 123.2 milionë lekë, pra janë arkëtuar rreth 98.8 % e faturimeve.

Gjithashtu, janë faturuar 25.7 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i numeracionit dhe janë arkëtuar rreth 25.5 milionë lekë pra janë arkëtuar 99% e faturimeve

- Komision si agjent tatimor**

Në programin e vitit 2020 ky zë u parashikua të ishte rreth 24 milionë lekë.

Si rezultat i faturimit, arkëtimit dhe derdhjes në buxhetin e shtetit të tarifës së radiotelekomunikacionit, janë arkëtuar në AKEP nga komisioni si agjent tatimor rreth 25 milionë lekë, ose rreth 104 % e programit nga të cilat janë përdorur 24 milionë lekë të buxhetuara. Diferenca është derdhur në buxhetin e shtetit.

- Pagesa për Domain dhe të tjera**

Nga pagesat për Domain janë faturuar rreth 11.87 milionë lekë dhe janë arkëtuar rreth 11.7 milion lekë.

11 Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave nr.28, datë 6.10.2008, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit", i ndryshuar.

5.2 Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit të institucionit

AKEP në zbatim të VKM nr. 159, datë 19.2.2020, administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2020, sipas zërave mëposhtëm:

1. Paga dhe shtesa të tjera	117,711,012 lekë
2. Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	14,988,988 lekë
3. Materiale	8,546,000 lekë
4. Shërbime	154,353,580 lekë
5. Investime	89,160,420 lekë

Gjatë vitit 2020 janë realizuar në total rreth 85.1 % e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, ose rreth 327.3 milionë lekë nga 384.76 milionë lekë të planifikuara dhe të miratuara.

Pavarësisht pezullimit të përkohshëm të prokurimeve publike dhe pengesave të tjera që solli situata e vazhduar e pandemisë, procedurat e prokurimit për investimet mallrat dhe shërbimet janë zhvilluar rregullisht dhe në shumicën e rasteve, impakti në diferencën midis faktit dhe programit, ka pasur çmimi më i ulët i ofertuar si rrjedhim i prokurimit publik.

Krahasuar me vitin 2019, AKEP ka realizuar 100 % të procedurave të prokurimit publik të parashikuara. Në vitin 2019 masa e realizimit ishte 70 %.

Shpenzimet

1. Pagat

Në nivelin e realizimit të shpenzimeve për këtë zë kanë ndikuar vakancat në strukturën e miratuar të institucionit, si dhe mosrritja e pagave për administratën publike gjatë vitit të kaluar.

Diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve për këtë zë është 9,9 milionë lekë.

2. Sigurime shoqërore

Për të njëjta arsye, edhe niveli i sigurimeve shoqërore ka një shmangie nga plani dhe rezulton me diferencë mosrealizimi në vlerën rreth 1.1 milionë lekë.

3. Materialet

Në lidhje me shpenzime materiale, është krijuar tepriceë rreth 3.2 milionë lekë, kjo si rrjedhojë e një sërë faktorësh:

- ulja e konsumit për disa artikuj si p.sh., karburant (shkak, pezullimi i procedurave inspektuese);
- në procedurat për prokurime rezultuan fitues operatorë ekonomikë me fond më të ulët se ai i llogarituri, të tilla si:
 - kancelari dhe Bojë printeri e fotokopje;
 - pjese këmbimi për automjete dhe shërbime për makina, goma bateri;
 - materiale pastrimi;
 - materiale të tjera.

4. Shërbime

Nga shërbimet bazë nuk arritën të përdoren rreth 2,1 milionë lekë, duke qenë se janë shërbime që varen nga konsumi i utilitareve, nga konsumi i energjisë elektrike, shërbimeve postare, etj.

Edhe këto shërbime u impaktuan nga pandemia, duke qenë se institucioni përkrahu dhe zbatoi telepunën dhe rotacionin në prezencë të punonjësve.

Nga shpenzimet për mirëmbajtje të infrastrukturës dhe platformave teknologjike, nuk arritën të përdoren rreth 2,87 milionë lekë, duke qenë se disa shërbime, si pasojë e pezullimi të procedurave të prokurimit, u kontraktuan në mes të vitit kalendarik, megjithëse ishin të planifikuara për 12 muaj.

Nga fondi i Shpenzime të tjera, nuk u arritën të përdoren rreth 11.8 milionë lekë.

Investimet

Zëri i shpenzimeve për investime është kryer 100%, duke marrë në konsideratë procedurat e kryera të prokurimit publik, ndërsa në lidhje me fondin, rezulton i realizuar rreth 79% e programit të miratuar për t'u investuar.

Nga zëri i investimeve të planifikuara në vlerën 89,16 milionë lekë:	• u shpenzuan 70,7 milionë lekë, • u kursye vlere prej 18,5 milionë lekë,
--	---

si rezultat i përdorimit të fondeve me efektivitet dhe ekonomizim, si dhe duke realizuar me sukses, transparencë dhe rigorozitet procedurat e prokurimit.

Vlera e kursyer u derdh në buxhetin e shtetit, si tepricë, bazuar në nenin 117, të ligjit 9918/2008.

Lidhur me zërin e investimeve, sqarojmë se:

- Janë kryer të gjitha investimet e programuara për vitin 2020.
- Janë kryer me sukses të gjitha procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontratat me operatorët ekonomikë fitues.
- Pezullimi i procedurave të prokurimit publik, për shkak të pandemisë, çoi në realizimin e procedurave kryesisht në gjysmën e dytë të vitit, duke mosrealizuar rialokim e fondeve të cilat mbetën nga fondi i miratuar.
- Fondet janë miradministruar dhe menaxhuar me transparencë.
- Janë zhvilluar investime në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese, duke u aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit, bazuar edhe nga detyrat e vendosura në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore të miratuara.
- Pas kryerjes së investimeve është bërë i mundur edhe sistemimi i dhomës së serverave



Figure 30: Gjendja e serverave në vitin 2019 (majtas) dhe në fund të vitit 2020 (djathtas) pas rivendosjes në standarte të mjedisit përkatës në QKMF


Burimi: AKEP 2020

Aktivitetet kryesore në zërin e Investimeve të ndodhura gjatë vitit 2020 përfshijnë investime shumë të rëndësishme, të tilla si:

- Implementimi i «Disaster Recovery Site» i sistemit të portabilitetit të numrit;
- Shërbim konsulence për dhënie në përdorim të brezit të lirë të frekuencave;
- Sistemi i avancuar i administrimit të spektrit të frekuencave;
- Përgatitja dhe konfigurimi i mëtejshëm i infrastrukturës së brendshme të shërbimeve të AKEP, si administrimi i email-eve, kompjuterave, serverave, dokumenteve, centrali qendrorë.

Teprica e të ardhurave

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në fund të vitit 2020 rezulton në shumën **53.55 milionë lekë**, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe kursimit të disa zërave të miratuar në fondin e shpenzimeve të AKEP.



Në krahasim më një vit më parë, kjo vlerë ka pësuar rënie me rreth 14%, duke evidentuar kështu një tregues pozitiv në menaxhimin e fondeve me efektivitet, pavarësisht sfidave që u shfaqën gjatë kësaj periudhe¹².

Theksojmë edhe njëherë se, pjesa më e madhe e tepricës buron nga diferenca e vlerës së fondit të përlogaritur me atë të ofertuar nga fituesi i procedurës së prokurimit, si rezultat i një gare dhe një procesi konkurrues në treg.

Pezullimi për një kohë të gjatë i procedurave të prokurimit nga APP si rrjedhojë e pandemisë, ndikoi në përdorimin e fondeve në fund të vitit dhe pamjaftueshmërinë e afateve kohore për të rishpërndarë tepricat e papërdorura, brenda kufijve që përcaktohen nga kuadri ligjor.

Nëse nuk do të kishte pasur pezullime dhe vonesa për shkak të pandemisë, në muajin tetor këto teprica mund të ishin rishpërndarë për të përshpejtuar investime të tjera.

Vlerat në milionë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2020		Diferenca Fakt-Program	% e realizimit vjetor
		Programi	Fakti		
I	Të ardhurat gjithsej:	384.76	380.81	-3.95	99.0%
II	Shpenzime gjithsej:	384.76	327.27	57.5	85.1%
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	117.71	107.81	-9.9	91.6%
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	14.99	13.93	-1.1	92.9%
3	Shpenzime për materiale	8.55	5.37	-3.2	62.8%
4	Shpenzime për shërbime	154.35	129.47	-25.1	83.9%
5	Shpenzime për Investime	89.16	70.7	-18.5	79.3%
III	Tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit				
1	Arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Shtetit		474.57		
2	Të ardhurat si agjent tatimor nga arkëtimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit	24.00	24.98		

¹² Teprica e të ardhurave e vitit 2019 përbëhej kryesisht nga zëra të paprokuruar, ndërsa teprica e vitit 2020 përbëhet nga kursimi dhe mirëmenaxhim i fondit.

5.3 Procesi i mbledhjes së të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore

- ***Në lidhje me ndjekjen e proceseve gjyqësore ku AKEP ka qenë palë e paditur, paditëse dhe/ose palë e tretë janë realizuar:***

Përgjatë vitit 2020 janë ndjekur dhe janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për arkëtimin e të detyrimeve të prapambetura si dhe vërtetimit të pamundësisë së arkëtimit të detyrimeve të tyre nga institucioni, nëpërmjet dokumentacionit shoqërues.

Ndërkohë, për debitorët për të cilët ishin ndjekur të gjitha hapat administrative, janë hartuar kërkesëpaditë përkatëse dhe janë iniciuar 12 procese gjyqësore.

Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadive për 11 çështje gjyqësore dhe rrëzimin e 1 kërkesëpadie për shkak të kalimit të afatit 10 vjeçar të parashkrimit.

Gjatë vitit 2020, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike është investuar si palë ndërgjyqëse, në:

- Cilësinë e palës së paditur, në 6 procese gjyqësore;
- Cilësinë e palës paditëse, në 12 procese gjyqësore;
- Cilësinë e personit të tretë, në 2 procese gjyqësore.

Në cilësinë e palës së paditur, Gjykata ka disponuar në favor të AKEP, duke vendosur rrëzimin e kërkesë padisë të palës së paditur, në 3 procese gjyqësore.

Në cilësinë e palës paditëse, Gjykata ka disponuar në favor të AKEP, duke vendosur pranimin e kërkesë padisë, në 11 procese gjyqësore.

Problematikat e konstatuara gjatë ndjekjes së këtyre proceseve gjyqësore me debitorët janë adresat jo të sakta, dhe pjesa dërrmuese e tyre rezultojnë në ekstraktin tregtar me status jo aktiv, duke bërë që njoftimet e tyre të bëhen përmes procedurës së shpalljes publike, duke zgjatur kështu afatet gjyqësore.



III

SHTOJCA

1. Struktura dhe Organigrama e AKEP

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizohet dhe funksionon referuar strukturës organizative miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 56/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.


Punonjësit e rekrutuar në Institucion trajtohen sipas dispozitave të ligjit “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe Kodit të Punës.

Struktura organizative dhe organika e AKEP përbëhet nga 85 punonjës, të organizuar në 8 Drejtori dhe 14 Sektorë.

Gjatë viti 2020, bazuar në planin vjetor të pranimit si dhe vendeve vakante të krijuara, gjatë vitit janë realizuar gjithsej 5 procedura rekrutimi në shërbim civil duke ndjekur procedurat e rekrutimit me lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil, dhe 2 procedura rekrutimi me Kod Pune.

Në fund të vitit 2020 rezultojnë 7 pozicione të lira pune për t’u plotësuar (6 në Shërbim Civil dhe 1 me Kod Pune) si edhe 1 vend vakant në pozicionin e Anëtarit të Këshillit Drejtues të AKEP.

Organigrama e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare



2. Raport lidhur me nivelin e zbatimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019



Figure 31: Pamje nga paraqitja e Raportit Vjetor për veprimtarinë e AKEP gjatë vitit 2019, në Kuvendin e Shqipërisë (seancë plenare, korrik 2020)

Burimi: Kuvendi i Shqipërisë 2020

- 1. AKEP t'i japë përparësi vënies në eficiencë të plotë të brezave të paalokuar, në përfitim të qytetarëve dhe konsumatorëve, pasi të ketë kryer analiza lidhur me dhënien në përdorim të spektrit, përfshirë këtu edhe kombinimet teknike të tij, bazuar në programin e politikës spektrale në nivel kombëtar.**

Realizuar

Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë si organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, si dhe në përmbushje të objektivave rregullatore të përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008, me qëllim sigurimin e eficiencës së plotë të përdorimit të brezave të paalokuar apo nxitjen e përdorimit të frytshëm të frekuencave në

administrim, përgjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2020, AKEP ka ndërmarrë të gjitha masat administrative për realizimin e procedurave të prokurimit për shërbimin e konsulencës përsa i përket dhënies në përdorim të brezave të lirë të frekuencave si dhe kombinimet midis tyre.

Prokurimi i këtij shërbimi ka përfunduar në fillim të muajit dhjetor 2020, ku është përzgjedhur një shoqëri ndërkombëtare me eksperiencë dhe njohuri të thelluara në fushën e administrimit, menaxhimit të spektrit të frekuencave, duke garantuar zbatimin e plotë të objektivave rregullatore, në përputhje të plotë me politikat e zhvillimit spektral në nivel kombëtar si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim.

2. AKEP të kryejë një analizë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm në kuadër të implementimit të teknologjisë së gjeneratës së re në Shqipëri, duke përcaktuar hapat strategjike dhe duke dalë në përfundime për vendimmarrje të mëtijshme në nivel sektorial

Në vijim

Për të plotësuar detyrën e lënë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, AKEP do të kryejë një analizë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm në kuadër të implementimit të teknologjisë së gjeneratës së re në Shqipëri, duke përcaktuar hapat strategjike dhe duke dalë në përfundime për vendimmarrje të mëtijshme në nivel sektorial. Situata dhe zhvillimet e teknologjisë së gjeneratës së re në vendet e rajonit dhe vendet e BE, është e tillë që zgjidhjet janë të larmishme dhe të aplikuara në varësi të kushteve specifike të shteteve të ndryshme, duke marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike, kushtet e tregut celular, nevojën për përfitim maksimal shtetëror dhe shoqëror. Një analizë e tillë duhet të përfshijë të njëjtat çështje për këto teknologji, të cilat diskutohen dhe trajtohen në vendet e rajonit dhe BE.

Duke pasur parasysh që një analizë kaq e hollësishme kërkon eksperiencën e kompanive konsulente të huaja, si dhe duke ditur që nevojitet kohë për të përmbushur procedurat ligjore dhe për vendimmarrje, është parashikuar që ky proces të zhvillohet gjatë vitit 2021, për shkak të kohës së shkurtër të mbetur deri në fund të vitit 2020 dhe pamundësisë në planifikimin e buxhetit të vitit 2020.

AKEP ka kryer studimin e tregut dhe ka përfshirë fondin e nevojshëm në parashikimet për buxhetin e vitit 2021. Në muajt e parë të vitit 2021 do të fillojë ndjekja e procedurave ligjore për prokurimin e kësaj ekspertize ligjore.

3. Duke pasur parasysh rëndësinë e procesit të Analizës së Tregut me Shumicë të Akses-Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, Këshilli Drejtues i AKEP, në vendimmarrjen për dokumentin përfundimtar, të shqyrtojë rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe komentet e aktorëve në treg, duke iu referuar edhe praktikave më të mira të BE-së dhe BEREK.

Realizuar

Në zbatim të procedurës së parashikuar nga nenet 31 e vijues, të ligjit nr. 9918/2008, si dhe të rregullores nr. 9/2009, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 11, datë 17.4.2019, miratoi dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare, tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare - dokument për Këshillim Publik”.

Procedura e Këshillimit Publik u zhvillua gjatë periudhës 18.4.2019 - 20.6.2019.

AKEP ka shqyrtuar komentet e marra nga palët e interesuara: dy vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, nr. 635, datë 4.7.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare” si dhe një rekomandim përfundimtar nëpërmjet vendimit nr. 661, datë 21.11.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për Këshillim Publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”” dhe komentet e palëve të interesuara, sipërmarrësit Telekom Albania sh.a. (11.6.2019; 26.2.2020), Albtelecom sh.a. (17.6.2019; 22.1.2020), Vodafone Albania sh.a. (18.6.2019; 25.2.2020), Neofone sh.p.k. (20.6.2019), Alban Tirana Nascendo Al. Sh.p.k. (15.6.2019).

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 9, datë 24.4.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas Këshillimit Publik për dokumentin “*Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare*” vendosi:

- | | |
|---|---|
| (i) Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4, të nenit 3, të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduralë të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe rregullorja 9/2009; | (ii) Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme, duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores. |
|---|---|

4. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik për Analizën e Tregut të Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare, AKEP të vlerësojë opinionet e aktorëve në treg, si dhe rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për të marrë vendime sa më të drejta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Realizuar

Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me nr. 9, datë 17.7.2009, “Për Analizën e tregut”. Ky treg ka qenë gjithashtu pjesë e tregjeve për rregullim, sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014. Që prej vitit 2015, për sa i përket terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, Komisioni Evropian ka vënë theksin mbi domosdoshmërinë e një analize të hollësishme, sipas kushteve specifike dhe dinamike të tregjeve kombëtare dhe zonave ekonomike, përkundrejt një rregullimi sistematik dhe skematik.

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 10, datë 17.4.2019, miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, periudha e këshillimit publik 18.4.2019 – 20.6.2019.

AKEP ka vlerësuar komentet nga palët e interesuara si Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr. 634, datë 4.7.2019, Telekom Albania sh.a., me shkresën nr. 3044, datë 13.6.2019 dhe me shkresën 1112/5 prot. të datës 27.2.2020; Albtelecom sh.a., me shkresën nr. 4560, datë 20.6.2019, Vodafone Albania sh.a., me

shkresën nr. CEO/006/KQ, datë 18.6.2019 dhe Neofone sh.p.k., me shkresën nr. 346, datë 19.6.2019.

Pas marrjes së opinionit të palëve të interesuara, AKEP zhvilloi konsultime të herëpashershme me organizmat ndërkombëtarë. Ndonëse u rekomandua që për thirrjet hyrëse kombëtare të vijohej sipas metodës së benchmark-ut rajonal (vendet e BE), u vërejt se analiza e tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse nuk do të mund të ishte plotësisht e eficiente, për aq kohë sa nuk do të përfitohej një model kostosh, i cili, në fakt, është duke u përpunuar aktualisht në AKEP, me asistencë ndërkombëtare dhe bazuar në praktikën më të fundit BE/BEREC.

Në konkludim të procedurave, Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 11, datë 16.6.2020, “*Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit: “Analizë tregun e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”*”, vendosi:

- | | |
|---|--|
| (i) T’i konsiderojë të tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a., Telekom Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi: (a). Masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 12, 13, 14, datë 22.2.2018; (b). Tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018; | (ii) Të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re. |
|---|--|

5. Duke pasur parasysh që gjatë vitit 2020 duhet bërë rishikimi për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, të kryejë një analizë të strukturës së tregjeve postare. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh që Komisioni Evropian do të kryejë rishikim të direktivave të shërbimit postar, ku priten ndryshime për sa i përket Shërbimit Universal Postar, gjatë analizës së tregjeve postare AKEP të ketë në vëmendje edhe ndryshimet e direktivave nga KE.

Realizuar

Bazuar në dispozitat ligjore dhe duke marrë në konsideratë afatin e përfundimit të autorizimit individual të “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar, në datën 7 korrik 2020, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 6, datë 16.4.2020, miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, për një afat 30 ditor (17 prill - 18 maj).

Ky vendim, pasi u publikua, ju njoftua palëve të interesuara, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Nga palët e interesuara, ka paraqitur mendim vetëm Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku ndër të tjera, shprehet parimisht dakord me përmbajtjen e dokumentit, duke argumentuar se janë analizuar në tërësi të gjithë aspektet e tregut të shërbimeve postare.

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 12, datë 16.6.2020, vendosi të miratojë dokumentin përfundimtar “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, dhe të përcaktojë shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me vendimin nr. 13, të datës 30.6.2020, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dhënien e Autorizimit Individual Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit Universal Postar për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga data 7 korrik 2020.

6. Të punojë për reformimin e kuadrit ligjor të komunikimeve elektronike në funksion të implementimit të kodit të ri të komunikimeve elektronike dhe përforcimin e garantimit të pavarësisë institucionale.

Realizuar

Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e madhe të këtij sektori në zhvillimin e ekonomisë digjitale, si dhe evoluimin e tij të jashtëzakonshëm brenda një periudhë shumë të shkurtër, AKEP konsideron si tejet të nevojshëm pasjen e një kuadri ligjor normues, i cili i përshtatet dinamikës së këtij sektori. Tregu i komunikimeve elektronike po ndryshon shumë shpejt përballë kërkesës gjithnjë e në rritje për zhvillimin e infrastrukturës së shpejtësisë së lartë, si dhe përdorimit në masë të madhe të aplikacioneve të telefonisë së lëvizshme në jetën moderne, ndaj dhe në këtë kontekst vlerësohet mjaft e rëndësishme ndërhyrja legjislative në kuadrin ligjor ekzistues në fuqi.

Nisur nga konteksti si më sipër, si dhe në ndjekje të rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përgjatë vitit 2020 AKEP ka kryer evidentimin e saktë të problematikave të legjislacionit në fuqi për sa i përket:

- Garantimit të pavarësisë operacionale të AKEP, bazuar në konstatimet dhe udhëzimet e Komisionit Evropian – progres raportet e përvitshme – dhe BEREC;
- Rritjen e performancës dhe kapaciteteve ushtrimore të misionëve rregullatorë dhe konkurrencë-nxitëse të AKEP në qasjet e tyre juridike, ekonomike dhe inxhinierike;
- Përforcimin e kapaciteteve nxitëse dhe ndërvepruese në kuadër të rritjes së investimeve në fushën e komunikimeve elektronike, në veçanti në aspektin e hyrjes në treg të teknologjive të reja 5G dhe shfrytëzimit të spektrave përkatës të frekuencave.

Në vijim, AKEP ka kryer hartimin e propozimeve ligjore në formën e akteve ligjore/nënligjore dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, fazë e cila do të ndiqet edhe nga propozimet përkatëse për nisjen e procesit legjislativ për miratimin e ndryshimeve ligjore.

Ky proces synon kryesisht, përcaktimin në kuadrin e ri ligjor të nevojës së autoritetit rregullator për të ushtruar kompetencat dhe vendimmarrjen në autonomi të plotë.

7. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit të vijojë të monitorojë dinamikën e ecurisë së problemit të dorëzimit të pakove në adresën e individit nga “Posta Shqiptare”, si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit, e cila edhe pas rekomandimeve të AKEP, vijon të mbetet problem duke sjellë mosdorëzimin e një pjese të mirë të pakove në adresë të marrësit, por dorëzimin e tyre pranë zyrave postare. Gjithashtu, të monitorojë dinamikën e ecurisë së problemit të tarifave dhe kostove shtesë që u kërkojnë konsumatorëve për marrjen e pakove nga “Posta Shqiptare”, duke kërkuar që në programin ekonomiko-financiar të vitit 2020 të postës të hiqet tarifa e dorëzimit të objekteve postare e kolipostare, e cila është në kundërshtim me frymën e ligjit dhe parimet e Rregullores së Shërbimit Postar Universal

Realizuar

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se gjatë vitit 2019 AKEP ka realizuar kontrollin dhe inspektimin e subjekti “Posta Shqiptare” sh.a.

Gjatë procedurës inspektuese, është konstatuar se subjekti “Posta Shqiptare” sh.a., në veprimtarinë e saj shfaqte problematika lidhur me:	- shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit në përputhje me nenin 40, të ligjit 46/2015; - tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare;
---	--

Në përfundim të procedurës së inspektimit ofruesi i shërbimit universal postar “Posta Shqiptare” sh.a., me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 1, datë 18.2.2020, është dënuar me masën administrative “Gjobë” si edhe dënime administrative plotësuese në formën e rekomandimeve. Pas ankimeve administrative të subjektit lidhur me masën e gjobës, Këshillit Drejtues i AKEP me vendimin nr. 19, datë 17.9.2020, ka vendosur lënien në fuqi për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 1, datë 18.2.2020, të dënimit me gjobë.

Pavarësisht masave administrative të ndërmarra nga AKEP, subjekti “Posta Shqiptare” sh.a., ka shfaqur vullnet pozitiv dhe ka bërë përpjekje në plotësimin e rekomandimeve. Në funksion të përmbushjes së shërbimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, “Posta Shqiptare” sh.a., ka raportuar se ka kryer investime me kosto të konsiderueshme, duke krijuar për herë të parë flotën e transportit të dedikuar vetëm për dorëzimin e paketave/kolipostave.

Gjithashtu, subjekti “Posta Shqiptare” sh.a., ka deklaruar se duke filluar nga data 1 janar 2021 të mos aplikojë për individët vjeljen e tarifës së dorëzimit të objekteve postare, paketot e vogla apo kolipostat që vijnë nga jashtë vendit.

8. Të punojë për miratimin dhe implementimin e kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit, si dhe të kryejë një proces këshillimi publik për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe ata me të ardhura të ulëta.

Në proces realizimi

Në vijim të procesit të Këshillimit Publik të vitit 2019 të Rregullores “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, dhe administrimit të komenteve të shumta dhe sugjerimeve me palët e interesit gjatë fillimit të vitit 2020, gjithashtu, bazuar edhe rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, AKEP përmes Vendimit të Këshillit Drejtues me nr. 20, datë 25.9.2020, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, e cila përfshin edhe një kapitull të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dhe të ardhura të ulëta.

Në këtë version të rishikuar të rregullores, e cila aktualisht është në fazën e Këshillimit Publik, është përfshirë kryesisht:

- një kapitull i veçantë për masat e propozuara për garantimin e aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, sipas nenit 102/1, të ligjit 9918/2008;
- plotësime/ndryshime të pjesëve të tjera të rregullores, duke marrë në konsideratë komentet dhe diskutimet me palët e interesit si dhe dokumentat më të fundit të KE në lidhje me kontratat e pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Rregullorja përmban kërkesat që duhet të plotësohen nga sipërmarrësit ofrues të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për të garantuar akses të barabartë dhe mundësi zgjedhjeje për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Detyrimet e përcaktuara nga AKEP, përfshijnë kërkesa për sipërmarrësit për krijimin e politikave dhe procedurave të veçanta për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë trajnimin e stafëve të tyre, dhënien e informacionit parakontraktual dhe kontratën e lidhur në formate të përshtatshme, dhënien e përparësisë në riparimin e defekteve në rrjete fikse. Detyrimet e propozuara përfshijnë masa për aksesueshmërinë në faqet web të operatorëve si përmbushjen e iniciativës “Web Accessibility Initiative” dhe krijimin e seksionit të dedikuar të aftësisë së kufizuar.

Një risi për përdoruesit me aftësi të kufizuara pritet të jetë fillimi i zbatimit të detyrimeve dhe ofrimit nga operatorët i shërbimit Text Relay (shërbim i konvertimit të tekstit) që lejon personat që kanë vështirësi në dëgjim dhe/ose në të folur për të kryer/marrë thirrje telefonike drejt/nga përdoruesit e tjerë nëpërmjet konvertimit të komunikimeve nga tekst në thirrje zanore dhe anasjelltas me asistencën e një pale ndërmjetëse (call assistant) që bën konvertimet e nevojshme.

Në draft-rregullore është përfshirë dhe propozimi për detyrime specifike për shërbimet me parapagim, të tilla si zgjatja e afatit të vlefshmërisë së rimbushjeve në 12+3 muaj dhe të drejtën e pajtimtarit për kompensim për shumat e papërdorura. Këto të drejta për pajtimtarët i vijnë në ndihmë sidomos pajtimtarëve me të ardhura të ulëta që përdorin shërbime celulare me parapagim me rimbushje (Pay As You Go), në kushtet kur operatorët celularë kanë reduktuar afatin e përdorimit të shumicës së rimbushjeve në 1 muaj.

Procesi i Këshillimit Publik përfundoi më datë 30.10.2020, dhe AKEP ka kryer takime me MSHMS dhe Shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve lidhur me rregulloren.

Aktualisht AKEP është në proces të miratimit të rregullores.

9. Duke e rikonsideruar problemin e kabllave ajrore apo atyre të vendosura në shtyllat elektrike, si dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës si një problem i cili vijon të mbetet shqetësues, me gjithë përmirësimet që ka pasur, AKEP të vazhdojë të ndjekë me përparësi këtë problematikë duke e koordinuar punën dhe me aktorët e tjerë në këtë proces, siç janë organet e pushtetit vendor, OSHEE dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Në proces realizimi

AKEP vlerëson se adresimi i problematikave lidhur me infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet parë jo vetëm në drejtim të ndotjes mjedisore vizive dhe çështjeve të sigurisë së shëndetit, por edhe në dhënien e stimuljeve të duhur për operatorët për ndërtimin e rrjeteve të cilësisë së lartë të aksesit *Broadband*, rritje të investimeve dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës fizike dhe konkurrencën e ndershme në treg, duke rritur në këtë mënyrë përfitimet e konsumatorëve dhe bizneseve nga shërbime me cilësi të lartë dhe tarifa të arsyeshme.

Problematika kryesore e evidentuar lidhet me ndotjen mjedisore të shkaktuar nga kabllot ajrore në fasadat e pallateve, ardhur kjo edhe për shkak të mungesës të pikave të aksesit dhe rrjeteve të brendshme të telekomunikacioneve në pallatet/godinat e vjetra si dhe një pjesë të godinave të reja.

Njëkohësisht, probleme shfaqen edhe nga mosrespektimi i rregullave nga operatorët apo edhe vakuumi i akteve nënligjore.

Problematika rezulton komplekse dhe kërkon nevojën e marrjes së masave afatshkurtra (p.sh., bashkëpunim për sistemim i kabllave ekzistuese) dhe afatgjata (p.sh., ndryshime ligjore/nënligjore për promovim të përdorimit të përbashkët të infrastrukturës) si dhe bashkëpunim të disa aktorëve, të tilla si MIE, Bashkitë, OSHEE, sipërmarrësit.

AKEP në vijimësi ka kërkuar prej sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ofruesve të rrjeteve kabllore marrjen e masave me qëllim eliminimin e lidhjeve që mbështeten në infrastrukturën e rrjetit elektrik dhe të ndriçimit.

Në vijim, AKEP do të ndërmarrë këto hapa:

- Organizim të konsultimeve/takimeve të përbashkëta në nivel ekspertësh për të forcuar bashkërendimin horizontal ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në proces.
- Bashkëpunim me Bashkitë dhe operatorët për sistemin e kabllave ajrore në pallate, në rrugë, në tubacione nëntokësore ekzistuese dhe/ose të reja. Sistemimi mund të kryhet sipas prioritetit të rrugëve urbane (parësore, dytësore etj.) apo sipas shkallës së problemit (duke filluar me rrugët me më shumë kabllot ajrore dhe që kanë dhe tubacione ekzistuese).
- Bashkëpunim midis institucioneve dhe operatorëve për përmirësimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit nr.120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.
- Nxitje të bashkëpunimit ndërmjet OSHEE dhe operatorëve të rrjeteve mbi rregullimin e përdorimit të infrastrukturës pasive, për përdorimin e shtyllave dhe rrjetit të OSHEE sipas standardeve të përcaktuar nga OSHEE dhe marrëveshjeve të miratuara nga të dy palët.

10. Pas miratimit të rregullores përkatëse, përfshirë dhe përcaktimet për regjistrin “Do Not Call Me”, të punojë për implementimin e regjistrit bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, për të rregulluar aktivitetet e telemarketuesve që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara për individë privatë. Implementimi i këtij regjistri do t’u mundësojë përdoruesve që të bëjnë “opt-out”, pra të mos marrin thirrje të pakërkuar nga kompanitë telemarketing.

Në proces realizimi

Krijimi i Regjistrin “Do Not Call Me” është pjesë e rregullores së nxjerrë në Këshillim Publik, me vendimin e Këshillit Drejtues me nr.20, datë 25.9.2020, “Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

AKEP gjatë kështimit publik të rregullores përgjatë vitit 2019, ka bashkëpunuar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP) në lidhje me krijimin e këtij regjistri. Bashkëpunimi ka vijuar dhe përgjatë vitit 2020, konkretisht gjatë muajit tetor 2020 është marrë pjesë në diskutimet për hartimin e projektligjit “Për Krijimin e Regjistrin të komunikimeve tregtare të pakërkuar” për të cilën KDIMP ka krijuar një grup pune ndërinstitucional që përfshin edhe përfaqësues të AKEP.

Me miratimin e “Rregullores për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, do të bëhet i mundur edhe krijimi i këtij regjistri i cili do të jetë në harmoni edhe me projektligjin për “Për Krijimin e Regjistrin të Komunikimeve Tregtare të Pakërkuar”.

11. Të luajë një rol proaktiv duke bërë propozime konkrete për nevojën e akteve nënligjore për trajtimin e thirrjeve drejt numrit 112 dhe numrave të tjerë të emergjencave, si dhe të vijojë bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur implementimin në të gjithë Shqipërinë të përdorimit të numrit të emergjencës 112, si një kërkesë e përsëritur si në rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, ashtu edhe në rekomandimet e raportit progresit të KE-së.

Në proces realizimi

Siç është raportuar më parë, AKEP në draft-Rregullore “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, ka përfshirë një nen të veçantë për thirrjet/komunikimet drejt numrave të emergjencës.

Gjithashtu, në komunikimet me MIE dhe institucione të tjera, AKEP ka kërkuar që raportimi për këtë kërkesë të KE të kryhet nga institucionet përgjegjëse për trajtimin e thirrjeve drejt numrave të emergjencës. Në vijim planifikohen të organizohen takime me institucionet e emergjencave për implementimin e këtij numri, gjithashtu AKEP ka shprehur gatishmërinë në dhënien e ekspertizës teknike/ligjore për hartimin e akteve nënligjore.

3. Statistika të zhvillimeve në tregjet e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare

Tabela 1 Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshim 2020/2019
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:							
<i>Sipas kartave SIM</i>	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	3,337,824	-1.22%
<i>Përdorues aktivë</i>	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	2,618,880	-0.43%
Numri përdoruesve me akses 3G/4G							
<i>Totali</i>	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	2,469,850	0.32%
<i>Përdorues aktivë</i>	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	1,998,579	11.71%
Thirrje telefonike dalëse celulare (mln/minuta)	7,381	6,794	6,620	6,019	5,494	5,286	-3.78%
Thirrje hyrëse kombëtare (mln/minuta)	1,388	2,523	2,894	2,525	2,319	2,306	-0.54%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (mln/minuta)	420	300	168	165	213	188	-12.00%
Numri mesazheve SMS të dërguara (mln)	1,599	1,610	1,400	1,213	968	6601	-31.74%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	88,950,833	28.66%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2015-2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshim 2020/2019
Thirrje dalëse	182	166	155	158	171	168	-1.75%
Thirrje te marra	171	169	156	161	177	174	-1.69%
MOU	353	335	311	319	348	341	-2.01%
SMS te dërguara	39	39	33	31	30	30	0.00%
Trafiku internet (GB)	0.96	1.49	2.06	2.60	3.40	3.90	14.71%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Tabela 3 Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G ndër vite

	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communications	Total	Norma e pentrimt për popullsi
2013	311,566	634,293	285,400	-	1,231,259	43%
2014	225,346	550,196	132,433	-	907,975	32%
2015	375,973	706,880	214,428	-	1,297,281	46%
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
2018	605,984	931,730	272,282		1,809,996	63%
2019	567,572	940,949	280,737		1,789,258	63%
2020	718,631	981,483	298,465		1,998,579	70%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Figura 1: Ecuria e thirrjeve (në minuta) dalëse dhe hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Figura 2: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Figura 3 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband nga rrjete fikse 2010-2020



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Figura 4 Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhëna të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Në vitin 2020 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 58% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 35% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni,

Internet dhe TV).

Tabela 4: Të dhëna mbi kategoritë kryesore të objekteve postare (2018-2020)¹³

Shërbime postare të ofuara		2017	2018	2019	2020	Ndryshim 2020/2019
Posta Shqiptare sh.a						
1	Shërbim Universal Postar	19,922,420	19,711,717	21,501,005	18,390,874	-14%
	Postë brenda vendit	18,599,662	18,298,143	20,348,070	17,487,538	-14.1%
	Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	1,152,935	903,336	-21.6%
2	Shërbim joniversal postar	2,612,719	2,826,217	661,801	875,856	32%
	Postë brenda vendit	2,603,017	2,819,601	656,177	873,512	33.1%
	Postë ndërkombëtare	9,702	6,616	5,624	2,344	-58.3%
3	Shërbim ekspres	750,558	718,573	723,120	499,405	-31%
	Ekspres brenda vendit	724,794	699,731	644,049	486,531	-24.5%
	Ekspres ndërkombëtar	25,764	18,842	79,071	12,874	-83.7%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare						
4	Shërbim JoUniversal Postar	312,136	526,386	738,157	1,959,797	165%
	Postë brenda vendit	277,504	490,900	698,388	1,914,761	174.2%
	Postë ndërkombëtare	34,632	35,486	39,769	45,036	13.2%
5	Shërbim ekspres	1,257,488	1,631,023	2,256,965	3,069,247	36%
	Ekspres brenda vendit	1,050,783	1,408,298	2,010,034	2,796,387	39.1%
	Ekspres ndërkombëtar	206,705	222,725	246,931	272,860	10.5%
6	Totali 1+2+3+4+5	24,855,321	25,413,916	25,881,048	24,795,179	-4.2%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP

13 Të dhënat e vitit 2019 për Postën Shqiptare janë përditësuar sipas shkresës me nr.416 prot, datë 23.2.2021 dërguar po nga Posta Shqiptare.

4.

Statistika të zhvillimeve në sektorin e autorizimeve dhe të drejtave të tjera të përdorimit, licencat, certifikatat ajrore, detare, etj.,
Si dhe përdorimi i domain.al

I. PAJISJA ME AUTORIZIMIN E RI INDIVIDUAL TË “POSTA SHQIPTARE” SH.A., PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR

Një nga zhvillimet e rëndësishme për në tregun e shërbimeve postare gjatë vitit 2020, ishte pajisja me Autorizimin e ri Individual të “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar.


Me vendimin nr. 13, datë 30.6.2020 të Këshillit Drejtues të AKEP, u miratua dhënia e Autorizimit Individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë 5 vjeçare. Ky vendim u mor në përfundim të Këshillimit Publik dhe pas miratimit të Analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal.

Në përgatitjen e Autorizimit Individual për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar, AKEP është bazuar në përcaktimet e ligjit 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloren nr. 36, datë 29.10.2015, “Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.


Dokumenti Autorizimi Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm në tregun e shërbimit postar, i cili i vendos të drejta dhe detyrime subjektit “Posta Shqiptare” sh.a., për të ofruar shërbimin universal postar, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

II. REGJISTRIMI I SIPËRMARRËSVE PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE, SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM


Të dhëna për sipërmarrësit e regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve/shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, për periudhën nga 1. 1. 2020 deri më 31. 12. 2020.




Sipërmarrës të rinj dhe sipërmarrës të çregjistruar gjatë vitit 2020:



Sipërmarrës që ofrojnë shërbime publike telefonike (2020):



Sipërmarrës që ofrojnë shërbime të tjera (2020):



Vlen të theksohet fakti që gjatë vitit 2020, të gjitha njoftimet e sipërmarrësve për fillim ofrimi rrjetesh të komunikimeve elektronike, janë paraqitur për ndërtim rrjetesh vetëm me fibra optike. Gjithashtu, vërehet edhe zëvendësimi i kablllove të vjetra koaksiale me fibra optike, duke mbështetur në këtë mënyrë, edhe më shumë shërbimet *broadband* (me shpejtësi të lartë) nga rrjetet fikse.

Instalimi i fibrave optike vitet e fundit, përbën një risi pasi janë rritur shumë investimet e operatorëve në rrjete të fibrave optike, duke përmirësuar kështu shpejtësitë e ofrimit të shërbimit, cilësinë e shërbimit si dhe kanë reduktuar numrin e kabllave që përdorin dhe llojet e pajisjeve të teknologjive të vjetra që instaloheshin në terren dhe tek abonenti, duke i zëvendësuar ato me teknologji të reja bashkëkohore. Risi përbën edhe fakti që përveç zonave urbane, në zonat rurale operatorët tashmë investojnë vetëm rrjete dhe teknologji të fibrave optike.


III. REGJISTRIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE POSTARE, sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2020 kanë ushtruar aktivitet:

- 1 ofrues i shërbimit universal postar (“Posta Shqiptare” sh.a.);
- 27 ofrues të shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.

Gjatë vitit 2020, në AKEP janë regjistruar 12 (dymbëdhjetë) ofrues të rinj për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, dhe janë çregjistruar 3 (tre) ofrues të shërbimeve postare.

Në formë grafike, paraqesim për krahasim, sipërmarrësit që ofruan shërbime postare gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019.




IV. AUTORIZIMET INDIVIDUALE

1. Autorizimet Individuale të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të lëvizshme (celulare) për përdorimin e frekuencave:


Gjatë vitit 2020 kanë ofruar shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime *broadband* në rrjetet mobile 3 operatorë: Vodafone Albania sh.a., One Telecommunications sh.a., dhe Albtelecom sh.a., të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE (800/900/1800/2100/2600 MHz), të njohura si 2G/3G/4G.

2. Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse (pikë-pikë), sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi, etj.

Gjatë vitit 2020, për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP, 69 autorizime individuale, për përdorimin e frekuencave në 67 lidhje fikse të reja dhe 207 lidhje fikse të ndryshuara (në total 274 lidhje fikse). Ndërsa janë revokuar autorizimet individuale për 221 lidhje fikse.



Gjatë vitit 2020, për operatorët që përdorimin frekuencave për sisteme PMR (radiokomunikimi dhe radioalarmi), janë konfirmuar 116 aplikime, nga të cilat, 79 aplikime për sisteme të reja, 1 aplikim për ndryshime në autorizimin ekzistues dhe 36 aplikime për revokimin e frekuencave.



3. Autorizime Individuale numeracionesh:

Gjatë vitit 2020, janë trajtuar dhe vepruar:


- 30 caktime numracionesh (seri numerike, kode të shkurtra);
- 9 anulime numracionesh, të kërkuara nga vetë subjektet/sipërmarrësit.

4. Transferimi i Autorizimeve Individuale të Abcom sh.p.k., tek Vodafone Albania sh.a.:

Pas miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës, të bashkimit me përrthithje të sipërmarrësit Abcom sh.p.k., me sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., me kërkesë të dy operatorëve, me vendimin nr. 23, datë 26.11.2020, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar transferimin e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave (lidhje fikse) dhe numeracioneve nga Abcom sh.p.k., tek Vodafone Albania sh.a. Në fund të vitit 2020, sipërmarrësi Abcom sh.p.k., është çregjistruar në QKB dhe në AKEP, ndërsa nga data 1 janar 2021 shërbimet e telefonisë fikse dhe të internetit me rrjetin fiks, ofrohen pa ndërprerje për pajtimtarët nga Vodafone Albania sh.a.

5. Autorizimet, licencat dhe certifikatat për shërbimet ajrore, detare, etj.


Në zbatim të ligjit 9918, i ndryshuar, dhe Rregulloreve të AKEP, bazuar në aplikimet e paraqitura, janë lëshuar Licenca, Certifikata dhe Autorizime stacione radio bregdetare, si më poshtë:




ADMINISTRIMI I DOMAIN-IT “.AL”:

AKEP administron domain-in “.al”, bazuar në pikën k), të nenit 8, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Numri i domain-eve me “.al” të regjistruar për vitin 2020 është 5726 domain-e. Numri total i domain-eve “.al” deri në fund të vitit 2020 arriti në 24.029 domain-e.

Në terma statistikorë vihet re se kemi një rritje në numër të domain-eve të regjistruar krahasuar me vitin 2019, me rreth 1170 domain-e të regjistruar më tepër gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019.



Numri i domain-eve me “.al” dhe nëndomain-eve me “.al”, deri në fund të vitit 2020, paraqitet me poshtë:



Për shkak të situatës pandemike Covid-19, domain-eve “.gov.al”, gjatë vitit 2020 u është kushtuar një vëmendje e veçantë, për shkak se faqet e ndërtuara me këto domain-e, përbënin burimin kryesor për informimin e sigurt të publikut mbi menaxhimin e situatës pandemike. Gjithashtu, edhe Portali e-Albania (që funksionon me domain-in e-albania.al), ka qenë gjithë kohës aktiv dhe ka ofruar shërbime *online* kritike për të gjithë qytetarët dhe bizneset gjatë vitit 2020.

Nga pikëpamja statistikore, gjatë vitit 2020 janë regjistruar 31 domain-e “.gov.al” dhe janë rinovuar 97 të tillë. Në fund të vitit 2020, numri total i domain-eve “.gov.al”, rezulton të jetë 409.

5.

Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2020

Vendimi	Data	Titulli i Vendimit
Nr.1	30.01.2020	Për miratimin e dokumentit “Plani Strategjik i Inspektimit të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”
Nr.2	30.01.2020	Për miratimin e dokumentit “Plani Strategjik i Inspektimit për Sipërmarrësit e Shërbimeve Postare”
Nr.3	24.02.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me VKD nr.7, datë 16.2.2017
Nr.4	25.03.2020	Vendim Qarkullues për “Pezullimin e mbledhjeve të Këshillit Drejtues në selinë e AKEP dhe realizimin e procesit të vendimmarrjes nëpërmjet mjeteve të komunikimeve elektronike, deri në përfundimin e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”
Nr.5	16.04.2020	Mbi “Pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankimit administrativ të ofruesit të shërbimeve universale postare, “Posta Shqiptare” sh.a., kundër masës administrative të dënimit me gjobë, si pasojë e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore”
Nr.6	16.04.2020	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”
Nr.7	22.04.2020	Për miratimin e dokumentit “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”
Nr.8	24.04.2020	Për “Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”
Nr.9	24.04.2020	Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”
Nr.10	28.05.2020	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aneksin e të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”
Nr.11	16.06.2020	Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit «Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”
Nr.12	16.06.2020	Për miratimin e dokumentit përfundimtar “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”
Nr.13	30.06.2020	Për dhënien e Autorizimit Individual shoqërisë “Posta Shqiptare”sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar
Nr.14	30.06.2020	Për “Përdorimin e komisionit të përfutur si agjent tatimor, nga AKEP, në formën e shpërblimit për vështirësi në punë, për vitin 2020”
Nr.15	13.07.2020	Për “Miratimin e rishpërndarjes së fondit të shpenzimeve të vitit 2020, në zërin shpenzime për investime”

Nr.16	24.07.2020	Mbi “Ankimin administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr.11, datë 16.6.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare , përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”
Nr.17	31.08.2020	Mbi “Përfundimin e afatit të pezullimit të shqyrtimit të ankimit administrativ të ofruesit të shërbimit universal “Posta Shqiptare” sh.a., kundër masës administrative të dënimit me gjobë dhe vijimin e procedurave administrative për shqyrtimin e ankimit”
Nr.18	31.08.2020	Për “Shfuqizimin e aktit administrativ “Akt bllokimi dhe ndalim funksionimi të pajisjeve”, datë 12.8.2020, të nxjerrë nga grupi monitorimit, i ngritur me Autorizimin nr. 1596, datë 06.8.2020 “Për kryerjen e matjeve për monitorimin e frekuencave ”
Nr.19	17.09.2020	Mbi “Shqyrtimin e ankimit administrativ të ofruesit të shërbimit universal postar, “Posta Shqiptare” sh.a., kundër Vendimit nr.1, datë 18.2.2020”
Nr.20	25.09.2020	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: «Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike»
Nr.21	30.09.2020	Për “Mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor, për vitin 2021”
Nr.22	05.10.2020	Për “Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2021, të AKEP”
Nr.23	26.11.2020	Për “Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP, si dhe autorizimet e përgjithshme dhe individuale të sipërmarrësit Abcom sh.p.k., tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a.”
Nr.24	26.11.2020	Për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile”
Nr.25	09.12.2020	Për “Përcaktimin e procedurave të dhënies së shpërblimit për rezultate të mira në punë gjatë vitit 2020 për punonjësit e AKEP”

Kontribuan në
hartimin e këtij Raporti:

Eriola Mosko, Lorenc Bako, Alma Kërçini, Bleron Dokle, Gazmir Mani, Altin Rrapaj, Vasil Mitezi, Jetmir Braha,
Enkeleda Pojani, Jonida Koçi, Bledar Kazia, Fjoralb Bitri, Gazmir Isakaj, Glorian Tusha.



AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE